



ANKETË PËR
**MIRËQENIEN
DHE SIGURINË
E GRAVE**
NË KOSOVË

Kjo punë është kryer në përputhje me kërkesat e standardit ndërkombëtar të cilësisë për hulumtim të tregut, ISO 20252:2012, dhe me kushtet dhe konditat e Ipsos MORI, që mund të gjenden në <http://www.ipsos-mori.com/terms>.

Misioni i OSBE-së në Kosovë i ka kushtuar kujdes të jashtëzakonshëm përpunimit të materialeve në këtë publikim. Megjithatë, OSBE nuk pranon asnjë përgjegjësi për saktësinë dhe plotësinë e informacioneve, udhëzimeve dhe këshillave të siguruara, apo për gabime shtypi. Qëndrimet, opinionet, gjetjet, interpretimet dhe konkluzionet e shprehura këtu janë të autorëve dhe kontribuuesve dhe ato jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pozitën institucionale ose politiken zyrtare. Për këto arsye, nuk mund të parashtrohet asnjë kërkesë kundër Misionit në Kosovë të OSBE-së përkitazi me pasojat potenciale që mund të dalin nga informacionet apo përfundimet që i përmban ky raport.

Përmbajtja

Informata të përgjithshme	4
Përmbledhje ekzekutive	8
1. Si të lexohen të dhënat	17
2. Konteksti ligjor, institucional dhe i politikave	23
3. Qëndrimet ndaj roleve gjinore dhe dhunës ndaj grave	31
4. Dhuna ndaj grave në Kosovë	37
5. Konflikti dhe dhuna	55
6. Ndikimi i dhunës në jetët e grave dhe pengesat për të kërkuar mbështetje.....	61
7. Përvojat e dhunës në mesin e grupeve specifike të grave...	75
8. Përfundimet dhe rekomandimet.....	81
SHTOJCAT	89

Informata të përgjithshme

OSBE-ja pranon se të drejtat e barabarta të grave dhe burrave janë thelbësore për të nxitur paqe, demokraci të qëndrueshme dhe zhvillim ekonomik. OSBE-ja e trajton dhunën ndaj grave dhe vajzave (DHNGV)¹ si kërcënim ndaj individit dhe si brengë më të gjerë të sigurisë, dhe rrjedhimisht e sheh si një prej prioriteteve të saj në parandalimin dhe luftimin e DHNGV. DHNGV është shkelje e vazhdueshme e të drejtave të njeriut që kërcënon sigurinë e grave dhe vajzave të shumta kudo nëpër botë. Kjo ndikon jo vetëm në jetën e grave dhe vajzave, duke penguar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe të barabartë në shoqëri, por edhe të atyre që i kanë pranë; përfundimisht ka ndikim afatgjatë në shëndetin dhe mirëqenien e tyre dhe të fëmijëve të tyre, komunitetin dhe shoqërinë në përgjithësi.

Pabarazia gjinore është gjeneza e dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave. OSBE-ja ka një rol kyç sa i përket punës që po bën me hisedarët lokalë për të ndërtuar kapacitetet e tyre në parandalimin e dhunës me bazë gjinore dhe mbrojtjen e të mbijetuarve.² Nën sloganin "Të sjellim sigurinë në shtëpi", OSBE-ja ka theksuar faktin se gratë dhe vajzat duhet të jenë të sigurta si në publik ashtu dhe në shtëpi, në mënyrë që të mund ta shpalosin potencialin e tyre të plotë dhe të kontribuojnë në zhvillimin politik, ekonomik dhe shoqëror.

Misioni i OSBE-së në Kosovë ka mbështetur në mënyrë aktive homologët në adresimin e çështjes së dhunës në baza gjinore dhe për të forcuar mbështetjen për viktimat e dhunës në familje gjatë dekadës së fundit. Misioni ka monitoruar nga afër zbatimin e kornizës përkatëse ligjore dhe të politikave, përfshirë Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2016-2020. Në periudhën 2012 dhe 2019, Misioni mbështeti krijimin e dymbëdhjetë Mekanizmave Koordinues të Dhunës në Familje në komuna të ndryshme dhe ka ofruar ekspertizë për Grupin Punues Ndërmator për Dhunën në Familje, i kryesuar nga Koordinatori i Kosovës për Dhunën në Familje. Pas avokimit të Misionit, dhuna në familje është përfshirë si vepër e veçantë penale në Kodin e ri Penal, i cili hyri në fuqi në mes të prillit 2019. Në gjysmën e parë të vitit 2019, Misioni mbështeti Grupin Punues të Kuvendit në hartimin e Ligjit të ri për parandalimin dhe mbrojtjen nga format e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.

Misioni vazhdimisht avokon për zgjidhje të qëndrueshme financiare për të mbështetur viktimat e dhunës në familje, si dhe rritjen e aftësive për të gjithë ofruesit e shërbimeve përkatëse. Në këtë drejtim, në vitin 2019, Misioni nxori një raport mbi strehimoret për viktimat e dhunës në familje në Kosovë, i cili përshkruan kornizën ligjore dhe institucionale që rregullon strehimoret dhe sfidat me të cilat ato përballen. Gjithashtu, u dhanë rekomandime për veprime të mëtejshme. Me një punë kaq të thellë për ndërtimin e kapaciteteve dhe mbështetje për homologët në fushën e DHNG dhe DHF. Misioni identifikoi mungesën e të dhënave të krahasueshme dhe një pasqyre të përshtatshme statistikore të këtij fenomeni në Kosovë.

Kështu, në fillim të vitit 2016, me mbështetjen e Seksionit Gjinor të OSBE-së në Vjenë, Misioni në Kosovë inicioi procesin e realizimit të Anketës për mirëqenien dhe sigurinë

¹ Shprehjet "dhunë ndaj gruas" (DHNG) dhe "dhunë ndaj grave dhe vajzave" (DHNGV), që përdoren në këtë raport përfshijnë dhunën fizike, seksuale dhe psikologjike nga partnerët intimë dhe nga jopartnerët, si dhe përndjekjen dhe ngacmimin seksual.

² Ky raport termin "e mbijetuar" ose "viktimë" e përdorë në mënyrë të ndërsjellë.

e grave në Kosovë. Metodologjia e kësaj ankete në Kosovë bazohet plotësisht në metodologjinë e anketës së parë në mbarë Bashkimin Evropian mbi dhunën ndaj grave që është nisur në vitin 2014 nga Agjencia Evropiane për të Drejtat Themelore. Qëllimi i këtij studimi është të sigurojë të dhëna të fuqishme në mënyrë që të zhvillohen politika, strategji, programe dhe aktivitete më gjithëpërfshirëse dhe të bazuara në prova për të parandaluar dhe luftuar DHNG. Qëllimi përfundimtar i këtij hulumtimi është të sigurojë dëshmi për vendimmarrje të informuar dhe avokim në nivele të ndryshme dhe në këtë mënyrë të kontribuojë në ulje të DHNG në Kosovë dhe për përmirësimin e shërbimeve për të mbijetuarit dhe ofrimin e sigurisë më të madhe për gratë. Rezultatet e anketës jo vetëm që do të ndihmonin Misionin e OSBE-së në Kosovë për zhvillimin e programimit më të mirë në këtë fushë, por ato do të përdoren edhe nga organizatat e tjera dhe OJQ-të për të drejtat e grave në aktivitetet e tyre të përditshme dhe ofrimin e shërbimeve të mbështetjes direkte për viktimat dhe të mbijetuarit.

Puna e përshkruar në këtë raport është realizuar në përputhje me kërkesat e standardit ndërkombëtar të cilësisë së hulumtimeve të tregut, ISO 20252: 2012, dhe me termat dhe kushtet e Ipsos MORI, të cilat mund të gjenden në <http://www.ipsos-mori.com/terms>

Anketë për mirëqenien dhe sigurinë e grave në Kosovë





Përmbledhje ekzekutive

Hyrje

Ky raport paraqet gjetjet nga studimi cilësor dhe sasior i OSBE-së në Kosovë mbi dhunën ndaj grave (DHNG). Studimi ka përfshirë sa vijon:

- **15 intervista me ekspertë kryesorë**, që ofruan një pasqyrë të çështjeve që kanë të bëjnë me DHNG, si dhe të akteve të dhunës të lidhura me konfliktin;
- Anketën e realizuar me **mostër reprezentative të përbërë nga 1,990 gra të moshës 18-74 vjeç që jetojnë në Kosovë**, duke përfshirë 1,690 gra të cilat jetojnë në zona të banuara kryesisht nga shqiptarë të Kosovës dhe 300 gra të cilat jetojnë në zona të banuara kryesisht nga serbë të Kosovës. Komunitetet e tjera që jetojnë në këto hapësira gjithashtu janë përfshirë në anketë.³ Anketa përdori modelin e mostrës shumëfazëshe, të shtresëzuar të probabilitetit të rastësisë, që kishte për synim përcaktimin e mbizotërimit dhe pasojave nga dhuna.
- **Tetë grupe fokusi me gra me sfonde të ndryshme demografike** mbi qëndrimet e tyre ndaj DHNG; dhe
- **Pesë intervista të hollësishme** me gra që kishin përjetuar dhunë, me qëllim të kuptimit të ndikimit që u kishte shkaktuar dhuna.

Gjetjet kryesore

- Gati dy e treta e grave të anketuara (64%) mendojnë se dhuna nga partnerët, personat e njohur apo të panjohur është shumë ose mjaft e zakonshme dhe më shumë se një e katërta (27%) mendojnë se është shumë e zakonshme.
- Mbi gjysma (54%) e të gjitha grave thonë se kanë përjetuar dhunë psikologjike, fizike ose seksuale nga një partner i ngushtë që nga moshë 15 vjeçare, dhe gati tre në dhjetë gra (29%) thonë të kenë përjetuar ngacmime seksuale. Një në shtatë gra (14%) pohojnë të kenë përjetuar dhunë fizike ose seksuale nga një partner ose jopartner (këtu nuk përfshihet dhuna psikologjike). Gratë serbe janë më me gjasë të tregojnë se kanë përjetuar dhunë fizike apo seksuale sesa gratë shqiptare të Kosovës (34% kundrejt 13%). Më shumë shqiptare të Kosovës se sa serbe të Kosovës pajtohen me idenë se dhuna ndaj grave shpesh provokohet nga viktimat (36% me 23%) dhe se dhuna në familje është një çështje private që duhet trajtuar brenda saj (49% me 38%). Është gjetur se gratë serbe të Kosovës janë më të gatshme t'i ndajnë përvojat e tyre gjatë intervistave të anketës.
- Gati një në pesë gra (18%) të cilat kanë pasur partner më parë thonë të kenë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partneri i mëparshëm, krahasuar me 9% të tyre që aktualisht kanë partner e të cilat thonë të kenë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partnerët aktualë. 8% e grave të anketuara thonë të kenë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga personat të cilët nuk i kanë partnerë. Përndjekja ka prekur një në dymbëdhjetë gra (8%).

Ndikimi nga dhuna mund të jetë i ashpër dhe afatgjatë. Më shumë se gjysma e të mbijetuarave karakterizoheshin nga ndjenja e zemërimit, bezdisë dhe frikës, secila e raportuar nga më shumë se gjysma e grave të anketuara, derisa një e katërta e tyre vuante nga ankthi, depresioni ose vështirësia për të bërë një gjumë të qetë si pasojë e

³ Gjithsej 179 gra janë identifikuar t'i përkasin komuniteteve të tjera.

përvojës së tyre. Më shumë se gjashtë në dhjetë gra (64%) që kishin përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga një partner intim, kishin pasur nevojë për një periudhë më të gjatë për ta rimarrë veten psikologjikisht nga incidenti më i rëndë.

Dhuna ndaj grave (DHNG) është njëherazi shkak dhe pasojë e pabarazisë gjinore, që përjetësohet nga normat dhe qëndrimet ekzistuese. Gratë e anketuara thonë se Kosova është ende një shoqëri patriarkale ku burrat dominojnë në shtëpi, në punë dhe në sferën publike. Më shumë se gjysma (57%) e grave në Kosovë nga mosha 18-74 vjeç besojnë se miqtë e tyre pajtohen me idenë se: "Një grua e mirë i bindet burrit të saj edhe nëse ajo nuk pajtohet me të." Pak më shumë se çereku (26%) i grave të anketuara thonë se miqtë e tyre do të pajtoheshin që: "Është obligim i gruas të kryejë marrëdhënie seksuale me burrin e saj edhe nëse ajo nuk ka dëshirë".

Më shumë se gjysma e grave që kanë pasur partner ndonjëherë thonë të kenë përjetuar dhunë psikologjike, fizike apo seksuale në duart e partnerit intim që nga mosha 15 vjeçare.

Nga një sërë deklaratash në lidhje me qëndrimet që janë testuar në këtë studim, janë gratë e reja, ato më mirë të arsimuara dhe ato në zonat urbane të cilat besojnë se miqtë e tyre janë dukshëm me më pak gjasë të pajtohen apo të veprojnë mbi bazën e nocionit se gratë duhet t'i nënshtrohen partnerit mashkull, megjithatë është me rëndësi të njihet që kjo nuk do të thotë se nuk ka forma të dhunës brenda këtij grupi. Për shembull, gratë e moshës 18-29 vjeç janë me më shumë gjasë të thonë të kenë përjetuar ngacmim seksual që nga mosha 15 vjeçare (42% kundrejt 15% të atyre mbi moshën 60 vjeç), derisa 5% të grave me shkollim të lartë tregojnë se kanë përjetuar dhunë fizike ose seksuale nga partnerët intimë në 12 muajt e fundit para anketës, që si e dhënë është e krahasueshme me gjitha gratë që kanë pasur ndonjëherë partnerë në jetën e tyre (4%).

Gjithashtu gratë serbe të Kosovës janë më me gjasë të thonë se kanë përjetuar dhunë fizike ose seksuale sesa shqiptaret e Kosovës (34% kundrejt 13%). Më shumë gra shqiptare të Kosovës sesa grua serbe të Kosovës pajtohen se dhuna ndaj grave shpeshherë provokohet nga viktima (36% kundrejt 23%) dhe se dhuna në familje është çështje private që duhet të trajtohet brenda familjes (49% kundrejt 38%). Është vërejtur se gratë serbe të Kosovës ishin më të gatshme t'i ndanin përvojat e tyre gjatë intervistës në anketë.

Vetëm një numër i vogël i grave të anketuara e kanë informuar policinë për atë që kanë konsideruar të jetë rast i tyre më i rëndë i dhunës në duart e partnerit aktual, partnerit të mëhershëm apo dikujt tjetër. Në veçanti, vetëm 2% e grave raportuan për incidentin më të rëndë të dhunës nga partneri aktual në polici. Kjo mbështetet nga fakti që gati gjysma e grave të anketuara (48%) besojnë se dhuna në familje është çështje private që duhet të mbahet brenda familjes.

Pengesat për të kërkuar mbështetje përfshijnë pranimin e dhunës si normale, mosbesimin e përgjithshëm se do të mbrohen nga sistemi dhe aktorët e tij në raste të kërkit të mbështetjes, si dhe mungesën e strehimit dhe mbështetjes afatgjate financiare, gjë që e bën braktisjen e partnerit abuzues aspak praktike, të kotë dhe

potencialisht të rrezikshëm. Shumica e grave të anketuara tregojnë se kanë parë fushata reklamuese që adresojnë çështjen dhe më shumë se një e treta e tyre (35%) ndjehen të mirinformuara rreth asaj se çfarë duhet të bëjnë nëse përjetojnë dhunë. Megjithatë, shumica e të anketuarave nuk kanë njohuri për shërbimet e specializuara dhe thonë se nuk do ti qaseshin këtyre shërbimeve për ndihmë pas ndonjë incidenti të dhunës, duke preferuar, në vend të kësaj, përkrahjen nga familja dhe miqtë.

Historia e jo e largët e konfliktit në Kosovë është gjithashtu një sfond i rëndësishëm për dhunën e përjetuar nga gratë. Gati tre të katërtat e të anketuarave (73%) mund të përkufizohen si të prekura drejtpërsëdrejti nga konflikti⁴, dhe atë kryesisht nga konflikti i Kosovës e për disa dhe nga trazirat e marsit 2004. Pothuajse një e treta (32%) e rasteve më të rënda të dhunës nga jopartnerë, të raportuara nga gratë që janë të prekura nga konflikti ishin të lidhura me konfliktin.

Gati një e katërta e grave (23%) thonë të kenë përjetuar ndonjë formë dhune nga një i rritur, si dhunë fizike, psikologjike ose seksuale, kur ishin fëmijë (para se të mbushnin 15 vjeç). Zakonisht, ato janë goditur me shuplakë ose u janë shkukur flokët deri në dhimbje, por gati një në dhjetë (9%) ishin rrahur shumë me shkop, thupër ose rrip. Shumica e atyre që thonë të kenë përjetuar pothuajse të gjitha format e dhunës fizike në fëmijëri, thonë se kjo u ka ndodhur më shumë se një herë.

Përfundime

Gjetjet e anketës dhe hulumtimit cilësor shpalosin përfundimet dhe rekomandimet e mëposhtme (shih Kapitullin 8 për më shumë hollësi):

1. Normat dhe qëndrimet shoqërore kontribuojnë në pabarazinë gjinore dhe stigmën e lidhur me raportim të dhunës dhe kërkim të ndihmës

Ekspertët e intervistuar për këtë raport kanë thënë se, ndonëse Kosova ka ligje të harmonizuara me zotimet ndërkombëtare, zbatimi i tyre është i mangët. Gratë në hulumtimin cilësor kanë thënë se disa zyrtarë i fajësojnë gratë për dhunën që përjetojnë, gjersa të dhënat e anketës shfaqin një mungesë besimi në institucione (polici, sektorin social e shëndetësor dhe në gjyqësor). Grumbullimi i të dhënave duhet gjithashtu të përmirësohet ashtu që të krijohen politika më të mira.

2. Legjislacioni nuk po gjen zbatim të mjaftueshëm dhe besimi tek institucionet që do të duhej t'u ofronin mbështetje viktimave të dhunës është i ulët

Ekspertët e intervistuar për këtë raport kanë thënë se, ndonëse Kosova ka ligje të harmonizuara me zotimet ndërkombëtare, zbatimi i tyre është i mangët. Gratë në hulumtimin cilësor kanë thënë që disa zyrtarë i fajësojnë gratë për dhunën që përjetojnë, gjersa të dhënat e anketës shfaqin një mungesë besimi në institucione (polici, sektorin social e shëndetësor dhe në gjyqësor). Grumbullimi i të dhënave duhet gjithashtu të përmirësohet ashtu që të krijohen politika më të mira.

3. Shërbimet e specializuara për mbështetje dhe strehimoret për gratë që mbijetojnë dhunën janë të mangëta dhe kanë nevojë për përmirësim, duke përfshirë ato për grupet e grave në disavantazh

Vetëm një përqindje e vogël e grave janë në dijeni të ekzistimit të strehimoreve dhe shërbimeve tjera përkrahëse, ose çfarë duhet bërë nëse përjetojnë dhunë. Duhet të sigurohet qëndrueshmëria e këtyre shërbimeve duke siguruar fonde të rregullta dhe të mjaftueshme. Gratë me aftësi të kufizuara dhe gratë nga grupet e pakicave dhe grupet e tjera në situatë të pafavorshme përballen me sfida të veçanta në kuptim të qasjes në shërbime dhe ka më shumë gjasë të përballen me diskriminim.

⁴ Gratë të cilat konsiderohen si të prekura nga konflikti janë ato që kanë jetuar në një situatë ku ka pasur një konflikt aktiv dhe të armatosur për një periudhë prej së paku një javë dhe i janë përgjigjur me "po" të paktën njëherë nga pyetjet e renditura në Kapitullin 4.

4. Gratë të cilat i kanë mbijetuar dhunës së lidhur me konfliktin kanë nevojë për më shumë mbështetje

Gati tre të katërtat e grave në Kosovë mund të cilësohen si të prekura drejtpërdrejtë nga konflikti. Ekspertët e intervistuar për këtë raport kanë thënë se sigurimi i pensionit për viktimat e dhunës seksuale gjatë një konflikti është i kufizuar dhe diskriminues, dhe se mund të bëhet më shumë për ta përmirësuar sistemin e verifikimit për viktimat e dhunës seksuale të lidhura me konfliktin.

Gratë me aftësi të kufizuara, gratë nga grupet e pakicave e grupet e tjera në situatë të pafavorshme përballen me sfida të veçanta për qasje në shërbime

Rekomandime

Gjetjet dhe konkluzionet e mësipërme nga anketa dhe hulumtimi sigurojnë bazën për një numër rekomandimesh specifike për të adresuar dhunën ndaj grave (shih Kapitullin 8 për një listë të hollësishme të rekomandimeve):

Përmirësimi dhe monitorimi i legjislacionit dhe zbatimit të tij

Për Qeverinë

- Të ndryshohet Ligji për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës, viktimave civile dhe familjarëve të tyre, për të mundësuar që të gjitha gratë të cilat i kanë mbijetuar dhunës seksuale në konflikt të marrin pension dhe të përmirësohet procesi i aplikimit për pension.
- Të sigurohet krijimi i një mekanizmi të cilin mund ta përdorin viktimat për të raportuar sjelljen e keqe ose dështimin nga ana e zyrtarëve për mbrojtjen e viktimave, të vendosen gjopa për sjellje dhe dështime të tilla, dhe të ndryshohet legjislacioni për të siguruar që gratë të mos humbasin kujdestarinë e fëmijëve të tyre me rastin e shkurorëzimit nga partnerët abuzivë.
- Të merren parasysh konkluzat e raportit në zhvillimin e ligjit të ri për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Për Ministrinë e Drejtësisë

- Të monitorohen dhe identifikohen boshllëqet në zbatimin e Procedurave standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje, të monitorohet dhe sigurohet që gjykatat të respektojnë afatin 24-orësh për nxjerrje të urdhrin për mbrojtje emergjente, dhe të sigurohet trajtim me ndjeshmëri i viktimave gjatë procedurave gjyqësore.

Bashkëpunimi, trajnimet dhe qasja shumë sektoriale

Për Qeverinë

- Të funksionalizohet një qasje shumëinstitucionale, të përmirësohet bashkëpunimi midis Policisë së Kosovës, prokurorëve, njësive të mbrojtësve të

viktimave, qendrave për punë sociale dhe gjykatave për të siguruar mbrojtje të përshtatshme për viktimat, të sigurohen trajnime të rregullta për të gjithë përfaqësuesit e zbatimit të ligjit dhe të jetësohen programe rehabilituese për kryerësit si pjesë e një reagimi të bashkërenduar të komunitetit.

Për Ministrinë e Drejtësisë

- Të sigurohet trajnim për prokurorët dhe gjyqtarët për rastet e dhunës në familje.

Për Policinë e Kosovës

- Të vazhdohet me ofrimin e trajnimeve të detyrueshme, trajnimeve të specializuara dhe të avancuara për t'iu përgjigjur rasteve të dhunës në familje; të bëhet obligative që Policia e Kosovës t'i informojë menjëherë qendrat për punë sociale dhe njësitë e mbrojtësve të viktimave për çdo akt të raportuar të dhunës në familje, dhe të sigurohet që të ketë numër të mjaftueshëm të zyrtareve policore për t'i mbështetur hetimet.

Për komunat

- Me mbështetje të Misionit të OSBE-së në Kosovë janë themeluar dymbëdhjetë mekanizma koordinues për dhunën në familje në tërë Kosovën. Të vazhdohet me themelimin e mekanizmave koordinues për dhunën në familje deri në mbulimin e të gjitha komunave;
- Të sigurohet qëndrueshmëri financiare për strehimoret për viktimat e dhunës në familje;
- Të forcohen kapacitetet e qendrave për punë sociale dhe të ofruesve të kujdesit shëndetësor për t'iu përgjigjur rasteve të dhunës në familje; të fuqizohen zyrtarët komunalë për barazi gjinore për t'i bashkërenduar përpjekjet në lidhje me luftimin e dhunës në familje në nivel lokal; të prezantohet buxhetimi gjinor.

Shërbimet e specializuara dhe mbështetja për gratë

Për Qeverinë

- Të përmirësohet niveli i mbështetjes ekonomike për gratë, duke përfshirë ndihmën financiare dhe strehimin, si dhe mbështetjen e projekteve të drejtuara nga OJQ-të që mbështesin gratë në gjetjen e punës dhe ngritjen e bizneseve; të stimulohen financiarisht bizneset që punësojnë gra të cilat i kanë mbijetuar DHNG.

Për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale

- Të sigurohet që të ketë financim të mjaftueshëm dhe të rregullt afatgjatë për strehimoret ekzistuese të grave, përfshirë procedurat e thjeshta dhe të shpejta në licencimin e strehimoreve të reja; të përmirësohet qasja në strehimore dhe shërbimet për gratë në nevojë; të ofrohet mbështetje psikologjike për viktimat;

të organizohen programe për nxitjen e pavarësisë ekonomike; të prezantohen programe të qëndrueshme të riintegritimit për të mbijetuarit e dhunës në familje.

Për Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

- Të sigurohet banim social për gratë të cilat i kanë mbijetuar DHNG.

Për komunat

- Të shpërndajë përmes institucioneve lokale informacione në lidhje me shërbimet në dispozicion dhe të drejtat e grave në rast të dhunës ndaj grave, të ofrojnë mbështetje financiare për të mbuluar koston e kujdesit për fëmijët, t'i informojnë më mirë gratë në nivel lokal se çfarë të bëjnë kur përjetojnë dhunë.

Edukimi, shpërndarja e informatave dhe vetëdijesimi

Për Qeverinë

- Të hartohen dhe realizohen fushata publike për të rritur ndërgjegjësimin për dhunën ndaj grave, posaçërisht për dhunën seksuale, veçanërisht në marrëdhëniet midis partnerëve intimë, si dhe dhunën seksuale ndaj grave që lidhet me konfliktin.

Për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale

- Të zhvillohen fushata sensibilizuese të synuara enkas për gratë të cilat i kanë mbijetuar DHNG, të promovohen histori për gratë të cilat kanë arritur ta tejkalojnë dhunën e ushtruar ndaj tyre dhe se si ndihmuan institucionet (policia, sektori social dhe ai i shëndetësisë, gjyqësori) dhe të sigurohet përfshirja e grupeve të grave në pozitë më të pafavorshme, si dhe të mbulohen të gjitha rajonet e Kosovës, përfshirë zonat rurale dhe zonat me popullsi kryesisht serbe të Kosovës.

Për Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë


- Të promovohen diskutime mes brezave të ndryshëm për ta nxitur angazhimin e rinisë dhe, në veçanti, burrave të rinj për ta luftuar DHNG.
- Të aplikohet komponenti i integritimit gjinor në programet shkollore, duke përfshirë heqjen e gjuhës dhe normave diskriminuese që shpijnë në vazhdimin e pabarazisë gjinore nga librat shkollorë.

Rezultatet e studimit të udhëhequr nga OSBE-ja: Kosovë

Studim sasior i realizuar me një mostër përfaqësuese të grave të moshës 18-74 vjeç që jetojnë në Kosovë. Gjithsej 1,990 intervista të realizuara ballë për ballë prej prillit deri në gusht të vitit 2018. Të dhënat janë ponderuar sipas profilit të njohur të popullsisë.

PËRHAPJE E MADHE E FORMAVE TË NDRYSHME TË DHUNËS NDAJ GRAVE

PËRHAPJE E MADHE E FORMAVE TË NDRYSHME TË DHUNËS NDAJ GRAVE



■ Qysh në moshën 15 vjeçare ■ Në 12 muajt e fundit para anketës

338,000*

gra kanë përjetuar një formë të ngacimit seksual, përndjekjes, dhunë nga partneri intim, ose dhunë nga jopartneri (përfshirë dhunën psikologjike, fizike ose seksuale) që nga moshë 15 vjeç

51,000*


gra kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partneri intim

45,500*

kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga jopartneri

*Shifra të përafërta

NJË NË DHJETË GRA KANË PËRJETUAR DHUNË FIZIKE DHE/OSE SEKSUALE NGA JOPARTNERI




■ Që nga moshë 15 vjeçare ■ Në 12 muajt e fundit para anketës

DHUNA NGA PARTNERI INTIM



■ Që nga moshë 15 vjeçare ■ Në 12 muajt e fundit para anketës


DHUNA PSIKOLOGJIKE NGA PARTNERI INTIM ËSHTË FORMA MË E PËRHAPUR



Baza: Përhapja e ngacimit seksual, përndjekjes dhe dhunës nga jopartneri bazohet në të gjitha gratë e moshës 18-74 vjeç (1,990); Dhuna nga partneri intim bazohet në të gjitha gratë që kanë pasur ndonjëherë partner (1,714)

SHKALLË TË ULTA TË RAPORTIMIT DHE NDËRGJEGJËSIMIT


SHUMË GRA MENDOJNË SE NUK JANË TË INFORMUARA PËR ATË QË DUHET TË BËHET NË RAST TË PËRJETIMIT TË DHUNËS



Baza: Të gjitha gratë e moshës 18–74 vjeçare (1,990)

SHKALLË TË ULTA TË RAPORTIMIT NË POLICI

% e atyre që kanë kontaktuar policinë drejtpërsëdrejti pas incidentit më të rëndë të dhunës




Baza: Gjitha gratë e moshës 18–74 vjeç të cilat kanë identifikuar një incident më të rëndë të secilës formë të dhunës - partneri aktual (149), partneri i mëparshëm (49), jopartner (131), ngacim seksual (389), përndjekje (112)

QËNDRIMET E HESHTJES DHE FAJËSIMIT TË VIKTIMËS

■ Plotësisht/Prirë të pajtohem ■ Plotësisht/Prirë të pajtohem

P: A do të pajtoheshin apo nuk do të pajtoheshin, përgjithësisht, miqtë tuaj me deklaratat vijuese. "Dhuna ndaj grave shprehet provokohet nga viktima"



P: A do të pajtoheshin apo nuk do të pajtoheshin, përgjithësisht, miqtë tuaj me deklaratat vijuese. "Është obligim i gruas të kryejë marrëdhënie seksuale me burrin e saj edhe nëse ajo nuk ka dëshirë".



P: Deri në çmasë do pajtoheshit apo nuk do të pajtoheshit me deklaratat vijuese? "Dhuna në familje është një çështje private dhe duhet të zgjidhet brenda në familje."

Baza: Të gjitha gratë e moshës 18–74 vjeç (1,990) - shqiptare të Kosovës (1,690), serbe të Kosovës (300); që jetojnë në zonat urbane (864), zona rurale (1,126)

NDIKIMI I INCIDENTEVE MË SERIOZE

DHUNA SHKAKTON VUAJTJE PSIKOLOGJIKE

% e atyre që kanë përjetuar një a më shumë pasoja psikologjike për shkak të...

Dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partneri intim ose jopartneri



Ngacim seksual



Përndjekje



DHUNA SHKAKTON VUAJTJE PSIKOLOGJIKE

% e atyre që kanë përjetuar një a më shumë pasoja fizike për shkak të...

Dhunë nga partneri aktual




Dhunë nga partneri i mëparshëm



Dhunë nga jopartneri



Çfarëdo dhune nga partneri intim/jopartneri




Kjo përkthehet në 24 në 24,700 gra* të cilat kanë pësuar ndonjë lëndim apo pasojë fizike, duke marrë parasysh vetëm rastet më të rënda që ato i kanë identifikuar gjatë jetës në moshën madhore.

*Shifra të përafërta

Gjitha gratë e moshës 18–74 vjeç të cilat kanë identifikuar një incident më të rëndë të secilës formë të dhunës - ngacim seksual (389), përndjekje (112), dhunë nga partneri aktual (149), partneri i mëparshëm (49), jopartneri (131), çfarëdo dhune nga partneri intim/jopartneri (265)

PËRHAPJA E DHUNËS SIPAS ZONËS SË BANIMIT



Baza: Të gjitha gratë e moshës 18–74 vjeç që jetojnë në zona urbane (864), zona rurale (1,126)

Anketë për mirëqenien dhe sigurinë e grave në Kosovë



Foto: Yllka Fetahaj

1. Si të lexohen të dhënat

Hyrje dhe qëllimet kryesore të hulumtimit

Anketa e udhëhequr nga OSBE kap shkallën e përhapjes së dhunës ndaj grave në Kosovë bazuar në një mostër përfaqësuese të popullsisë së grave në moshë madhore (1,990 individë të moshës 18-74 vjeç, duke përfshirë 1.960 të cilët jetojnë në zona kryesisht të banuara me shqiptarë të Kosovës dhe 300 gra të cilat jetojnë në zona kryesisht të populluara me serbë të Kosovës. Karakteristikat kryesore demografike të përdorura për hulumtim ishin mosha e grave, statusi i punës, nëse ato jetonin në një zonë rurale apo urbane dhe nëse ishin prekur nga konflikti apo jo. Qëllimet kryesore të studimit janë të sigurohet dëshmi për shkallën e përhapjes së DHNGV dhe pasojave të saj për shëndetin dhe mirëqenien e grave me qëllim të hartimit të politikave. Pyetjet kryesore të anketës ishin:

- Cila është shkalla e dhunës së përjetuar nga gratë në Kosovë?
- Cilat forma të dhunës i përjetojnë gratë në Kosovë?
- Kush janë kryerësit e dhunës ndaj gruas?
- Cilat janë pasojat e dhunës për shëndetin dhe mirëqenien e gruas?
- A i raportojnë gratë përvojat e tyre tek policia apo autoritetet e organizatat tjera? Nëse jo, pse?
- A ka ndryshime mes përvojave të dhunës të grave në varësi të moshës, arsimit, statusit profesional, të ardhurave apo nëse janë nga ndonjë grup pakicë ose nga një zonë rurale?

Studimi gjithashtu synoi arritjen e një kuptimi më të mirë të të lartpërmendurave duke e marrë në konsideratë edhe nëse gratë kishin përjetuar konflikt të armatosur bazuar në përkufizimet e përdorura në studim (për më shumë shih Kapitullin 5).

Anketa e udhëhequr nga OSBE u kërkoi grave që të bëjnë dallimin midis incidenteve që u kanë ndodhur që nga mosha 15 vjeç dhe në dymbëdhjetë muajt e fundit përpara anketimit. Në këtë mënyrë sigurohen të dhëna me rëndësi të drejtpërdrejtë për politikën sa i përket praktikës aktuale, siç janë raportimi dhe përgjigjet ndaj viktimave.

Krahasueshmëria me të dhënat e BE-së dhe zonën e mbuluar nga anketa e udhëhequr nga OSBE

Ky hulumtim bazohet në metodologjinë e përdorur nga Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (ADTH) për anketën e saj të vitit 2012 mbi dhunën ndaj grave në 28 shtete anëtare të Bashkimit Evropian. Prandaj, ky studim i udhëhequr nga OSBE-ja është i krahasueshëm me anketën e ADTH. Instituti Evropian për Barazi Gjinore (IEBGJ) përdorë të dhënat e ADTH në punën e tyre aktuale dhe planet për përdorimin e gjetjeve të OSBE-së në të ardhmen. Në fund, studimi i OSBE përmban pyetje të përzgjedhura të Eurobarometrit⁵ mbi qëndrimet ndaj DHNG.

⁵ Eurobarometri Special 449: Dhuna e bazuar në gjini", Komisioni Evropian, Drejtoria e Përgjithshme për Drejtësi dhe Konsumator, nëntor 2016, parë më 26 janar 2019, https://data.europa.eu/euodp/data/dataset/S2115_85_3_449_ENG.

Ngurrimi për të folur mbi DHNG dhe DHF

Për ta kuptuar më mirë përhapjen e DHNG, konteksti ka rol shumë të rëndësishëm. OSBE-ja shtoi në anketë disa pyetje mbi normat, qëndrimet dhe sjelljen e grave, familjes dhe miqve të tyre (përfshirë burrat) në lidhje me dhunën dhe përvojat me raportim të abuzimit. Duke krahasuar të dhënat e OSBE-së me të dhënat e BE-së mbi qëndrimet dhe normat gjinore (Eurobarometri Nr. 449), ky studim sugjeron se në vendet ku ka më shumë gra të cilat mendojnë se dhuna në familje është një çështje private ka tendencë që numër më i vogël i grave ta raportojnë përjetimin e dhunës në polici dhe organizata të tjera sesa në vendet ku ka traditë më të gjatë të ndërgjegjësimit mbi dhunën ndaj grave. Studimi cilësor konfirmon që tabuja dhe turpi që lidhet me dhunën seksuale është veçanërisht i përhapur.

Studimet paraprake

Mbi përhapjen dhe karakteristikat e dhunës ndaj grave janë zhvilluar disa anketa të mëparshme, por gjithashtu janë kryer edhe anketime specifike në lidhje me dhunën në bazë gjinore të kryer ndaj grave gjatë konfliktit të Kosovës. Studimi kërkimor i bërë nga Rrjeti i Grave të Kosovës në vitin 2008 kishte për qëllim përcaktimin, për herë të parë, të përhapjes së formave të ndryshme të dhunës ndaj grave dhe ndikimin që ato kanë në shëndetin riprodhues të grave.⁶ Burime të ndryshme të të dhënave u përdorën në një përpjekje për të vlerësuar përhapjen, shpeshësinë dhe pasojat e formave fizike, psikologjike dhe seksuale të dhunës në familje, si dhe përdhunimin gjatë konfliktit. Një anketë e kryer më vonë nga Rrjeti i Grave të Kosovës në vitin 2015 me një mostër prej 1,315 gra dhe burra synonte të maste ndërgjegjësimin dhe përhapjen e dhunës në familje, si dhe qëndrimet ndaj kësaj çështjeje. Anketa tregoi se në vitin 2015, 31% e kosovarëve (20% e burrave dhe 40% e grave) kishin pësuar një formë të dhunës në familje. Dhuna psikologjike ishte më e përhapura, e ndjekur nga dhuna fizike, ekonomike dhe seksuale. Një anketë mbi dhunën në familje realizuar nga UNICEF⁷ me mostër prej 3,474 të anketuarve në tri komunat e Kosovës (Dragash, Gjakovë dhe Gjilan) përdori një pyetësor të administruar vetë. Për shkak të metodologjisë dhe mbulimit gjeografik të kufizuar, si dhe për shkak të përkufizimeve dhe indikatorëve të ndryshëm që u përdorën, gjetjet e saj nuk janë të krahasueshme me anketën e bërë nga OSBE. Gjetjet e anketës së UNICEF-it janë veçanërisht interesante pasi ato hedhin dritë mbi përvojat e dhunës nga partneri intim nga këndvështrimi i të dyja palëve, si gratë ashtu dhe burrat. Sipas këtyre rezultateve, përqindja e përhapjes së dhunës fizike ndaj grave të ushtruar nga partneri intim doli të jetë shumë më e lartë kur burrat u pyetën nëse kishin qenë të dhunshëm ndaj partneres (28% e burrave thanë se kishin ushtruar dhunë kundër partneres së tyre) sesa kur gratë u pyetën për këtë gjë (17% e grave raportuan përjetimin e të paktën një forme dhune fizike). Përhapja e dhunës fizike ishte më e lartë në zonat rurale.

Dy studime të rëndësishme lidhur me dhunën ndaj grave që lidhet me konfliktin janë ai i zhvilluar nga UNIFEM (organizata pararendëse e UN Women) në vitin 2000, menjëherë pas konfliktit dhe nga Rrjeti i Grave të Kosovës i publikuar në vitin 2008. Studimi i UNIFEM-it hedh dritë mbi format e dhunës së ushtruar ndaj grave gjatë konfliktit të viteve 1996-1999 dhe vlerëson shkallë shumë të ultë të raportimit për përdhunimet gjatë luftës, jo më shumë se 4%, gjë që e konfirmon përsëri se ajo që zbulohet (përmes studimit) apo që raportohet (tek institucionet dhe organizatat) është vetëm maja e ajsbergut e dhunës kundër grave, veçanërisht në rastin e formave më të rënda.⁸ Studimi kërkimor i Rrjetit të Grave të Kosovës mbi përhapjen e dhunës me bazë gjinore dhe ndikimin e saj në shëndetin riprodhues të grave siguroi një pasqyrë të vlerësimeve të ndryshme të përhapjes së dhunës dhe pasojat shëndetësore për gratë viktime të këtyre krimeve.

Udhëzim për interpretimin e të dhënave të anketës

6 Studimi kërkimor për Ekstraktin e Dhunës Gjinore në Kosovë dhe ndikimi i saj në Shëndetin Riprodhues të Grave (Prishtinë: Rrjeti i Grave të Kosovës, 2008) parë më 5 prill, 29, gjendet në <https://kosovo.unfpa.org/sites/default/files/pub-pdf/TheExtentofGBVandItsImpactonWomensRH-English1.pdf>

7 UNICEF (2013) Studim mbi dimensionin e dhunës në familje, dhunës në baza gjinore në komunat e Kosovës*: Dragash, Gjakovë dhe Gjilan, qasur më 2 tetor 2019, në dispozicion në https://www.unicef.org/kosovoprogramme/media/156/file/Final_Gender_based_violence_ENG.pdf

8 Nuk ka vend të sigurt: Vlerësimi i dhunës së ushtruar kundër gruas në Kosovë (Prishtinë: Fondi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara për Gratë, 2000), hapur më 5 prill 2019, gjendet në <http://iknowpolitics.org/en/2007/02/no-safe-place-assessment-violence-against-women-kosovo>.

Aty ku nuk dalin llogaritë apo e tejkalojnë 100 përqindëshin, kjo mund të jetë për shkak të rrumbullakosjes, përjashtimit të përgjigjeve "nuk e di", ose për faktin se të anketuarat kanë dhënë përgjigje të shumëfishta ndaj pyetjeve të caktuara.

Privatësia, anonimiteti dhe mbrojtja e të dhënave personale

Intervistat u zhvilluan sy më sy nga intervistuese femra të trajnuara dhe me përvojë. Përpunimi i të dhënave, të mbledhura përmes mënyrave automatike (intervista të zhvilluara në privatësi dhe me përdorimin e një tableti), u bë në përputhje me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale, duke përfshirë duke iu ofruar respondentëve opsionin e dhënies së pëlqimit të lirë, specifik, të informuar dhe të qartë. Gratë e intervistuarat u informuan se të gjitha të dhënat e grumbulluara do të ishin konfidenciale dhe anonime.

Format e dhunës të mbuluara në anketë

Gjetjet e paraqitura në këtë raport kanë për bazë një sërë pyetjesh të bëra në kuadër të anketës së udhëhequr nga OSBE në lidhje me dhunën ndaj grave nga një partner intim ose dikush që nuk është partner, si dhe rastet e ngacmimit seksual, përndjekjes, dhunës në fëmijëri dhe ndikimit të konfliktit në dhunën me bazë gjinore. Pyetësi është bazuar në përkufizimet e përcaktuara me Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit).⁹

Për ta matur përhapjen (e raportuar) të çdo lloji të dhunës, gratë u pyetën nëse ato kishin përjetuar forma të ndryshme të dhunës në periudha të ndryshme referimi siç është paraqitur në hollësi në kapitujt 4 dhe 5 të këtij raporti.

- **Dhuna fizike dhe dhuna seksuale**, lista e pyetjeve të bëra në anketë mund të gjendet në Kapitullin 4 në faqen 37.
- **Dhuna psikologjike**, lista e pyetjeve të bëra në anketë mund të gjenden në Kapitullin 4 në faqen 42.
- **Përndjekja**, pyetjet që iu drejtuan grave të anketuara gjenden në Kapitullin 4 në faqen 44.
- **Ngacmimi seksual**, pyetjet që iu drejtuan grave të anketuara gjenden në Kapitullin 4 në faqen 45.

Në këtë raport hulumtues, termi **dhunë në fëmijëri** i referohet dhunës para moshës 15 vjeçare. Një listë e pyetjeve për përvojat e dhunës gjatë fëmijërisë mund të gjenden në Kapitullin 4 në faqen 38. Pyetjet, metodologjia dhe mosha e të anketuarave pjesë e anketës së udhëhequr nga OSBE-ja dallon nga ato të përdorura në anketat për Përvojat e Hidhura Fëmijërore¹⁰ si dhe Anketat me Grumbuj Indikatorësh të Shumëfishtë¹¹ dhe, për rrjedhojë, shkallët e përhapjes së dhunës në fëmijëri nuk janë të krahasueshme.

Sa i përket kapitullit për konfliktin dhe dhunën me bazë gjinore (Kapitulli 5), për qëllimet e këtij studimi konflikti i armatosur u përcaktua si luftim i armatosur midis dy ose më shumë grupeve të organizuara, sulme ndaj komuniteteve ose pasiguri e përgjithshme e shkaktuar nga konflikti, ndërsa gratë e konsideruara të prekura direkt

⁹ Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit, Këshilli i Evropës, 2011), <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=090000168046031c>, qasur më 22 shtator 2019, accessed on 22 September 2019

¹⁰ Organizata Botërore e Shëndetësisë, Përvojat negative të fëmijërisë, pyetësor ndërkombëtar (ACE-IQ) parë më 26 mars 2019, https://www.who.int/violence_injury_prevention/violence/activities/adverse_childhood_experiences/en/

¹¹ UNICEF, Anketat me Grumbuj Indikatorësh të Shumëfishtë (MICS) parë më 26 mars, https://www.unicef.org/statistics/index_24302.html

nga konflikti janë ato që kanë jetuar në një situatë kur pati një konflikt të armatosur aktiv për një periudhë prej së paku një javë dhe që u përgjigjën "po" të paktën në një prej pyetjeve listuara në faqen 41 të Kapitullit 5.

Partnerët përfshijnë individë me të cilët ishin të martuara të anketuarat, me të cilët bashkëjetonin ose me të cilët ishin në një lidhje por nuk bashkëjetonin.

Jopartnerë përfshijnë të gjithë kryerësit tjerë të aktit të dhunës, përveç partnerit aktual apo të mëhershëm të grave.

Incidenti më i rëndë përkufizohet si incidenti me ndikimin më të madh tek gratë e anketuara, qoftë ky ndikim fizik ose psikologjik.

Përmbledhje e studimit cilësor

Pesëmbëdhjetë ekspertë kyç të cilët punojnë në Kosovë ndanë pikëpamjet e tyre mbi gjendjen aktuale se si po punojnë institucionet qeveritare dhe OJQ-të për të parandaluar DHNGV, çfarë mbështetje ka në dispozicion për gratë që kanë përjetuar DHNGV dhe çfarë përmirësimesh rekomandojnë. Grupi i ekspertëve përfshin përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe institucioneve qeveritare dhe joqeveritare.

Janë realizuar tetë diskutime në formë fokus grupesh me gra të moshave të ndryshme (gratë e rritura nën 30 vjeç, mbi 50 dhe gratë e moshës së mesme), gra që jetojnë në zonat urbane dhe rurale të Kosovës, gra nga grupe të ndryshme etnike (shqiptarë të Kosovës, serbë të Kosovës, ashkali, goranë të Kosovës dhe malazezë të Kosovës) si dhe gra të cilat kanë përjetuar konflikte. Qëllimi i diskutimeve ishte:

- Të kuptohen qëndrimet shoqërore ndaj grave në përgjithësi dhe të kuptohet DHNGV dhe kryerësit e një dhune të tillë;
- Të shikohet se si kanë ndryshuar qëndrimet ndaj DHNGV me kalimin e kohës, përfshirë në kohë të konfliktit.
- Të hulumtohet shkalla e vetëdijesimit të grave për masat ekzistuese të mbështetjes, pikëpamjet e tyre për ato masa dhe çdo pengesë që mund t'ua pamundësojë atyre qasjen në mbështetje; dhe
- Të identifikohet se si mund të përmirësohen parandalimi dhe mbështetja.

Janë realizuar dhe katër intervista shumë të detajuara me të mbijetuarat e dhunës, përfshirë gratë me aftësi të kufizuara apo probleme shëndetësore afatgjate. Qëllimi i diskutimeve ishte:

- Të hulumtohen format e dhunës që gratë kanë përjetuar gjatë gjithë jetës së tyre dhe ndikimi i konfliktit;
- Të identifikohen pengesat në zbulimin e përvojave dhe për kërkimin e mbështetjes, dhe të shqyrtohen arsyet pse disa gra zgjedhin t'i zbulojnë përvojat e tyre ndërsa tjerat ngurrojnë;
- Të kuptohet mbështetja e marrë, të identifikohen boshllëqet në ofrimin e shërbimeve, si dhe të identifikohen nevojat e paplotësuara të grave nga radhët e grupeve të caktuara pakicë (p.sh. gra nga një pakicë etnike ose me aftësi të kufizuara); dhe
- Për gratë të cilat kanë pasur qasje në asistencë (formale apo joformale), të kuptohet se si ato kanë arritur të kenë qasje në këtë mbështetje dhe ndikimi që ka pasur kjo tek ato.



2. Konteksti ligjor, institucional dhe i politikave >>

Anketë për mirëqenien dhe sigurinë e grave në Kosovë



Foto: Yllka Fetahaj

2. Konteksti ligjor, institucional dhe i politikave

Ky kapitull shqyrton shkurtimisht kontekstin, legjislacionin kryesor të Kosovës lidhur me dhunën ndaj grave,¹² parandalimin dhe mbrojtjen e grave nga dhuna, grumbullimin e të dhënave dhe ndikimin e konfliktit tek gratë. Ai mbështetet në shqyrtimin e literaturës dhe pikëpamjet e 15 ekspertëve kryesorë të cilët janë intervistuar.

Hyrje

Dhuna ndaj grave dhe vajzave (DHNGV) ndikon në jetën e miliona grave dhe vajzave dhe pengon përparimin drejt sigurisë gjithëpërfshirëse për të gjithë. Si organizata më e madhe rajonale e sigurisë në botë, OSBE pranon që DHNGV jo vetëm që prekë sigurinë personale të grave, por gjithashtu pamundëson pjesëmarrjen e tyre në shoqëri ose t'i përdorin aftësitë dhe njohuritë e tyre me potencial të plotë.

Anketa udhëhequr nga OSBE-së u përqendrua në dhunën me bazë gjinore ndaj grave të kryer nga partnerët e tyre, anëtarët e familjes, miqtë, të njohurit dhe kolegët, si dhe kryerësit e panjohur.

Dhuna ndaj grave është një shkelje e të drejtave dhe lirive themelore të grave dhe një manifestim i marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të pushtetit midis burrave dhe grave.¹³ Meqenëse pabarazia gjinore qëndron në rrënjët e dhunës me bazë gjinore, është e rëndësishme të merret parasysh konteksti më i gjerë i statusit të grave në rajonin e OSBE-së për vlerësimin e sigurisë dhe mirëqenies së tyre.

Në Kosovë, ashtu si në rajon dhe në mbarë botën përgjithësisht, këto pabarazi strukturore janë të dukshme në fusha të ndryshme: pjesëmarrje politike dhe ekonomike; qasje në pasuri, të ardhura dhe shërbime; pjesëmarrje në ekonomi; dhe në standardet e jetesës dhe cilësinë e jetës.

Gratë në Kosovë nuk janë të përfaqësuara sa duhet në pozita të pushtetit politik dhe, për rrjedhojë, nuk janë në gjendje të ndikojnë në politika, ligje dhe reforma që formësojnë zhvillimin socio-ekonomik në të njëjtën masë sa burrat. Gratë përbëjnë më pak se një të tretën (31.9%) e deputetëve të Kuvendit, dhe është vetëm një grua në qeveri, që përbën vetëm 4.2% të totalit.

¹² Trafikimi i qenieve njerëzore dhe, më konkretisht, trafikimi i grave dhe vajzave për qëllime të shfrytëzimit seksual është një formë e dhunës me bazë gjinore ndaj grave. Është një çështje serioze e të drejtave të njeriut dhe e sigurisë. Ky studim nuk përfshin pyetje mbi këtë lloj të dhunës, meqë studimi i trafikimit të qenieve njerëzore përfshin një rrezik shumë të lartë për viktimat e saj dhe një studim i ekonomive familjare nuk është metoda e përshtatshme kërkimore në këtë rast. Anketa e ADTH, në të cilën është bazuar anketa e zhvilluar nga OSBE, nuk ka hetuar trafikimin e grave dhe as të vajzave.

¹³ Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, 1994.

<https://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/ViolenceAgainstWomen.aspx>, qasur më 22 shtator 2019

Gratë nuk marrin pjesë në ekonomi mbi baza të barabarta me burrat. Ato nuk janë përfaqësuar sa duhet në tregun e punës dhe kompanitë preferojnë të punësojnë burra në vend të grave. Shkalla e aktivitetit të tyre është 17.4%, që është shumë më e ulët se sa për burrat (63.1%) dhe paraqet një nga nivelet më të ulëta të pjesëmarrjes së grave në forcën punëtore në botë.¹⁴ Shkalla e punësimit në mesin e grave në moshë pune (15-64) është 12.0%, përsëri vetëm sa çereku i burrave (44.8%).¹⁵ Një prej arsyeve kryesore pse gratë kanë pjesëmarrje më të ultë në fuqinë punëtore është tendenca e tyre për të marrë më shumë përgjegjësi familjare dhe punë pa pagesë në shtëpi. Mesatarisht, gratë i kalojnë tre orë pune pa pagesë në ditë duke u marrë me punë shtëpie.¹⁶ Gratë në Kosovë përfaqësojnë vetëm 10% të pronarëve të bizneseve, kryesisht biznese mikro dhe të vogla,¹⁷ dhe vetëm 20% e grave kanë pronë në emër të tyre.¹⁸

Pabarazitë gjinore janë të rrënjosura në normat patriarkale. Një studim i OSBE /UNFPA i vitit 2018, i quajtur Këndvështrimi i burrave mbi barazinë gjinore në Kosovë tregoi se qëndrimet tradicionale ende mbizotërojnë¹⁹ Gati shtatë nga dhjetë burra pjesë e studimit (69.5%) u pajtuan që burri "duhet të ketë fjalën e fundit në lidhje me vendimet në shtëpinë e tij". Një përqindje e ngjashme (72.8%) besojnë se roli më i rëndësishëm i një gruaje është të kujdeset për shtëpinë dhe familjen e saj, dhe 72.5% e burrave besojnë se një grua duhet të kujdeset për fëmijët e saj. Siç raportohet nga burrat, ndarja e detyrave shtëpiake bëhet sipas gjinisë, ku gratë kryejnë detyra që kryhen tradicionalisht nga gratë në shumicën e rasteve, siç është larja e rrobave (kryer në 88% të rasteve nga partnerët femra), gatimi (80 % femrat) dhe pastrim (71% femrat). Një analizë e vitit 2017 e librave shkollorë të përdorur në shkollën e mesme të lartë, gjeti stereotipe të konsiderueshme gjinore, p.sh., pohime se "truri i mashkullit dhe i femrës është i lidhur ndryshe: truri i mashkullit mëton të bëjë e truri i femrës të flasë". Tekstet shkollorë i portretizojnë gratë si të kujdeshme, miqësore dhe të hapura, ndërsa burrat shihen si konkurrues dhe mbizotërues, duke forcuar stereotipet gjinore dhe normat tradicionale gjinore.²⁰

Dhuna ndaj grave mund të kuptohet dhe adresohet plotësisht vetëm brenda këtij konteksti, pasi instrumentet në dispozicion për ta eliminuar atë janë të kufizuara ose të përforcuara nga veprimet në fusha të tjera në të cilat gratë nuk janë të barabarta.

14 "Hulumtim i Fuqisë Punëtore në Kosovë, Q2 2018", Agjencia Kosovare e Statistikave 17 shtator 2018, parë më 5 prill 2019, <http://ask.rks.gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/add-news/labor-force-survey-in-kosovo-q2-2018>.

15 Po aty.

16 Gratë në fuqinë punëtore: Analizë e kushteve të fuqisë punëtore për gratë në Kosovë (Prishtinë: Instituti Riinvest, 2017), f.10, parë më 5 prill 2019.

https://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2017/November/10/Women_in_the_workforce1510308291.pdf.

17 Po aty, f. 9.

18 Sandra Joireman, Midterm National Survey on Property Rights in Kosovo Burlington, VT: Tetra Tech and USAID, 2017), qasur më 5 prill 2019, https://www.land-links.org/wp-content/uploads/2018/03/USAID_Land_Tenure_PRP_Midterm_National_Survey_Kosovo.pdf.

19 Një këndvështrim i burrave mbi barazinë gjinore në Kosovë: Gjetjet kryesore nga Anketa Ndërkombëtare Burrat dhe Barazia Gjinore (IMAGES) (Prishtinë, Misioni i OSBE-së, 2018), qasur më 5 prill 2019, <https://promundoglobal.org/wp-content/uploads/2018/07/IMAGES-Kosovo-English.pdf>.

20 Gjuha diskriminuese në librat shkollorë – Analizë e librave shkollorë të shkollës së mesme të lartë", Iniciativa Rinore për të Drejtat e Njeriut, 2017

2.1: Korniza legislative e Kosovës dhe implementimi

Legjislacioni në Kosovë është në përputhje me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut nëpërmjet Kushtetutës së saj, e cila parashikon zbatim të drejtpërdrejtë të normave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Institucionet e Kosovës ende nuk e kanë ratifikuar Konventën për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW) dhe Konventën e Stambollit. Megjithatë, CEDAW është përfshirë në nenin 22 të Kushtetutës. Në vitin 2019, Gjykata Kushtetuese shqyrtoi ndryshimin e kushtetutës në pajtim me Konventën e Stambollit me propozim të tetë deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Gjykata nxori vendim pozitiv mbi këtë çështje dhe i mundësoi Kuvendit të Kosovës që të votojë për miratimin e ndryshimit në të ardhmen e afërme.

Legjislacioni i Kosovës mbulon barazinë gjinore, dhunën në familje, ngacmimin seksual, sulmet seksuale dhe fizike, përdhunimin brenda martesës, raportimin e detyrueshëm dhe grumbullimin e të dhënave të kategorizuara sipas gjinisë. Ligji për mbrojtjen nga dhuna në familje synon të parandalojë dhunën në familje dhe të mbrojë të mbijetuarit e saj.²¹ Ai ofron një përkufizim të hollësishëm të dhunës në familje si forma të ndryshme të dhunës fizike, seksuale, psikologjike dhe ekonomike të kryera ndaj një personi në një marrëdhënie familjare, dhe përfshin sigurimin e urdhrave të mbrojtjes emergjente dhe mbrojtjes afatgjatë. Sipas Kodit Penal (nr. 04/L-082, 2012), nëse një vepër penale (si vrasja ose lëndimi i rëndë trupor) kryhet brenda një marrëdhënieje familjare, përbën një formë të rëndë të veprës penale.²² Kodi i ri Penal i Kosovës (2019)²³, i cili u botua në Gazetën Zyrtare më 14 janar 2019 dhe hyri në fuqi në prill 2019, përcakton akte të reja kriminale të dhunës në familje (neni 248) dhe ngacmimit seksual (neni 183). Ligji për barazi gjinore²⁴ ndalon ngacmimin seksual, dhunën me bazë gjinore, viktimizimin dhe përfaqësimin e pabarabartë. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi vendosë një kornizë të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në çfarëdo baze, duke përfshirë gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, si dhe dhunën në familje dhe atë gjinore.²⁵ Ligji për kompensimin e viktimave të krimit krijoi Programin për kompensim të viktimave të krimit për viktimat e krimeve të dhunshme dhe të vartësve të tyre.²⁶

Si ekspertët e intervistuar (nga qeveria, shoqëria civile dhe organizatat ndërkombëtare) ashtu edhe literatura kryesore (legjislacioni lidhur me DHBGJ, politikat përkatëse, planet e veprimit dhe raportet e qeverive si dhe raportet nga organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare dhe statistikat relevante) e konsultuar për këtë raport, përshkruajnë përmirësime në legjislacionin, strategjitë dhe veprimet që kanë të bëjnë me dhunën ndaj grave në 10 vitet e fundit. Megjithatë, janë shprehur shqetësime në lidhje me pengesat kulturore dhe institucionale përkitazi me efikasitetin e kornizës legislative:

- Pengesat kulturore mbesin ende. Ekspertët kanë thënë se disa zyrtarë vazhdojnë ende me idenë se disa lloje të caktuara të dhunës kundër grave janë të pranueshme nga aspekti kulturor dhe fajësojnë gratë për krimet e kryera kundër tyre, veçanërisht në lidhje me dhunën seksuale.²⁷
- Disa ekspertë konsideruan se legjislacioni zbatohet pak dhe në mënyrë të parregullt, duke thënë se ai kryesisht trajton dhe merret me "dhunën në familje" e jo me "dhunën ndaj grave".

21 Ligji nr. 03/L-1822 për mbrojtje nga dhuna në familje, 10 gusht 2010, Kosovë, në dispozicion në: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-182-eng.pdf>

22 Kodi Penal i Kosovës nr. 04/L-082, 13 korrik 2012, hyri në fuqi më 1 janar 2013 Gjetet në <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Criminal%20Code.pdf>.

23 Kodi Penal i Kosovës nr. 06/L-074, 14 janar 2019, gjendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>;

24 Ligji nr. 05/L020 për Barazi Gjinore, 26 qershor 2015 gjendet në <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10923>.

25 Ligji nr. 05/L-21 për mbrojtje nga diskriminimi, 26 qershor 2015 në dispozicion në: <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10924>;

26 Ligji nr. 05/L/036 për kompensimin e viktimave të krimit, 30 qershor 2015, gjendet: <http://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10936>

27 Kosovo Women's Network, 'No More Excuses: An Analysis of Attitudes, Incidence, and Institutional Responses to Domestic Violence in Kosovo' (2015), accessed 2 October 2019 <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20151124105025622.pdf>.

- Në mesin e praktikuesve ka mungesë njohurish në lidhje me ngacmimin seksual, përkufizimin e tij, kuadrin ligjor gjegjës dhe procedurat përkatëse për adresimin e tij.²⁸
- Janë identifikuar sfida sa i përket monitorimit dhe sigurimit të zbatimit të Strategjisë kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Kosovë 2015-2019.²⁹

2.2: Mekanizmat institucionalë dhe bashkëpunimi

Strategjia dhe plani i veprimit për mbrojtjen nga dhuna në familje 2016-2020³⁰ synon të promovojë dhe institucionalizojë një shoqëri të barabartë dhe zero tolerancë ndaj dhunës në familje. Në Kosovë ka Koordinator kundër Dhunës në Familje (Zëvendësministri i Drejtësisë), Njësi kundër Dhunës në Familje në kuadër të Policisë së Kosovës, Zyrë për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave në kuadër të Zyrës së Kryeprokurotit, Divizion për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë dhe qendra për punë sociale në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.³¹ Në nivel lokal, ekzistojnë zyrtarë të caktuar për barazi gjinore (në të gjitha komunat) dhe mekanizmat komunal të koordinimit për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe koordinatorët për mbrojtjen nga dhuna ndaj grave.

Institucionet kanë bashkëpunuar në forma të ndryshme për çështje që lidhen me dhunën gjinore:

- Ministria e Shëndetësisë ka punuar me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për të zhvilluar një protokoll mjekësor për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe për të ofruar trajnime për profesionistët shëndetësorë.
- Procedurat standarde të veprimit për mbrojtjen nga dhuna në familje u shpërndanë në vitin 2013 nga Agjencia për Barazi Gjinore, së bashku me Protokollin për parandalimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar.³² Qëllimi i tyre është sigurimi i ndihmës dhe mbështetjes cilësore për trajtimin e rasteve të dhunës në familje.
- Ekzistojnë Procedura standarde të veprimit dhe standarde minimale të kujdesit për viktimat e trafikimit si dhe Procedura standarde të veprimit kundër trafikimit të qenieve njerëzore.
- Zyra për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave në kuadër të Zyrës së Kryeprokurotit punon me policinë dhe të gjitha institucionet përkatëse e ofruesit e shërbimeve për zbatimin e Procedurave standarde të veprimit për mbrojtje dhe ndihmë e viktimave (2013)³³, të cilat zbatohen për të gjitha viktimat e krimin.

2.3: Disponueshmëria e të dhënave administrative dhe të tjera

Të dhënat statistikore, të kategorizuara sipas gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, aftësisë së kufizuar, vendndodhjes gjeografike dhe prejardhjes socio-ekonomike, janë të nevojshme për një vlerësim të saktë të situatës së grave, pabarazive gjinore dhe shtrirjes dhe natyrës së dhunës kundër grave. Pa të dhëna, nuk është e mundur të merren veprime të bazuara në prova.

Edhe pse institucionet që ofrojnë shërbime dhe mbrojtje për të mbijetuarit regjistrojnë rastet individuale të dhunës, ndryshimet në përmbajtje dhe metodologji pengojnë

²⁸ Po aty.

²⁹ Grupi i Ekspertëve për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (GRETA), "Raport mbi pajtueshmërinë e Kosovës* me standardet e Konventës së Këshillit të Evropës për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore", miratuar në 22 Dhjetor 2015, botuar në 12 Prill 2016, faqe 47–48, qasur 5 Prill 2019, <https://rm.coe.int/16806454cc>.

³⁰ "Strategjia e Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit është në dispozicion në gjuhë angleze dhe në shqipe: <https://abgi.rksgov.net/assets/cms/uploads/files/Publikimet%20ABGI/Strategjia%20Komb%C3%ABtare%20e%20RK%20p%C3%ABr%20mbrojtje%20nga%20dhuna%20në%20familje%202016-2020.pdf>

³¹ Zëvendësministri i brendshëm është edhe koordinator kundër trafikimit me qenie njerëzore.

³² Opsionet e Politikave mbi Dhunën në Familje/Dhunën në Baza Gjinore në Kosovë: Gjetja e zgjidhjeve për ti dhënë fund DHF/DHGJ (Prishtinë: UNICEF Kosovë, 2013), https://www.unicef.org/kosovoprogramme/Final_Policy_Options_English_web.pdf.

³³ "Procedurat Standarde të Veprimit për Zyrën për Mbrojtjen dhe Asistencë të Viktimave", Zyra e Kryeprokurorit, 18 tetor, 2013, qasur më 5 prill 2019, http://www.psh-ks.net/repository/docs/No.1202.2013_Directive_on_SOP_FOR_THE_VPAO.pdf.

përpilimin e të dhënave gjithëpërfshirëse duke e bërë më të vështirë reagimin efektiv të institucioneve dhe duke rritur rrezikun e ritraumatizimit për gratë që kanë kërkuar ndihmë.

Në mars të muajit 2019 institucionet përkatëse qeveritare nënshkruan një memorandum mirëkuptimi për një bazë të integruar dhe të unifikuar të të dhënave për rastet e dhunës në familje. Kjo bazë e të dhënave do të mundësojë monitorimin dhe ndjekjen penale të rasteve të dhunës në familje në Kosovë, dhe siguron llogaridhënie, duke detyruar institucionet përkatëse që ta ushqejnë bazën e të dhënave me informacionin e nevojshëm nga niveli qendror dhe lokal.

Një bazë e unifikuar e të dhënave do të mbështesë institucionet përkatëse në reagime më efektive ndaj dhunës në familje dhe problemet e mëparshme me metodologjitë e ndryshme në regjistrimin e rasteve do të jenë të harruara.

Krahas çështjeve lidhur me mbledhjen e të dhënave mbi rastet e raportuara, ekspertët dhe gratë në këtë hulumtim kanë theksuar se, në disa raste, policia bindte të mbijetuarit se dhuna ishte e vogël dhe se ata duhet të ktheheshin në shtëpi dhe të përpiqeshin të rregullonin çështjen, pra duke mos e raportuar këtë.

Ekspertët që morën pjesë në këtë studim raportuan se të dhënat aktuale në dispozicion nuk e tregojnë plotësisht shkallën e dhunës ndaj grave. Ato përmbajnë vetëm informacionin e atyre që kanë kërkuar ndihmë dhe është e qartë se shumica e incidenteve nuk raportohen.

2.4: Parandalimi, mbrojtja dhe mbështetja

Preventive Ndërhyrjet parandaluese mund të ndihmojnë në rritjen e ndërgjegjësimit, ndërtimin e mirëkuptimit dhe në adresimin efektiv të dhunës ndaj grave.

Në Kosovë janë zhvilluar disa aktivitete të gjera parandaluese:

- Zhvillimi i sistemit të drejtësisë penale në mënyrë që kryerësit të mbahen përgjegjës për veprat që kryejnë. Ekspertët në përgjithësi e konsiderojnë legjislacionin aktual të aftë për t'u marrë me dhunën ndaj grave. Për të siguruar që ky legjislacion kuptohet nga të rinjtë, Protokollin mbi parandalimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar përcakton hapat për të parandaluar dhunën në shkolla. Dhuna në familje dhe shkeljet e tjera të të drejtave të njeriut janë përfshirë në kurrikulat e shkollave fillore. Megjithatë, ekspertët pjesëmarrës në studim ishin të shqetësuar për zbatimin e veprimeve parandaluese për shkak të vazhdimësisë së qëndrimeve dhe normave patriarkale.
- Sigurimi i ndihmës adekuate ligjore, sociale, mjekësore dhe psikologjike për të mbijetuarit. Strategjia e re për mbrojtjen nga dhuna në familje (dhe Plani i veprimit) 2016-2020 synon të promovojë dhe institucionalizojë një shoqëri të barabartë dhe me zero tolerancë ndaj dhunës në familje. Është shumë herët për ta vlerësuar Strategjinë, por ekspertët në përgjithësi e konsiderojnë atë si një hap të madh në drejtimin e duhur.
- Organizimi dhe realizimi i fushatave të informimit dhe edukimit nga institucionet dhe OJQ-të, veçanërisht brenda sistemit arsimor. Fushata e përvitshme e vetëdijesimit, "16 Ditët e Aktivizmit", bashkërendohet nga Grupi për Siguri dhe Barazi Gjinore³⁴ dhe përfshinë një mori aktivitete të ndryshme. Përveç kësaj, një numër institucioneve publike, civile dhe ndërkombëtare organizojnë aktivitete të posaçme dhe fushata ndërgjegjësimi.

Një sërë trajnimesh janë mbajtur për profesionistë të drejtësisë, zyrtarët e zbatimit të ligjit dhe stafin tjetër profesional, të mbështetur nga organizma të shumtë ndërkombëtarë – përfshirë këtu Ambasadën e SHBA, Ambasadën Britanike dhe OSBE-

në. Ekspertët e intervistuar për këtë raport thanë se trajnimet kanë pasur ndikim pozitiv. Trajnimet në fjalë kryesisht shqyrtojnë dhe elaborojnë mbi legjislacionin në fuqi dhe përgjegjësitë e secilit institucion. Megjithatë, sipas ekspertëve të intervistuar, duket të mos kenë qenë të bashkërenduar. Aktualisht nuk ekziston një program i veçantë dhe i standardizuar efektiv për kryerësit e akteve të dhunës ndaj grave, ndonëse Strategjia e re parashikon krijimin e një programi të tillë në të ardhmen.

Në Kosovë operojnë rreth tetë strehimore për të mbijetuarit e dhunës në familje³⁵, nën drejtimin e OJQ-ve, duke përfshirë një në Novobërdë, zonë kjo kryesisht e banuar nga serbë të Kosovës, e cila aktualisht është në proces të licencimit për të ofruar shërbime. Ka disa shërbime për përkrahje psikologjike, ndonëse jo aq sa duhet. Linjat ndihmëse 24-orëshe drejtohen nga Policia e Kosovës dhe nga Zyra e Operatorëve të Ndihmës brenda Zyrës për Avokim dhe Ndihmë për Viktimat, ose nga Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit (me mbështetjen e OSBE-së). Gjithashtu, ekzistojnë disa shërbime të këshillimit ligjor përmes një rrjeti të zyrave të ndihmës juridike dhe shërbimeve të ndryshme të arsimit, aftësimin dhe mbështetjes për punësim. Raporti i OSBE-së i vitit 2019 "Strehimoret për viktimat e dhunës në familje në Kosovë" identifikoi një numër sfidash me të cilat përballen strehimoret për të ofruar shërbime, veçanërisht mungesën e financimit të qëndrueshëm, që vjen për shkak të mungesës së dispozitave të qarta institucionale për financim. Në mesin e sfidave të tjera të identifikuara janë³⁷:

- Mungesa e pronësisë së qeverisë mbi strehimoret dhe e vullnetit për t'i njohur ato si pjesë e sistemit të drejtësisë, e jo thjeshtë vetëm si ofrues të shërbimeve me status të OJQ-së;
- Takime të rralla të mekanizmave komunalë për mbrojtjen nga dhuna në familje;
- Në rastin e strehimores në Novobërdë, procesi i tejzgjatur i licencimit i lidhur me mosnjohjen e titujve/diplomave të marra në Serbi;
- Mungesa e trajnimeve për stafin e strehimoreve mbi politikën dhe kornizën ligjore të lidhur me dhunën në familje;
- Mungesa e trajnimeve për stafin e strehimoreve për përballje me stresin në punë dhe me mjediset sfiduese emocionale;
- Mungesa e automjeteve për strehimoret (Ferizaj, Prishtinë, Novobërdë dhe Mitrovicë Jugore);
- Stigma lidhur me punësimin e viktimave të dhunës në familje që pengon procesin e riintegritimit;
- Rrogat shumë të ulëta për punonjësit me orar të plotë në strehimore: 160–250 € në muaj varësisht nga funksioni i punëtorit.

Në përgjithësi, ekspertët kanë qenë kritikë ndaj masave aktuale parandaluese dhe mbrojtëse. Ata janë shprehur të shqetësuar për mungesën në përgjithësi të mbështetjes institucionale për të mbijetuarat e dhunës ndaj grave, mbështetjes jo të përshtatshme financiare për gratë, varësinë e tepruar në OJQ-të dhe donatorë të tjerë, dyshime për sa i përket qëndrueshmërisë së shërbimeve mbështetëse, dyshime për

34 Grupi i Sigurisë dhe Barazisë Gjinore është një grup i përbërë nga hisedarë të ndryshëm, grupi kryesor i udhëhequr nga UN Women dhe nëngrupi për Dhunën Gjinore/Dhunën në Familje, të udhëhequr nga Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe Rrjeti i Grave të Kosovës, Shih ueb-faqen e Rrjetit i Grave të Kosovës në <http://www.womensnetwork.org/?FaqeID=1&n=451>.

35 Gjilan (1999), Prishtinë (2000), Pejë (2001), Gjakovë (2002) dhe Prizren (2002) Mitrovicë e Jugut (2007), Ferizaj (2014) dhe Novobërdë (2018).

36 Këshilli Prokurorial i Kosovës, 'Rregullorja për Strukturën dhe Funkcionimin e Mandatit të Zyrës për Mbrojtjen dhe Asistencën e Viktimave', http://www.psh-ks.net/repository/docs/REGULATION_FOR_THE_MANDATE_STRUCTURE_AND_FUNCTION_OF_THE_VPAO.pdf;ajs

37 "Strehimoret për viktimat e dhunës në familje në Kosovë", OSBE, Misioni në Kosovë, 2019, qasur më 5 prill 2019, <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/409136>.

sa i përket cilësisë dhe nivelit të trajnimit për ofrues të shërbimeve, mbështetjen dhe trajnimet joadekuate për të mbijetuarat për t'u ndihmuar të krijojnë një jetë dhe punë të re, si dhe mungesën e komunikimit me të mbijetuarat lidhur me mbështetjen në dispozicion të tyre.

2.5: Pasojat e konflikteve për gratë

Nuk ka asnjë të dhënë zyrtare për numrin e rasteve të dhunës ndaj grave që rezultojnë nga konflikti i Kosovës. Incidentet u raportuan kryesisht në Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK).

Kodi Penal i Kosovës³⁸ mbulon krimet e luftës “në shkelje të rëndë të Konventës së Gjenevës”, me qëllim të shkakimit të vuajtjeve të mëdha ose dëmtim të rëndë për trupin ose shëndetin, përdhunimin dhe ngacmimin seksual (neni 150). Disa OJQ ofrojnë mbrojtje dhe mbështetje për viktimat e dhunës së ushtruar ndaj grave që lidhet me konfliktin, në mesin e të cilave edhe Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës, Medica Kosova dhe Medica Gjakova.

Ligji për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave të dhunës seksuale të luftës, viktimave civile dhe familjarëve të tyre³⁹ parasheh kompensim për të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë konfliktit gjatë periudhës së konfliktit nga 27 shkurti 1998 deri më 20 qershor 1999. Ekspertët e intervistuar për këtë raport bënë të ditur se arsyeja përse një gjë e tillë nuk ishte ndërmarrë më parë ishte sepse shumë viktima nuk e kishin raportuar dhunën e përjetuar për shkak të ndjeshmërisë së çështjes.

Një tjetër aspekt i ndikimit të konfliktit në dhunën ndaj grave është numri i armëve të zjarrit që mbahen nga civilët, dhe atë kryesisht në duart e burrave e jo të grave. Raporti i 2016 i UNDP/SEESAC thekson se burrat rrallëherë janë viktima të vrasjes nga parterët intimë, e që tregojnë natyrën me bazë gjinore të dhunës në familje: "Prania e armëve të zjarrit në incidentet e dhunës në familje prek gratë shumë më shpesh sesa burrat."⁴⁰ Tutje, po i njëjti raport thekson se krahas mundësisë së një përfundimi fatal, prania e armëve të zjarrit në dhunën në familje ka një varg pasojash të rënda sepse "shpesh përdoret për të nxitur dhunë psikologjike, fizike, seksuale, ekonomike dhe forma të tjera të saj, për të ushtruar kontroll të përgjithshëm mbi gratë, i cili [ka] efekte të dëmshme në sigurinë e grave "

38 Kodi Penal i Kosovës nr. 04/L-082, 13 korrik 2012, hyri në fuqi më 1 janar 2013 Gjetet në <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Criminal%20Code.pdf>

39 "Ligji nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Dhunës Seksuale Viktima të Luftës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre", 31 dhjetor 2011, në dispozicion në <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2793>.

40 Dragan Bozhaniq, Gjinia dhe armët e vogla dhe të lehta në Evropën Juglindore:: Brengat kryesore dhe Reagimi me Politika (Beograd: Clearinghouse i Evropës Juglindore dhe Lindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta, 2016), qasur 5 Prill 2019, http://www.seesac.org/f/docs/Armed-Violence/Gender_and_SALW_publication_eng-web.pdf.

57%

Më shumë se gjysma e grave të moshës 18-74 vjeç në Kosovë besojnë se miqtë e tyre do të pajtoheshin me idenë se "një grua e mirë i bindet burrit të saj edhe nëse ka tjetër mendim."

26%

Pak më shumë se një e katërta e grave besojnë se miqtë e tyre do të pajtoheshin me idenë se "gruaja e ka për obligim të kryejë marrëdhënie seksuale me bashkëshortin edhe nëse ajo nuk ka dëshirë."

48%

Gati gjysma e grave në Kosovë pajtohen me idenë që dhuna në familje është çështje private dhe duhet të trajtohet brenda familjes.

64%

Gati dy të tretat e grave mendojnë që, përgjithësisht, dhuna e ushtruar ndaj grave nga partneri, të njohurit apo të panjohurit është goxha apo mjaft e rëndomtë në Kosovë.

3. Qëndrimet ndaj roleve gjinore dhe dhunës ndaj grave

Studimi tregon se normat dhe qëndrimet e rrënjosura thellë në Kosovë kanë për pasojë vazhdimin e pabarazisë gjinore me role dhe pritshmëri gjinore të përcaktuara qartë për burrat dhe gratë.

Në studimin cilësor, gratë kanë vënë në dukje që si burrat ashtu edhe gratë kanë role tradicionale gjinore. Nga gratë gjithmonë është pritur që të merren me shtëpinë dhe të kujdesen për familjen, ndërsa nga burrat është pritur që të sjellin të ardhurat për familjen. Ndërkohë që po bëhet gjithnjë e më e pranueshme për gratë që të punojnë jashtë shtëpisë, megjithatë, sipas grave të cilat morën pjesë në studimin cilësor, për këtë gjë vendosë shpesh burri dhe se ky vendim nuk zëvendëson e as pakëson asnjë nga përgjegjësitë e saj në shtëpi.

"Në lagjen time ka [gra] që punojnë, por që, megjithatë, me t'u kthyer nga puna e kanë për detyrë t'i bëjnë punët e shtëpisë."

Grua, 18-30 vjeç, shqiptare e Kosovës, vendbanim urban

Gratë që kanë marrë pjesë në hulumtimin cilësor kanë thënë që gratë shihen si më emocionale, të kujdesshme dhe më dashamirëse sesa burrat. Ato kanë thënë që është e papranueshme që gratë të shfaqin ndjenja tipike "mashkullore", të tilla si zemërimi ose frustrimi. Ato po ashtu kanë thënë që mohimi i këtyre emocioneve dhe pritja nga to që t'u nënshtrohen burrave është e vështirë dhe e rëndë.

"Familjet tona i kanë mësuar gratë që të heshtin, ta mbajnë në fre zemërimin. Ata thonë: "Shsh vajza ime, duhet të durojmë, burrat kanë gjithmonë të drejtë." Por kjo nuk është e shëndetshme. Ne mbajmë të gjithë zemërimin brenda, derisa shtresat e këtij zemërimi bëhen gjithnjë e më të vështira për t'u duruar, aq sa kur i prek, dhembin."

Grua, 34-55 vjeç, shqiptare e Kosovës, vendbanim urban

Ato gjithashtu kanë deklaruar të kenë më pak liri në shoqëri, si dhe në lidhje romantike. Ato kanë shprehur bindjen që sjellja e tyre vazhdimisht vëzhgohet dhe gjykohet nga të tjerët, si dhe thonë që kjo e ndikon mënyrën në të cilën ato sillen. Veprimet si takimi i një kolegu mashkull jashtë punës mund të interpretohen si marrëdhënie me të, ndërsa ato thonë që do të gjykoheshin negativisht për një gjë të tillë. Këtë gjë e mbështetë dhe studimi sasior, ku një e pesta e grave (20%) thonë se partneri i tyre aktual zemërohet nëse ato flasin me një tjetër burrë, gjersa gati një e katërta (24%) thonë të njëjtën gjë për një partner të mëhershëm. Gratë thonë që, nga ana tjetër, burrat gjykohen për një gjë të tillë dhe janë të lirë të bëjnë çfarëdo të dëshirojnë.

"Mendoj që mentaliteti i prapambetur ka sjellë këtë mos vetëdijesim tek njerëzit. Gratë ngurrojnë të dalin të vetme me një burrë, sepse po ta bënë këtë gjë njerëzit do të thoshin: "Ka diçka këtu". Nuk kemi të drejtë, edhe nëse ky njeri është kolegj i yni, nuk kemi as të drejtë të dalim në pushim dreke apo qoftë edhe të pimë një kafe për shkak të këtyre [thashethemeve], dhe pikërisht ky është problemi. Kjo është ajo që na shqetëson."

Grua, 18-30 vjeç, shqiptare e Kosovës, vendbanim urban

Gratë që kanë marrë pjesë në hulumtimin cilësor shprehën bindjen që liria dhe të drejtat e burrave janë më të rëndësishme se ato të grave në çdo sferë të jetës në Kosovë. Ato kanë thënë që, krahasuar me burrat, gratë janë në situatë më të pafavorshme qoftë në shtëpi, në vendin e punës apo dhe në sferën publike.


"Ndoshta kemi filluar me disa hapa të vegjël dhe gjërat mund të përmirësohen, por, për mendimin tim, si dhe duke parë edhe atmosferën e përgjithshme, të drejtat e grave shkelen. Duke filluar nga familja, dhe në institucione [publike] ... e kudo tjetër, [burrat kanë] më shumë të drejta."

Grua, 20-30 vjeç, serbe e Kosovës, vendbanim urban

Gratë të cilat morën pjesë në hulumtim shprehën gjithashtu mendimin që disa nga këto qëndrime dominuese në marrëdhënie kanë filluar së ndryshuari dalëngadalë. Për shembull, katër në dhjetë gra thonë se miqtë e tyre do të pajtoheshin me idenë që gruaja "duhet të jetë në gjendje që t'i zgjedhë miqtë e saj, edhe nëse bashkëshorti nuk i pëlqen" (42%), ndërsa dy të tretat e grave thonë se miqtë e tyre do të pajtoheshin me idenë që "nëse një burrë e keqtrajton gruan e tij, duhet të ndërhyjnë edhe të tjerët jashtë familjes" (62%) (Figura 3.1). Ngjashëm, 51% thonë se miqtë e tyre nuk do të pajtoheshin me idenë se "është me rëndësi që burri t'i tregojë gruas se kush është shefi" dhe se "gruaja e ka për detyrë të kryejë marrëdhënie seksuale me bashkëshortin, edhe nëse ajo nuk ka dëshirë" (71%).

Figura 3.1: Perceptimet e normave shoqërore dhe sjelljeve të pranueshme

Njerëzit kanë ide të ndryshme për familjen dhe atë çfarë konsiderohen sjellje të pranueshme për burrin dhe gruan. Tregoni nëse miqtë tuaj përgjithësisht do të pajtoheshin apo nuk do të pajtoheshin me deklaratat vijuese.



Dallimet në moshë, arsimim dhe vendndodhje dalin në pah sidomos gjatë analizës së këtyre këndvështrimeve shoqërore në ndryshim e sipër. Përqindja e grave më të reja në moshë (nën 30 vjeç), të cilat thonë që besojnë se miqtë e tyre do të pajtoheshin me idenë se "një grua e mirë i bindet bashkëshortit edhe nëse nuk pajtohet me të" është vetëm sa gjysma e grave më në moshë (44% krahasuar me 82% të atyre të moshës 60+). Derisa pothuajse gjysma e grave më në moshë thonë që "gruaja e ka për detyrë të kryejë marrëdhënie seksuale me burrin e saj edhe nëse nuk ka dëshirë" (45%), vetëm 13% e grave më të reja në moshë janë dakord.

Dallime të tilla të theksuara ka dhe ndërmjet grave nga zonat urbane dhe ato rurale. Për shembull, në rastin e "t'i bindet burrit", dy të tretat e grave të cilat jetojnë në zonat rurale bien dakord me këtë deklaratë (64%), krahasuar me 49% syresh nga zonat urbane, e që ilustron nga dallimi midis rajonit më rural jugperëndimor (68%

3. Qëndrimet ndaj roleve gjinore dhe dhunës ndaj grave

pajtohen) krahasuar me zonën rreth Prishtinës (49%). Të anketuarave iu dhanë nëntë skenarë dhe u pyetën nëse marrëdhëniet seksuale pa dëshirë mund të justifikohen në ndonjërin prej tyre, siç është seksi i detyruar brenda martesës ose partneritetit, ku ose gruaja ose sulmuesi ka qenë duke pirë, ose nëse gruaja ka qenë e veshur në mënyrë provokuese. Të paktën dy të tretat nuk ishin dakord me asnjërin nga skenarët, ndërsa më shumë se gjysma "nuk pajtoheshin aspak". Sidoqoftë, pikëpamjet janë larg nga të qenit unanime. Për shembull, një e katërta e grave (25%) mendojnë se marrëdhëniet seksuale pa dëshirë mund të justifikohen në një martesë ose midis partnerëve që jetojnë së bashku, ose nëse gruaja vullnetarisht shkon në shtëpi me sulmuesin, për shembull pas një feste ose një takimi.

Në studimin cilësor është vënë re gjithashtu dhe një perceptim që gratë ngandonjëherë janë vet përgjegjëse për dhunën fizike që përjetojnë, se ato mund ta kenë provokuar partnerin, si dhe deri në një farë mase, meritonin rrahjen.

"Ka disa gra që vetë e kërkojnë. Si të ishin të çmendura, burrat nuk kanë zgjidhje tjetër veçse t'i rrahin. Për shembull, burri thotë diçka, ajo diçka krejt tjetër ... ose ajo është e acaruar me dikë tjetër dhe vjen e ia nxjerr burrit të saj."


Grua, 34-55 vjeç, shqiptare e Kosovës, vendbanim urban

Siç ilustron tek figura 3.2, një e treta e grave thonë që janë të mendimit se dhuna ndaj grave shpesh provokohet nga viktimja (35%) dhe se gratë të cilat thonë se janë keqtrajtuar shpesh i sajojnë apo ekzagjerojnë pretendimet se janë abuzuar apo përdhunuar (32%).

Për krahasim, 15% e grave në BE mendojnë se dhuna shpesh provokohet nga viktimja, duke filluar nga 6% në Holandë e deri në 58% në Letoni, gjersa 19% e grave në BE (duke filluar nga 7% në Suedi deri në 43% në Maltë) mendojnë se gratë i ekzagjerojnë pretendimet për abuzim apo përdhunim, sipas raportit 449 të Barometrit Special të Komisionit Evropian mbi dhunën me bazë gjinore, të kryer në vitin 2016.⁴¹

Figura 3.2: Qëndrimet themelore kundrejt dhunës ndaj grave

Ju lutemi na thoni në çmasë do të pajtoheshit apo nuk do të pajtoheshit me deklaratat vijuese.



Pothuajse gjysma e grave në Kosovë pajtohen me idenë që "dhuna në familje është çështje private dhe duhet të trajtohet brenda familjes" (48%). Për krahasim, studimi i Eurobarometër i përmendur më sipër ka gjetur që në gjithë BE-në, vetëm 14% e grave ishin të të njëjtit mendim.⁴² Pajtimi mbi këtë çështje në BE varion nga 2% në Suedi

41 Eurobarometri special 449: Dhuna në baza gjinore
42 Special Eurobarometer 449: Dhuna në baza gjinore


deri në 31% në Rumani, duke sugjeruar që aty ku ka një traditë më të gjatë ndërgjegjësimi për barazinë gjinore ka më shumë gatishmëri për të folur për dhunën jashtë familjes. Megjithatë në Kosovë janë më të pakta ato gra të moshës nën 30 vjeç dhe të mirë arsimuara që e ndajnë këtë mendim, përqindjet janë prapëseprapë mjaft domethënëse (41% (nën 30) dhe përkatësisht 33% (shkollim i lartë)).

Shumica e grave raportojnë përshtypjen se dhuna ndaj grave është diçka e zakonshme në Kosovë (64%, krahasuar me 78% mesatarisht në të gjithë BE-në në vitin 2012, që shkon nga 54 - 93%).⁴³ Megjithatë, më pak se një në gjashtë gra (15% krahasuar me 20% në BE) thonë se personalisht njohin dikë në rrethin familjar apo të miqve, qoftë edhe në lagjen ku jetojnë, që të ketë pësuar dhunë (14% krahasuar me 16% në BE).

Pothuajse gjysma e grave në Kosovë pajtohen që dhuna në familje është çështje private dhe duhet të trajtohet brenda familjes

Figura 3.3: Perceptimet e përhapjes së dhunës ndaj grave

Sa e shpeshtë mendoni që është dhuna ndaj grave nga partnerët, të njohurit apo të huajt në Kosovë?



Gratë të cilat ishin pjesë e studimit cilësor kanë thënë që dhuna fizike, psikologjike, seksuale dhe ekonomike janë që të gjitha më se të zakonshme në Kosovë. Ato janë shprehur të bindura që lloji më i zakonshëm i dhunës ndaj grave është dhuna psikologjike, ndërsa dhuna fizike është konsideruar si më së paku e pranueshme. Ato thanë që dhuna seksuale është tejet e përhapur, sidomos brenda marrëdhënieve, por që rrallë diskutohet. Ato thanë se është normë që gratë të jenë gjithmonë në

⁴³ Dhuna ndaj grave: Hulumtim i gjithë BE-së. Rezultatet kryesore (Vjenë: Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, 2015), qasur më 5 prill 2019, <http://fra.europa.eu/en/publication/2014/violence-against-women-eu-wide-survey-main-results-report>.

3. Qëndrimet ndaj roleve gjinore dhe dhunës ndaj grave

dispozicion për marrëdhënie seksuale me partnerin, pavarësisht nëse e dëshirojnë këtë gjë apo jo.

“Gratë janë gjithmonë në dispozicion për burrin e tyre, për seks. Edhe kur janë të lodhura ose të zëna me punë, ato duhet të jenë të disponueshme për burrat e tyre ... Nëse një grua nuk është gjithnjë në dispozicion për burrin e saj, atëherë ai mund të shkojë tek dikush tjetër dhe pikërisht kësaj ia kanë gratë drojën, andaj edhe sakrifikohen”

Grua, 34-55 vjeç, shqiptare e Kosovës, vendbanim urban

Nuk ka ndonjë model të qartë për sa u përket qëndrimeve ndaj rolit gjinor dhe etnisë në Kosovë. Ndërkohë që pothuajse i njëjti numër grash nga komuniteti shqiptar i Kosovës dhe ai Serbe e Kosovës besojnë se miqtë e tyre do të pajtoheshin me idenë se është e rëndësishme që burri t'i tregojë gruas së kush është shefi (48% e shqiptareve dhe 43% e serbeve), si dhe që është detyrë e gruas të kryejë marrëdhënie seksuale me burrin e saj (27% kundrejt 30%), gratë shqiptare janë më konservatore kur bëhet fjalë për atë nëse gruaja mund t'i zgjedhë vetë miqtë e saj. Dyzet e dy për qind të shqiptareve të Kosovës besojnë që miqtë e tyre do të pajtoheshin me këtë ide, ndërkohë që këtë mendim e ndajnë 60% të serbeve të Kosovës. Ndryshe nga kjo, më pak gra serbe të Kosovës mendojnë se miqtë e tyre do të pajtoheshin me idenë se nëse një burrë keqtrajton gruan e tij, të tjerët jashtë familjes duhet të ndërhyjnë (56% në krahasim me 65% të shqiptarëve të Kosovës).

Megjithatë, kur është fjala për qëndrimet ndaj dhunës në familje, shqiptaret e Kosovës kanë në mënyrë konsistente më shumë gjasë të kenë pikëpamje tradicionale. Gjasat janë më të mëdha që ato të pajtohen me idenë se gratë që thonë se janë keqtrajtuar shpesh e sajojnë ose teprojnë kur vjen puna tek pretendime të tilla (35% në krahasim me 29% të serbeve), që dhuna kundër grave shpesh provokohet nga viktimat (38% kundrejt 24%), që gratë kanë më shumë gjasë të përdhunohen nga një i panjohur (45% kundrejt 34%) dhe se dhuna në familje është çështje private që duhet trajtuar brenda familjes (50% kundrejt 39%).



8%

Pak më pak se një në dhjetë gra të moshave 18-74 vjeç tregojnë të kenë përjetuar dhunë fizike ose seksuale nga një jopartner që nga mosha 15-vjeçare.



11%

Afërsisht një në nëntë gra të moshave 18-74 vjeç që kanë pasur ndonjë partner tregojnë të kenë përjetuar dhunë fizike ose seksuale nga një partner intim.



53%

Dhuna psikologjike nga partneri ka prekur mbi gjysmën e grave që kanë pasur partner ndonjëherë.



29%

Gati tri në dhjetë gra të moshave 18-74 vjeç kanë përjetuar ngacmim seksual që në moshën 15 vjeçare.

4. Dhuna ndaj grave në Kosovë

4.1: Dhuna fizike dhe seksuale nga partneri intim

Kur diskutohej mbi dhunën nga partneri intim, gratë në studimin cilësor u përqendruan në dhunën fizike, psikologjike dhe atë ekonomike. Ato thanë që dhuna fizike dhe psikologjike janë të zakonshme nëpër lidhje, dhe se shpesh shkonin bashkë.

Më se gjysma e grave (54%) të cilat kanë ose kanë pasur partner intim tregojnë të kenë përjetuar dhunë nga këta partnerë. Në të shumtën e rasteve dhuna ka qenë psikologjike (deklaruar nga 53% syresh krahasuar me një mesatare më të ulët të BE-së prej 43%), por thuajse një në dhjetë gra thonë të kenë përjetuar dhe dhunë fizike (9%)⁴⁴ dhe 4% dhunë seksuale.⁴⁵ Këto shifra janë më të ulëta se ato në BE, ku 20% flasin për përjetim të dhunës fizike (duke filluar nga 11% në Austri deri në 31% në Danimarkë) dhe 7% për përjetim të dhunës seksuale (duke filluar nga 3% në Kroaci e deri në 11% në Danimarkë). Fakti që më pak gra thonë të kenë përjetuar dhunë fizike ose seksuale nga partneri intim nuk do të thotë detyrimisht se prania e dhunës është më e ulët. Janë disa faktorë që mund të kontribuojnë në gatishmërinë e grave për të folur për dhunën, duke përfshirë, për shembull, normat e përhapura shoqërore, ndjenjën e turp-it ose mungesën e besimit në institucione (shpjeguar më hollësisht në Kapitullin 5). Në uljen e niveleve të raportimit të këtij lloji të dhunës mund të kontribuojë gjithashtu dhe fakti që gati gjysma e grave në Kosovë e konsiderojnë dhunën në familje çështje private.

Dallimet në shkallët e raportuara të pranisë së dhunës krahasuar me vende:


Është me rëndësi të vihet në dukje që shoqëritë me traditë më të gjatë të politikave dhe fushatave të vetëdijesimit për barazi gjinore (vendet skandinave dhe Evropa Perëndimore) kanë njëherësh dhe shkallë më të lartë të grave që raportojnë rastet e dhunës.

Për shembull, sipas studimit të ADTH të realizuar në mbarë BE-në, tri vendet ku gratë kanë më së shumti gjasë të thonë që kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga një partner apo jopartner qysh në moshën 15-vjeçare janë Danimarka (52%), Finlanda (47%) dhe Suedia (36%). Shkalla e deklaruar e pranisë së dhunës është më e ulët në Kroaci (21%), Austri (20%) dhe Poloni (19%).

Figura 4.1: Prania e dhunës fizike dhe seksuale nga partneri intim

44 Në lidhje me dhunën fizike, grave në anketë iu bënë pyetjet vijuese: Dikush / partneri aktual / partneri i mëhershëm 1) ju ka shtyrë ose shtirë në tokë? 2) ju ka qëlluar me shpullë? 3) ju ka gjuajtur me objekt të fortë? 4) ju ka kapur me forcë apo ju ka kapur për flokë? 5) ju ka goditur me grusht, me objekt të fortë, apo ju ka shqelmuar? 6) ju ka djegur, 6) është përpjekur t'ju ngulfasë apo t'ju merrte frymën, 7) ju ka prerë apo therrur, apo ka qëlluar me armë drejt jush? 8) ju ka përplasur koken për diçka? Në këtë raport, përhapja e dhunës fizike bazohet në të anketuarit që raportojnë se kanë përjetuar të paktën një nga këto forma të dhunës së paku një herë. Normat e përhapjes së dhunës fizike jepen për partnerët aktualë, partnerët e mëhershëm, çdo partner intim (qoftë aktual apo i mëhershëm) dhe jopartnerët. Periudha e referencës për dhunën nga jopartnerët ishte nga mosha 15 vjeçare / në 12 muajt e fundit para studimit, ndërsa për dhunën nga partneri ishte nëse kjo kishte ndodhur ndonjëherë gjatë marrëdhënies ose në 12 muajt e fundit para studimit.

45 Lidhur me dhunën seksuale, gratë u pyetën: Që kur keni qenë 15 vjeç dhe në 12 muajt e fundit, sa shpesh dikush ju ka: 1) detyruar të kryenit marrëdhënie seksuale, duke ju mbajtur me forcë apo duke ju lënduar në çfarëdo mënyre? 2) Përveç kësaj, sa shpesh ju ka detyruar dikush të kryeni marrëdhënie seksuale duke ju mbajtur me forcë ose duke ju lënduar në çfarëdo mënyre? 3) Përveç kësaj, sa shpesh ju ka detyruar dikush të merrni pjesë në çfarëdo forme të aktivitetit seksual kur nuk keni dashur apo nuk keni qenë në gjendje të refuzoni? 4) jeni detyruar të pajtohni me aktivitetin e tillë seksual sepse keni pasur frikë se çfarë mund të ndodhë nëse do refuzoni? Në këtë raport, përhapja e dhunës fizike bazohet në të anketuarit që raportojnë se kanë përjetuar të paktën një nga këto forma të dhunës së paku një herë. Normat e përhapjes së dhunës fizike jepen për partnerët aktualë, partnerët e mëhershëm, çdo partner intim (qoftë aktual apo i mëhershëm) dhe jopartnerët. Periudhat e referencës janë si më sipër.



Gratë të cilat e kanë të vështirë të mbijetojnë me të ardhurat e tyre kanë më shumë gjasë të thonë të kenë përjetuar dhunë nga partneri sesa gratë në përgjithësi (76% kundrejt 54%). Gratë më në moshë (mbi 60 vjeç) kanë më shumë gjasë të tregojnë për përjetim edhe të dhunës fizike (19% kundrejt 9% në përgjithësi) edhe të asaj seksuale (7% në krahasim me 4% në përgjithësi) gjatë jetës së tyre. Mënyra më e shpeshtë e ushtrimit të dhunës fizike nga partneri aktual është nëpërmjet goditjes me shuplakë. Kjo është njëherësh dhe forma më e raportuar e dhunës fizike nga partneri mëparshëm, bashkë me shtyrjen apo shtrirjen në tokë, kapjen me forcë apo tërheqjen nga flokët. Gratë në BE kanë më shumë gjasë të raportojnë të shtyrat apo të shtrirat në tokë, sesa goditjet me shuplaka.

Forma më e përhapur e dhunës nga partneri intim është ajo psikologjike, që raportohet nga më se gjysma e grave që kanë pasur partner ndonjëherë

Tabela 4.1: Format e dhunës fizike dhe/ose seksuale nga partneri intim

Sa shpesh ju ka bërë ndonjërin prej këtyre partneri aktual/i mëparshëm i juaj?

	Partneri aktual % e rasteve të mundshme	Partneri i mëparshëm % e rasteve të mundshme
Goditje me shuplakë?	7	12
Shtyrje apo shtrirje në tokë?	2	7
Kapje me forcë apo kapje për flokë?	2	7
Gjuajtje me objekt të fortë?	1	2
Goditje me grusht, objekt të fortë, apo me shqelma?	1	4
Përpjekje për ngulfatje, apo zënie të frymës?	0,3	1
Përplasje e kokës për diçka?	0,3	1
Ju ka prerë apo therur, apo ka shtënë me armë drejt jush?	0,2	1
Ju ka djegur?	0,2	0.4

BAZA: Gjitha gratë në Kosovë, në moshat 18-74 vjeç, me partnerin aktual (1,573) ose partnerin e mëhershëm (313)

BURIMI: Studim i udhëhequr nga OSBE-ja mbi dhunën ndaj grave (2018)

Dhuna seksuale, e përjetuar nga 4% të grave që kanë pasur partner ndonjëherë, manifestohet në disa forma.

Tabela 4.2: Prania e dhunës seksuale nga partneri intim

Sa shpesh ju ka bërë ndonjërin prej këtyre partneri aktual/i mëparshëm i juaj?

	Partneri aktual % e rasteve të mundshme	Partneri i mëparshëm % e rasteve të mundshme
Ju ka detyruar të kryeni marrëdhënie seksuale duke ju mbajtur me forcë, ose duke ju lënduar në çfarëdo forme?	2	4
Përveç kësaj, ka tentuar t'ju detyrojë të kryeni marrëdhënie seksuale duke ju mbajtur me forcë ose duke ju lënduar në çfarëdo mënyre?	2	4
Përveç kësaj, ju ka detyruar të merrni pjesë në çfarëdo forme të aktivitetit seksual kur nuk keni dashur apo nuk keni qenë në gjendje të refuzoni?	2	2
Jeni detyruar të pajtoheni me aktivitetin e tillë seksual sepse keni pasur frikë se çfarë mund të ndodhë nëse do refuzonit?	2	2

BAZA: Gjitha gratë në Kosovë, në moshat 18-74 vjeç, me partnerin aktual (1,573) ose partnerin e mëhershëm (313)

BURIMI: Studim i udhëhequr nga OSBE-ja mbi dhunën ndaj grave (2018)

Modelet në dhunën nga partneri intim⁴⁶

Ne mesin e atyre grave për të cilat përvoja e parë e dhunës fizike dhe/ose seksuale (apo e kërcënimit me të) nga ana e partnerit aktual daton më shumë se pesë vjet para studimit, 16% thonë që incidenti i fundit ka ndodhur diku mes një deri katër para studimit, ndërsa 2% të tjera thonë të ketë ndodhur në 12 muajt para studimit. Katërmbëdhjetë për qind të atyre për të cilat përvoja e parë ka qenë mes një dhe pesë vitesh para studimit thonë që incidenti më i vonë ka ndodhur në 12 muajt e fundit para studimit.

Pak mbi nëntë nga dhjetë të mbijetuarat e dhunës fizike dhe/ose seksuale nga partneri aktual (91%) ishin duke bashkëjetuar me partnerin e tyre aktual në kohën e përvojës së parë të dhunës (krahasuar me 82% të BE-së), derisa 61% e të mbijetuarave të dhunës nga partneri i mëparshëm ishin duke bashkëjetuar me partnerin e tyre në kohën e incidentit të tyre të parë (krahasuar me 62% në BE).

Ndër të anketuarat të cilat ishin shtatzënë gjatë kohës sa ishin në lidhje me partnerin e tyre dhe që përjetuan dhunë (ose kërcënime me të) gjatë kësaj lidhjeje, një në gjashtë (18%) viktima të dhunës së shkaktuar nga partneri aktual (ngjashëm me mesataren e BE-së prej 20%) dhe dy nga pesë viktimat e dhunës së shkaktuar nga partneri i mëparshëm⁴⁷ (42%, njëlloj me mesataren e BE-së) thonë se dhuna fizike ose seksuale (ose kërcënimet me të) kishin ndodhur gjatë shtatzënisë.

Në 18% të rasteve, partneri aktual ishte i dehur në kohën kur incidenti më i rëndë. Kjo shifër rritet në 25% në rastet kur incidentet më të rënda janë shkaktuar nga partneri i mëparshëm.

Anketa kërkonte nga gratë të cilat kishin përjetuar dhunë fizike ose seksuale që të jepnin më shumë hollësi në lidhje me incidentin që ato e konsideronin si më të rëndin të përjetuar në jetën e tyre. Llojet e dhunës së përjetuar gjatë atyre incidenteve të identifikuar si më seriozet janë të ngjashme, qoftë nga partnerët aktualë ose nga partnerët e mëhershëm (Tabela 4.3).

Gratë në Kosovë kanë shumë më tepër gjasë të raportojnë shuplakën si incidentin më të rëndë të dhunës sesa gratë në BE, ku 59% e grave e përjetojnë atë nga partneri aktual dhe 50% nga një partner i mëparshëm, krahasuar me mesataren e BE-së prej 28% për të parën, si dhe 25% për të fundit.

⁴⁶ Derisa shkalla e raportimit / përhapja e dhunës fizike dhe seksuale të diskutuara më sipër nuk përfshijnë kërcënime për një dhunë të tillë, pyetje të tjera që kanë të bëjnë me kohën kur ka ndodhur dhuna dhe detajet për incidentin më të rëndë, përfshijnë kërcënimet e dhunës.

⁴⁷ Duke marrë parasysh bazën tejet të vogël (n=28), duhet pasur kujdes në interpretimin e këtyre gjetjeve.

Tabela 4.3: Incidenti më i rëndë i dhunës nga partneri intim

Do të doja të mendonit për incidentin më të rëndë të shkaktuar nga partneri juaj aktual/i mëparshëm. Cila prej ngjarjeve në kartë ka ndodhur në atë rast? Kuptimi i incidentit “më i rëndë” është ai incident që ka pasur ndikimin më të madh mbi ju.

	Partneri aktual %	Partneri i mëparshëm %
Ju ka goditur me shuplakë	59	50
Ka kërcënuar t’ju lëndojë fizikisht	21	19
Ju ka shtyrë apo shtrirë në tokë?	14	22
Ju ka kapur me forcë apo për flokë?	12	19
Ka provuar t’ju detyrojë të bëni marrëdhënie seksuale duke ju mbajtur me forcë, ose duke ju lënduar në çfarëdo forme?	10	11
Ju ka detyruar të bëni marrëdhënie seksuale duke ju mbajtur me forcë, ose duke ju lënduar në çfarëdo forme?	9	9
Jeni detyruar të pajtoheni me aktivitetin e tillë seksual sepse keni pasur frikë se çfarë mund të ndodhë nëse do refuzoni?	8	4
Ju ka detyruar të merrni pjesë në çfarëdo forme të aktivitetit seksual kur nuk keni dashur apo nuk keni qenë në gjendje të refuzoni?	5	13
Ju ka gjuajtur me objekt të fortë?	3	6
Ju ka goditur me grusht, objekt të fortë, apo me shqelma?	3	7
Djegje?	1	0
Ka provuar t’ju ngulfasë, apo t’ju zërë frymën?	1	2
Ju ka përplasur kokën për diçka?	1	1
Ju ka kërcënuar me veprime të dhunshme seksuale (si përdhunimi, shtatzënia e detyruar, etj.) në një mënyrë që ju ka frikësuar shumë	2	5
Prerje apo therje, apo qitje me armë drejt jush?	0	1

BAZA: Gjitha gratë në Kosovë të moshave 18–74 vjeç të cilat kanë përjetuar dhunë ndonjëherë nga duart e partnerit aktual (180) ose partnerit të mëparshëm (64)

BURIMI: Studim i udhëhequr nga OSBE-ja mbi dhunën ndaj grave (2018)

Dhuna fizike dhe seksuale në 12 muajt e fundit para studimit

Në përgjithësi, 4% e grave që kanë pasur partner ndonjëherë kanë raportuar se kanë përjetuar dhunë fizike ose seksuale nga një partner intim gjatë 12 muajve të fundit para studimit. Llojet e dhunës nga partneri intim me të cilat gratë janë përballur gjatë 12 muajve të fundit para studimit janë përgjithësisht të ngjashme me ato që kanë përjetuar gjatë jetës së tyre. E quëllura me shuplakë është forma më e përhapur e dhunës e kryer nga partnerët intimë, e përmendur si formë dhune nga 2% e grave.

4.1.1. Dhuna psikologjike nga partneri intim

Gratë të cilat morën pjesë në studimin cilësor besonin se dhuna psikologjike ndaj grave, përfshirë dhe abuzimin verbal, veprimet kontrolluese dhe kërcënimet, ishte e zakonshme brenda marrëdhënieve në Kosovë. Njëlloj si në rastin e dhunës fizike, kishte një perceptim se gratë nganjëherë e meritojnë abuzimin verbal që pësojnë nga partneri i tyre.

Gjetjet e studimit tregojnë se mbi gjysma e grave të cilat kanë pasur partner ndonjëherë kanë përjetuar dhunë psikologjike nga partneri i tyre, aktual ose i mëparshëm (53%), shifër kjo më e lartë se mesatarja e raportuar në BE (43%, duke filluar nga 31% në Irlandë në 60% në Danimarkë dhe Letoni). Format e ndryshme të dhunës psikologjike për të cilat janë dhënë informata janë kategorizuar në katër kategori të gjera, si vijon.⁴⁸

Dhuna ekonomike, që përfshin ndalimin e marrjes së vendimeve për financat e familjes, si dhe nga dalja në treg si e vetme, por edhe ndalimi i punës jashtë shtëpisë.

Veprimet kontrolluese, ku përfshihen situatat në të cilat partneri i gruas përpiqet ta pengojë të mos takohet me miq, t'ia kufizojë përdorimin e mediave sociale (si Facebook, Twitter etj.), përpiqet t'ia kufizojë kontaktet me familjen apo të afërmit e saj, insiston të dijë se ku është në një mënyrë që tejkalon suazat e kujdesit të përgjithshëm, zemërohet nëse ajo flet me një mashkull tjetër, dyshon që nuk ka qenë besnike në martesë, *ia ndalon përdorimin e kontraceptivëve apo ia kufizon në ndonjë mënyrë tjetër vendimet për planifikimin familjar, e pengon të kryejë shkollimin apo të fillojë ndonjë kurs edukativ, kërkon të vendosë për veshjen e saj apo pret që ajo t'i kërkojë leje për t'u vizituar nga mjeku.*

Sjelljet abuzive, ku përfshihen situatat në të cilat partneri ia ndalon tërësisht gruas të dalë nga shtëpia, ose ia ndalon të dalë nga shtëpia pa përcjellje të një të afërmi, ia merr çelësat e veturës ose e kyç në shtëpi, e nënçmon apo e përbuzë në sytë e të tjerëve apo edhe privatisht, qëllimisht e trembë apo e frikëson apo (p.sh. duke bërë titur apo thyer gjëra), e detyron të shohë materiale pornografike pa dëshirën e saj, kërcënon ta lëndojë apo vrasë dikë që ajo e do (përveç fëmijëve të saj), kërcënon ta lëndojë fizikisht, e kërcënon me akte të dhunshme seksuale (si përdhunimi, shtatzënia e detyruar etj.), *si dhe e lëndon apo kërcënon ta lëndojë derisa ajo viziton, merr apo sjell fëmijët e saj (vetëm për partnerët e mëhershëm).*

Shfrytëzimi i fëmijëve të gruas për ta shantazhuar apo abuzimi i fëmijëve të saj, ku përfshihen kërcënimi për t'ia marrë fëmijët, kërcënimi për t'ia lënduar fëmijët, lëndimi i fëmijëve apo kërcënimi lidhur me kujdestarinë e fëmijëve të saj (vetëm për partnerët e mëhershëm).

Nga gratë të cilat ishin në një lidhje u kërkua të tregonin nëse ndonjëra prej këtyre u kishte ngjarë ndonjëherë, shpesh apo gjatë gjithë kohës, apo nuk kishte ndodhur kurrë, ndërsa gratë që kishin pasur lidhje intime të mëhershme u pyetën nëse ndonjë prej partnerëve të mëhershëm u kishte bërë ndonjëherë prej këtyre gjërave.⁴⁹

Përgjithësisht, 42% e grave që kanë pasur partner ndonjëherë kishin përjetuar veprime kontrolluese, ndërsa 31% kishin përjetuar sjellje abuzive (24%). Dhuna ekonomike u raportua nga rreth një në tetë gra (13%). Kishte pak dallime në përhapjen


48 Format e dhunës psikologjike në shkronja kursive nuk kanë qenë pjesë e pyetjeve në studimin FRA.

49 Sa i përket kërcënimit me dhunën fizike apo seksuale, gratë janë pyetur se sa herë partneri i tyre aktual dhe/ose i mëhershëm ka bërë këtë, si dhe sa shpesh e ka bërë në 12 muajt e fundit para studimit.

e këtyre formave të dhunës të ushtruara nga partnerët aktualë apo të mëhershëm. Në mesin e atyre grave që kanë pasur partner ndonjëherë dhe që kanë fëmijë, 4% thonë që fëmijët e tyre janë përdorur për t'i shantazhuar apo që janë keqtrajtuar nga partneri, ku kjo formë e dhunës psikologjike është ushtruar më shpesh nga partnerët e mëhershëm sesa ata aktualë.

Figura 4.2: Prania e formave të ndryshme të dhunës psikologjike nga partneri intim

Tri format më të shpeshta të dhunës psikologjike nga partneri intim janë ato ku



partnerët insistojnë të dinë se ku janë, në një mënyrë që tejkalon suazat e kujdesit normal; partnerët zemërohen nëse gruaja flet me një burrë tjetër, nënçmojnë ose poshtërojnë gruan privatisht, ku secila nga këto forma raportohet nga rreth një e pesta e grave që janë aktualisht apo kanë qenë më parë në marrëdhënie intime. Rezultatet janë shumë të ngjashme me mesataren e BE-së, ku secila nga këto tre forma është përjetuar nga afërsisht tri në dhjetë gra të cilat kanë pasur partner ndonjëherë.

Gratë të cilat morën pjesë në studimin cilësor kanë folur për llojet e dhunës ekonomike, duke përfshirë ndalesën për të punuar ose mohimin e qasjes në para, qoftë edhe nëse i fitonin vetë. Gratë në këtë pozitë shpreheshin që kjo i bënte të ndjeheshin pambrojtura, pasi e dinin se nuk do të kishin asnjë mjet për të mbijetuar të vetme. Partnerët që kanë përdorur këtë lloj dhune kuptonin ndikimin e saj, si dhe përdornin edhe kërcënime, duke thënë, për shembull, që mund ta detyronin gruan të largohej nga shtëpia e familjes, ashtu që ta kontrollonin.

“Di për një rast të një gruaje që ka përfunduar shkollën e mjekësisë, por që ende nuk punon, sepse burri i saj nuk e lejon. Ai i thotë se ajo nuk ka nevojë të punojë sepse punon ai. [Ajo] rri në shtëpi, edhe pse ka pasur shumë mundësi punësimi, sepse burri nuk e lë [të punësohet].”

Grua, 18-30 vjeç, shqiptare e Kosovës, vendbanim urban

4.2: Përndjekja

Tetë për qind të grave thonë të kenë qenë përndjekur⁵⁰ në një moment të caktuar që prej moshës 15 vjeçare. Kjo përqindje është më e ulët se mesatarja e BE-së prej 18% dhe renditet ngjashëm me vendet me vlerat më të ulëta të kësaj dukurie në BE- (Rumania me 8% deri në 33% në Suedi). Nxënëset dhe studentet në Kosovë raportojnë përjetime më të shpeshta të përndjekjes (19%) sesa mesatarisht gratë me arsim të lartë (13%). Format më të zakonshme të përndjekjes janë thirrjet fyese, kërcënuese ose të heshtura (4% në krahasim me 11% në BE), ndjekja e qëllimtë e gruas (3% në krahasim me 8% në BE), si dhe dërgimi i mesazheve elektronike, mesazheve me tekst ose mesazheve të çastit me natyrë ofenduese ose kërcënuese (2% në krahasim me 4% në BE).

Në thuajse gjysmën e rasteve (48%) kryerësi ka qenë dikush i panjohur, ndërsa në një të katërtën e incidenteve (27%) ishte dikush tjetër që ajo e njihnte, por pa e specifikuar më tej.⁵¹ Shtatë për qind të grave theksojnë që personi ishte mik, i njohur apo fqinj.

Shumica e përvojave më serioze të grave në lidhje me përndjekjen kanë zgjatur deri në një muaj (57%), derisa për 43% incidentet nuk zgjasin më shumë se disa ditë. Sidoqoftë, 18% e incidenteve të përndjekjes kanë zgjatur mbi një vit dhe 3% për pesë vjet. Viktimat e përndjekjes në BE raportojnë që përndjekja ka vazhduar për periudha më të gjata, ku 29% e grave theksojnë që ka shkuar për më shumë se një vit.

Për çdo pesë raste, në dy e më shumë sosh incidenti më i rëndë i përjetuar ka bërë që gruaja të ndjente zemërim ose frikë (43%, respektivisht 42%) dhe në një të tretën e rasteve gruaja është ndjerë e mërzitur ose turpëruar (30% gjithsecili). Pasojat psikologjike afatgjata përfshijnë ankthin (për 21% të grave në rastin më të rëndë), vështirësitë në gjumë (17%), depresionin (gjithashtu 17%) ose humbjen e vetëbesimit (13%). Në lidhje me incidentin më të rëndë të përndjekjes, gati gjysma e grave (49%), tregonin që kanë folur mbi përvojën me miqtë apo të afërmit; në BE, 77% e grave kanë bërë të njëjtën gjë. Në disa raste, gratë raportojnë të kenë ndërmarrë veprime: 34% kanë ndryshuar numrin e tyre të telefonit ose adresën elektronike, krahasuar me 23% në BE, ndërsa 26% kanë ndërruar shtëpi (14% në BE). Një e katërta e grave (24% kundrejt 43% në BE) janë përballur me dhunuesin, dhe 22% kanë mbyllur llogaritë e tyre në rrjetet sociale, ashtu si edhe 7% e grave në BE. Në 14% të rasteve, gratë e përndjekura e kanë kërcënuar dhunuesin se do të ndërmerrnin veprime gjyqësore, krahasuar me 32% e grave në BE. Përgjigjet e grave tregojnë se gratë në Kosovë kanë më shumë gjasa të ndërmarrin veprime shmangëse për të shmangur vazhdimin e përndjekjes, ndërsa gratë në BE kanë më shumë gjasa të ndërmarrin veprime të bindura dhe të përballen me dhunuesit, ndërsa një në pesë gra që kanë pësuar përndjekje në BE tregojnë se incidentin e tyre më të rëndë e kanë raportuar në polici.

50 Për përndjekjen, gratë në anketë u pyetën: Që kur keni qenë 15 vjeç / në 12 muajt e fundit, i njëjti person në mënyrë të përsëritur ka bërë një ose më shumë nga këto gjëra kundrejt jush: 1) Ju ka dërguar emaila, mesazhe me tekst (SMS) ose mesazhe të çastit që ishin ofenduese ose kërcënuese? 2) Ju ka dërguar letra ose kartolina ofenduese ose kërcënuese? 3) Ja ka bërë telefonata fyese, kërcënuese ose të heshtura? 4) Ka postuar komente fyese për ju në internet? 5) Ka publikuar foto ose video tuajat në internet ose nëpër celularë? 6) Është vërtitur rreth shtëpisë suaj ose ju ka pritur jashtë, në vendin e punës ose në shkollë pa ndonjë arsye të vërtetë? 7) Ju ka ndjekur qëllimisht? 8) Me qëllim ka ndërhyrë ose ka dëmtuar pronën tuaj? Prania e përndjekjes bazohet në të anketuarit që raportojnë se kanë përjetuar një ose më shumë forma të përndjekjes të renditura më sipër.

51 Duke përjashtuar partnerin aktual, partnerin e mëhershëm, shefin/mbikëqyrësin, kolegun/bashkëpunëtorin, klientin/konsumatorin/pacientin, mësuesin/trajnerin/mentorin, kolegun e shkollës, mjekun/punonjësin shëndetësor, të afërmit/familjarët (përveç partnerit), të afërmit/familjarët e partnerit, një pretendent/dikush që sapo keni takuar.

4.3: Ngacmimi seksual


Pothuajse një e treta e të gjitha grave thonë të kenë përjetuar të paktën një formë të ngacmimit seksual⁵² (siç është e treguar në figurën 4.4) që në moshën 15 vjeçare (29%) (figura 4.3). Prania është veçanërisht e lartë tek gratë nën 30 vjeç (42%), tek studentet (60%), tek gratë të cilat nuk kanë pasur kurrë partner (41%), tek gratë në një familje pa fëmijë (47%), gratë më mirë të arsimuara (44%), si dhe gratë në rajonet veriperëndimore dhe jugperëndimore të Kosovës (përkatësisht 42% dhe 37%).

Një në tetë gra tregojnë të kenë përjetuar ngacmime seksuale në 12 muajt e fundit (13%) me një përqendrim më të lartë në të njëjtat grupe demografike si më sipër. Një në gjashtë gra (16%) kanë përjetuar forma më të rënda të ngacmimit seksual,⁵³ ku 6% e grave kanë përjetuar forma më të rënda të ngacmimit seksual në 12 muajt e fundit para studimit. Përsëri, kjo ishte veçanërisht e përhapur mes grupeve të njëjta demografike.

Përqindja e grave të cilat raportojnë se kanë përjetuar ngacmim seksual në BE është 55%, me një amplitudë nga 24% në Bullgari deri 81% në Suedi. Përhapja e kësaj dukurie në Kosovë është më e ulët se ajo e mesatares së BE-së dhe më afër pragjeve të poshtme në Bashkimin Evropian.

Në BE-së ka dallime të mëdha sa i përket shkallës së raportimit të ngacmimeve seksuale, me një prirje për përqindje më të mëdha të grave që raportojnë rastet e ngacmimit seksual në ato vende ku ka traditë më të gjatë të politikave dhe fushatave vetëdijesuese për barazi gjinore.

Figure 4.3: Prania e ngacmimit seksual



52 Për sa i përket ngacmimit seksual, gratë në anketë u pyetën: Sa shpesh, që kur keni qenë 15 vjeç / 12 muajt e fundit, keni përjetuar ndonjëherë nga këto: 1) prekje, përqafim ose puthje të padëshiruara? 2) Komente ose shaka sugjестive seksuale që ju kanë ofenduar? 3) ftesa të pahijshme për të dalë në një takim? 4) pyetje të papërshtatshme në lidhje me jetën tuaj private që ju kanë ofenduar? 5) komente të papërshtatshme në lidhje me pamjen tuaj që ju ka bërë të ndiheni të ofenduar? 6) Ju ka ngulur sytë në mënyrë të papërshtatshme sa ju ka ofenduar? 7) Dikush që ju ka dërguar ose ju ka treguar fotografi, pamje ose dhurata me përmbajtje seksuale që ju kanë ofenduar? 8) Dikush që është ekspozuar pahijshëm para jush? 9) Dikush ju ka detyruar të shikoni ose vështroni materiale pornografike pa dëshirën tuaj? 10) Emaille ose mesazhe seksuale të padëshiruara që ju kanë ofenduar? 11) Veprime të papërshtatshme në faqet e rrjeteve sociale si Facebook, apo në bisedat në internet që ju kanë ofenduar? Në lidhje me çdo formë të ngacmimeve seksuale, gratë mund të tregojnë se ato e kishin përjetuar këtë formë ngacmimi 'kurrë', 'një herë', '2-5 herë', '6 ose më shumë herë'. Përhapja e ngacmimeve seksuale bazohet në të anketuarit të cilët raportojnë se kanë përjetuar një nga elementët e listuar të paktën një herë. Gjashtë forma të ngacmimit seksual u përzgjedhën për ashpërsinë e tyre dhe në këtë raport janë përmendur si "format më të rënda" të ngacmimeve seksuale.

53 Format më të rënda të ngacmimeve seksuale janë "kontakti, përqafimi ose puthja e padëshiruara", "komente seksuale apo shaka që ju bëjnë të ndiheni ofenduar", "dikush që dërgon ose ju tregon fotografi, pamje ose dhurata seksuale që ju bëjnë të ndiheni ofenduar", "dikush që qëllimisht ekspozohet pahijshëm para jush", "dikush ju ka detyruar të shikoni ose vështroni materiale pornografike kundër dëshirës tuaj" dhe "emaille me përmbajtje seksuale aspak të dëshirueshme ose mesazhe SMS që ju kanë ofenduar". Përhapja e formave më të rënda të ngacmimit seksual bazohet tek të anketuarat që raportojnë se kanë përjetuar të paktën një nga këto forma të ngacmimit seksual së paku një herë.

Ngacmimi seksual mbulon një gamë të gjerë përvojash. Format më të zakonshme të raportuara nga gratë janë vështrimet apo ngulitja e syve në mënyrë të papërshtatshme (15%), ose pyetje të tepërta dhe fyese mbi jetën e tyre private (14%). Në BE, llojet më të zakonshme të ngacmimeve seksuale ishin gjithashtu vështrimet apo ngulitja e syve në mënyrë të papërshtatshme (30%), pasuar nga ngacmimi fizik: prekje, përqaqim ose puthje e padëshiruar (29%, krahasuar me 5% në Kosovë).

Teksa diskutohej mbi ngacmimet seksuale në studimin cilësor, gratë përqendroheshin në atë që kishin parë, apo atë që ato besonin se u kish ndodhur grave në vendin e punës. Ngacmimi seksual përshkruhej si veprim i kryer nga meshkujt në pozita të larta, si për shembull drejtorë dhe politikanë, ndërsa gratë që e kishin përjetuar një gjë të tillë shpesh nuk guxonin ta raportonin për shkak të frikës së humbjes së punës apo turpfit. Ato po ashtu thoshin se shantazhi ishte diçka shumë e zakonshme, veçanërisht në sektorin privat.

"Dy gra donin të punonin në shkollë (time) sepse ishte i lirë pozicioni i asistentes teknike. Më thirrën dhe më kërkuan që të shkoja e të flisja me burrat e tyre. Ata (burrat) fare nuk e pëlqenin këtë ide, e edhe u shkaktonin probleme grave, duke thënë "pse paska nevojë ajo të flasë me ty..." Unë e konsideroj edhe këtë dhunë psikologjike".

Grua, 18-30 vjeç, serbe e Kosovës, vendbanim urban

Nga ana tjetër, disa gra, e sidomos ato nga grupmoshat më të reja, përgjegjësinë për ngacmimin seksual ia ngarkojnë viktimës duke shprehur bindjen se gratë po i provokojnë instinktet seksuale tek burrat me mënyrën se si vishen apo sillen dhe se duhet t'i pranojnë pasojat e sjelljeve të tilla.

"Unë do thosha që disa gra janë provokuese, ose siç thonë, "nëse bushtra nuk e tund bishtin, qentë nuk i vihen pas". Këto gra shkojnë në zyrën e kryetarit të komunës, veshin minifunde, dhe ia bëjnë vetë vetes".

Grua, 18-30 vjeç, shqiptare e Kosovës, vendbanim urban

Tabela 4.4: Përhapja e ngacmimit seksual

Në raste të caktuara, mund të keni përjetuar njerëz që ju drejtohen në mënyra që janë të padëshiruara dhe ofenduese. Sa shpesh, që kur keni qenë 15 vjeç dhe deri tani, e keni përjetuar ndonjëherë nga këto?

	Asnjë herë %	Një herë %	2-5 herë %	6+ here %
Kontakt, përqaqim ose puthje të padëshiruara	95	2	2	1
Ngulitje e syve në mënyrë të papërshtatshme sa ju ka ofenduar	82	4	7	4
Komente apo shaka seksuale sugjестive që ju kanë ofenduar	87	3	6	3
Dikush ju ka dërguar ose ju ka treguar fotografi, pamje ose dhurata me përmbajtje seksuale që ju kanë ofenduar	96	1	1	0.3
Ftesa të papërshtatshme për të dalë në një takim	90	3	4	2
Pyetje të papërshtatshme në lidhje me jetën tuaj private që ju kanë ofenduar	85	3	7	4
Komente të papërshtatshme në lidhje me pamjen tuaj që ju ka bërë të ndiheni të ofenduar	88	3	5	2
Emaille ose mesazhe seksuale të padëshiruara që ju kanë ofenduar	87	1	2	1
Veprime të papërshtatshme në faqet e rrjeteve sociale si Facebook, apo në bisedat në internet që ju kanë ofenduar?	79	1	3	1
Dikush është ekspozuar në mënyrë të pahijshme para jush	97	2	1	0.3
Dikush ju ka detyruar të shikoni ose vështroni materiale pornografike pa dëshirën tuaj	98	0.3	0.3	0.1

BAZA: 1,990 gra të moshave 18–74 vjeç në Kosovë

BURIMI: Studim i udhëhequr nga OSBE-ja mbi dhunën ndaj grave (2018)

Gati dy të tretat e grave të cilat kanë përjetuar ngacmim seksual thonë që nuk njihnin kryesin (64%, krahasuar me mesataren e BE-së prej 68%). Ndonjë mik, i njohur apo fqinj është identifikuar si kryerës nga 24% e viktimeve të ngacmimeve seksuale, që është më pak se në BE (31%),⁵⁴ ndërsa 13% thonë se kryesi ka qenë i afërm apo familjar. Pak më shumë se një e treta (34%) thonë se kryesi ka qenë dikush tjetër të cilin e njihnin por pa e specifikuar se nga cila kategori⁵⁵ (ngjashëm me prevalencën evropiane prej 35%).

Ndërsa kryerësit e ngacmimeve seksuale prirën të jenë burra, kjo gjë jo çdoherë qëndron. Burrat identifikohen si kryerës nga 46% të grave të cilat thonë të kenë përjetuar ngacmim seksual, ndërkaq gratë përmenden nga vetëm 7% e viktimeve, e 38% thonë që edhe burrat edhe gratë kanë qenë të përfshirë. Kryerëset femra më së shpeshti janë nga kategoria e familjes së vetë viktimës.

4.4: Dhuna fizike dhe seksuale nga jopartnerët

Shtatë për qind e grave thonë të kenë përjetuar një a më shumë forma të dhunës fizike⁵⁶ nga një jopartner qysh prej moshës 15-vjeçare (2% në 12 muajt e fundit), ndërsa 1% u janë nënshtruar formave të dhunës seksuale nga një jopartner që në moshën 15 vjeçare (Figura 4.3).

Këto shifra janë dukshëm më të ulëta se ato në nivel të mbarë BE-së në vitin 2012 (Figura 3.8). Në BE, mesatarisht 20% e grave kanë raportuar dhunë fizike nga jopartneri (duke filluar nga 10% në Austri, Greqi, Poloni dhe Portugali, deri në 36% në Danimarkë), ndërsa 6% kanë raportuar të kenë përjetuar dhunë seksuale nga jopartnerët, duke filluar nga 1% në Greqi e Portugali, deri në 12% në Suedi.


Këto statistika përfshijnë të gjitha përvojat e dhunës, (siç u janë paraqitur intervistuesve), përfshirë edhe dhunën e lidhur me konfliktin. Siç është diskutuar në kapitullin 5, 10% e grave të cilat cilësohen si të prekura nga konflikti dhe që kanë përjetuar dhunë të shkaktuar nga një jopartner, e lidhin këtë përvojë me konfliktin që kanë përjetuar, dhe përhapja e raportuar e dhunës fizike apo seksuale të shkaktuar nga jopartnerë nuk dallon mes atyre që janë prekur drejtpërdrejt nga konflikti dhe atyre që nuk janë prekur. Mund të pritet që shkalla e gjithmbarshme e përhapjes e dhunës, ose ajo në mesin e grave të prekura nga konflikti, të jetë më e lartë, veçanërisht duke pasur parasysh se tri të katërtat e grave janë përkufizuar si të prekura nga konflikti në Kosovë. Megjithatë, siç shpaloset në studimin cilësor, besimi se dhuna mund të nxitet nga viktima ose që viktimat janë në një farë mënyre përgjegjëse, mbizotëron ende në Kosovë. Kjo, përveç ndjenjave të turpërimit dhe traumave të shkaktuara nga konflikti midis grave të prekura nga ai, do të thotë se ka shumë gjasë që dhuna e shkaktuar nga jopartneri të jetë raportuar më pak seç ndodhë në të vërtetë në këtë studim.

54 Anketa e FRA përfshinte kategorinë e "mikut/të njohurit", por jo "fqinjin".

55 Kategoritë qenë "partneri aktual", "partneri i mëhershëm", "shefi/mbikëqyrësi, kolegu/bashkëpunëtori, klienti/konsumatori/pacienti, mësuesi/trajneri/mentori, kolegu i shkollës, mjeku/punonjësi shëndetësor, anëtari i familjes/familjes së partnerit, një pretendent/dikush që sapo keni takuar - secili nga këta është përmendur në përmasa më të vogla.

56 Përhapja e dhunës fizike llogaritet në bazë të numrit të grave që thonë se kanë përjetuar së paku një nga format e mëposhtme të dhunës që nga moshën 15 vjeçare ose në 12 muajt e fundit: Ju kanë shtyrë apo shtrirë në tokë, Ju kanë qëlluar me shpullë, Ju kanë qëlluar me një objekt të fortë, Ju kanë kapur me forcë ose ju kanë tërhequr për flokësh, Ju kanë qëlluar me grusht apo me një objekt të fortë, ose ju kanë shqelmuar, Ju kanë djegur, janë përpjekur t'ju mbysin apo t'ju marrin frymën, Ju kanë prerë ose ju kanë qëlluar me thikë, Ua ka përplasur kokën kundër diçkaje.

Figura 4.4: Përhapja e dhunës fizike dhe seksuale nga jopartneri




Format më të përhapura të dhunës fizike nga jopartnerët në Kosovë janë goditja me shuplakë (që prekë 5% të grave gjatë jetës së tyre), shtyrja apo shtrirja në tokë me forcë (3%), ndërsa secila nga format e dhunës seksuale për të cilat u pyetën gratë, nuk shkon më shumë se 1%.

Incidenti më i rëndë i kryer nga një jopartner (ai me më së shumti ndikim tek gruaja, përfshirë kërcënimet me dhunë nga jopartnerët), ka tendencë të jetë fizike dhe jo seksuale (figura 4.5). Për një të tretën e grave që raportojnë se kanë përjetuar forma të dhunës nga një jo-partner, incidenti më i rëndë përfshin goditjen me shuplakë (31%), ndërsa për rreth një të pestën përfshihet ai i shtyrjes me forcë (23%, respektivisht 19%). Dymbëdhjetë për qind e incidenteve më serioze nga një jopartner kanë ndodhur në 12 muajt e fundit para studimit.

Figura 4.5: Incidentet më të rënda të dhunës së ushtruar nga jopartneri


Dua që të mendoni për incidentin më të rëndë nga një jopartner. Cilat nga këto gjëra në këtë kartelë kanë ndodh në atë kohë? Me shprehjen “më i rëndë”, ne nënkuptojmë incidentin që ka pasur më së shumti ndikim tek ju.



Shtatë nga dhjetë incidentet më të rënda të dhunës (72%) kanë ndodhur në një shtëpi a banesë, në shumicën e rasteve në shtëpinë e gruas (Figura 4.6). Njëlloj dhe në BE incidentet më të rënda kanë ndodhur në një shtëpi ose banesë (41%), por ishte më e zakonshme që veprimi të ndodhte edhe në rrugë (18% në krahasim me 12% në Kosovë).

Figura 4.6: Vendndodhja e incidenteve më të rënda të dhunës së ushtruar nga jopartneri

Kur mendoni për incidentin më të rëndë të dhunës së ushtruar nga jopartneri, ku ka ndodhur ai?



4.4.1: Kryerësit

Kryerësit jopartnerë të dhunës fizike më së shpeshti identifikohen si të afërm të viktimës (30%), i afërm i partnerit të viktimës (11%) ose dikush tjetër të cilin viktimja e njihje por pa saktësuar se cilës nga kategoritë e paraqitura i takon (23%).⁵⁷ Të afërmit ishin gjithashtu kryerësit më të përmendur në BE (31%).

Analiza e kryerësve jopartnerë të dhunës seksuale është e kufizuar për shkak të numrit të vogël të grave që raportojnë një përvojë të tillë. Ndër ato të cilat raportojnë një përvojë të tillë, kryerësit që identifikohen më së shpeshti janë ose dikush të cilin e njihje viktimja, por nuk saktësojnë se në cilën kategori bie siç i paraqitet të anketuarit (shtatë raste), ose dikush të cilin viktimja nuk e njihje më parë (pesë raste).

Burrat janë identifikuar si kryerës të dhunës fizike të shkaktuar nga jopartneri nga 68% e grave të cilat kanë përjetuar Dhunë e ushtruar nga jopartneri, ku 48% e të mbijetuarave cekin vetëm burrat ndërsa 20% edhe burra edhe gra. Gratë identifikohen si kryerës nga 37% e viktimave (ku 18% cekin vetëm gratë). Pjesa tjetër e mbetur (15%) nuk e dinë gjininë e kryerësit apo nuk parapëlqejnë ta zbulojnë atë. Pesëdhjetë e gjashtë për qind e të mbijetuarave të dhunës seksuale nga jopartneri thonë se kryerësi ishte burrë dhe 3% thonë se ishte grua, ndërsa pjesa tjetër e mbetur nuk e dinë apo nuk parapëlqejnë ta thonë atë.⁵⁸

Gratë të cilat morën pjesë në studimin cilësor deklaruan se kryerësit e dhunës së ushtruar nga jopartner kishte më së shumti të ngjarë të ishin anëtarë të familjes (përfshirë familjen e gruas ose familjen e partnerit të saj), kolegë të punës ose njerëz me poste zyrtare si zyrtarët policorë.

⁵⁷ Kategoritë përfshijnë 'shëfën / mbikëqyrësin', 'kolegun / bashkëpunëtorin', 'klientin/klientin/pacientin', 'mësuesin/trajnerin', 'bashkë-studentin', 'mjekun/punonjësin e kujdesit shëndetësor', 'të afërmin/anëtarin e familjes (përveç partnerit)', 'të afërmin/anëtarin e familjes së partnerit', 'një pretendent/dikush që sapo keni takuar'.

⁵⁸ Duke pasur parasysh bazën e vogël (n=35), duhet të ushtrojmë kujdes gjatë interpretimit të këtyre gjetjeve.

Siç u tha më lart, gjetjet e anketës tregojnë se të afërmit janë ndër ata që zakonisht raportohen si kryerës të dhunës fizike, por gjatë intervistave të hollësishme nga gratë u raportuan dhe disa raste të dhunës fizike apo seksuale në duart e ushtarëve.

Megjithatë, në studimin cilësor u vu re se gratë përgjithësisht besonin se shkalla e dhunës fizike e ushtruar nga anëtarët e familjes së partnerit kishte pësuar rënie. Ato thanë se gratë zakonisht ishin mësuar që t'i nënshtroheshin sulmeve fizike nga gjithë anëtarët e familjes së burrit, si nga kunati apo vjehëria e tyre, mirëpo, tani gjasat janë më të vogla që të ndodhë një gjë e tillë dhe se një grua mund të jetë në rrezik vetëm nga dhuna e ushtruar nga partneri.

Një nga të mbijetuarat e dhunës përshkroi përvojën e saj të dhunës psikologjike të ushtruar nga familja e bashkëshortit të saj. Burri i saj jetonte jashtë vendit pothuajse përgjatë gjithë vitit, ndërsa ajo jetonte me nënën dhe vëllezërit e motrat e tij. Familja në fjalë e kontrollonte gruan në çdo gjë, madje ata ushtronin edhe dhunë verbale ndaj saj dhe e shprehnin qartë se nuk dëshironin që ajo të ishte pjesë e familjes së tyre.

“Familja e tij nuk më donte. Më thoshin: “Përse vallë të jetë kaq i dashuruar me ty? Ti nuk e meriton aspak. Nuk bën asgjë për ta merituar dashurinë e tij.” Kështu, familja e tij filloi të më urrente. Pastaj, fati deshi që unë të bëhesha me një vajzë, por ata më thoshin: “Duhet të ishte djalë, jo vajzë.”

E mbijetuar e dhunës së lidhur me konfliktin dhe dhunës që nuk lidhet me konfliktin

Një e katërta e incidenteve që janë identifikuar si më të rëndat janë kryer nga dikush që ose ishte i dehur ose ishte nën ndikimin e drogës (26%). Në mbi dy të tretat e incidenteve të cilësuar si më të rëndat, kryerësi ka vepruar i vetëm (70%).

Kryerësit e dhunës fizike nga jopartneri më së shpeshti identifikohen si i afërm i viktimës

4.5: Përjetimi i dhunës gjatë fëmijërisë


Pothuajse një e katërta e grave në Kosovë (23%) raportojnë të kenë përjetuar një formë dhune në duart e një të rrituri⁵⁹ —dhunë fizike, psikologjike ose seksuale - kur ishin ende fëmijë (para se të bëheshin 15 vjeç).

⁵⁹ Dhuna në fëmijëri i referohet dhunës para moshës 15 vjeçare. Në lidhje me dhunën fizike para moshës 15 vjeçare, grave iu parashtruan pyetjet si në vijim: Para moshës 15 vjeç, sa shpesh një i rritur që ishte 18 vjeç ose më i madh ju ka bërë si më poshtë: 1) Ju ka goditur shuplakë apo kapur për flokë sa që ju ka shkaktuar dhimbje? 2) Ju ka goditur shumë sa që ju ka shkaktuar dhimbje? 3) Ju ka shkelmuar shumë sa që ju ka shkaktuar dhimbje? 4) Ju ka rrahur me një mjet, si shkopi, bastuni apo rripi? 5) Ju ka therur apo prerë me diçka? Në lidhje me dhunën seksuale para moshës 15 vjeçare, grave iu parashtruan pyetjet si në vijim: Para moshës 15 vjeç, sa shpesh një i rritur që ishte 18 vjeç ose më i madh ju ka bërë si më poshtë edhe pse ju nuk donit: 1) I ka ekspozuar organet gjenitale para jush? 2) Ju ka bërë që të pozoni zhveshur para ndonjë personi, ose në fotografi, video apo kamerë interneti? 3) Ju ka prekur organet gjenitale apo gjinjte kundër vullnetit tuaj? 4) Ju ka detyruar që të kenë marrëdhënie seksuale? Në lidhje me dhunën psikologjike para moshës 15 vjeçare, grave iu parashtruan pyetjet si në vijim: Para moshës 15 vjeç, sa shpesh një anëtar i familjes së rritur ka bërë gjërat si në vijim ndaj jush: 1) Ju ka thënë se nuk ju duan? 2) Ju ka thënë se ma mirë mos të kishit lindur fare? 3) Ju ka kërcënuar t'ju braktis apo largojë nga shtëpia e familjes?

Një në pesë gra thonë të kenë përjetuar një nga format e dhunës fizike të listuara në figurën 4.7 nga një i rritur (21%), krahasuar me një të katërtën e grave në BE (27%). Më së shpeshti, ato janë qëlluar me shuplakë ose u tërhequr flokët deri në dhimbje (18%, krahasuar me 22% në BE), por një në dhjetë gra tregojnë të jenë rrahur shumë me thupër, bastun ose rrip (9%), përqindje kjo e njëjlojtë si në BE). Katër për qind e grave kanë raportuar të kenë përjetuar dhunë psikologjike në fëmijëri. Më pak se 1% raportojnë dhunë seksuale në fëmijëri. Kjo është shumë më e ulët se mesatarja e BE-së prej 12% (duke filluar nga 1% në Rumani dhe 2% në Kroaci deri në 20% në Francë dhe Holandë). Edhe në këtë rast, vendet ku gratë mendojnë se dhuna në familje është një çështje private priren të kenë dhe numra më të ulët të grave që flasin mbi këto përvoja sesa vendet ku ka një traditë më të gjatë të ndërgjegjësimit mbi dhunën ndaj grave.

Figura 4.7: Përvojat e dhunës fizike para moshës 15 vjeçare


Para moshës 15 vjeç, sa shpesh një i rritur ju ka bërë si më poshtë?



Format më të zakonshme të dhunës në fëmijëri në të shumtën e rasteve ushtrohen nga anëtarët e familjes së fëmijës. Incidentet si të qëlluarit me shpullë, tërheqja nga flokët e fëmijës apo goditja me ndonjë send të fortë janë veprime që shpesh rezultojnë të kryhen nga nëna e fëmijës, përcjellë nga babai. Ndonëse në përqindje shumë më të vogël, ushtrues të këtyre dy formave të dhunës në fëmijëri janë gjithashtu edhe mësuesit meshkuj.

Siç ilustron dhe në figurën 4.7, një dhunë e tillë nuk ka gjasa të jetë një ngjarje e njëhershme. Për shumicën e formave të dhunës fizike në fëmijëri, shumica e atyre që thonë ta kenë përjetuar thonë që u ka ndodhur më shumë se një herë.

Gratë të cilat kanë përjetuar ndonjë formë të dhunës në fëmijëri kanë më shumë gjasa të thonë se kanë përjetuar dhunë fizike ose seksuale nga partneri apo një jopartner: 18% e grave të cilat kanë përjetuar dhunë gjatë fëmijërisë thonë se kanë përjetuar dhunë nga jopartneri, krahasuar me 5% të atyre të cilat nuk kanë përjetuar dhunë gjatë fëmijërisë. Për dhunën nga partneri aktual, shifrat gjegjëse janë 17% dhe 7%, ndërsa për dhunën e ushtruar nga partneri i mëhershëm ato janë përkatësisht 32% dhe 12%.



Gati tre të katërtat e grave në Kosovë mund të cilësohen si të prekura drejtpërdrejtë nga konflikti.



Më shumë se tetë nga dhjetë gra të cilat kanë përjetuar konfliktin janë detyruar të braktisin shtëpitë e tyre— kryesisht nga 1 deri në 12 muaj

5. Konflikti dhe dhuna

5.1: Përjetimet e lidhura me konfliktin

Për qëllimet e këtij studimi, konflikti i armatosur përkufizohet si luftim me armë mes dy ose më shumë grupeve të organizuara, sulme mbi komunitetet ose pasiguri të përgjithshme të shkaktuara nga konflikti.

Dy të tretat e të gjitha grave në Kosovë tregojnë të kenë jetuar në një situatë ku ka pasur konflikt aktiv të armatosur për një periudhë të paktën njëjavore. Shumica e tyre e kanë përjetuar konfliktin e Kosovës (68%), një e treta ndërhyrjen e NATO-s në vitin 1999 (34%), 5% trazirat e marsit në vitin 2004, dhe një numër më i vogël tregojnë të kenë përjetuar dhe konflikte të tjera.

Shumica e grave që thonë se kanë jetuar gjatë një periudhe konflikti të armatosur përjetuan po ashtu një a më shumë nga përvojat e mëposhtme:

- Më shumë se nëntë në dhjetë gra raportuan të kishin dëgjuar të shtëna armësh ose zhurmën e sulmeve ajrore ose bombardimeve me artileri në zonën lokale ku ato jetonin në kohën e konfliktit (91%);
- Përqindje e ngjashme (85%) jetonte në një vend ku persona të armatosur (grupe ushtarake apo grupe tjera të armatosura) ishin vendosur ose lëviznin në masë për të paktën një periudhë njëjavore;
- Më shumë se gjysma kanë qenë dëshmitare të luftimeve në zonën ku jetonin në kohën e konfliktit (55%);
- Për dy të tretat e grave të cilat e kanë përjetuar konfliktin (66%), familjarët e tyre të ngushtë kishin pasuri (si shtëpi, makina ose bagëti të tyre) që u shkatërrua ose dëmtua rëndë si rrjedhojë e konfliktit. Në shumicën e rasteve (61%), pasuria e tyre u grabit nga persona të armatosur.

Përjetimi i konfliktit pati një ndikim shumë të madh në jetën e këtyre grave:

- Tetë nga dhjetë syresh raportuan se u është dashur t'i lëshonin shtëpitë e tyre (83%);
- Mbi dy të tretat nuk kanë arritur të gjejnë punë në zonën ku banonin për shkak të konfliktit (70%) - 87% në rajonin veriperëndimor me shumicë serbe të Kosovës;
- Gati dy të pestat kishin një bashkëshort ose anëtar të familjes që kishte marrë pjesë në luftime (39%) - 53% në rajonin veriperëndimor - dhe 5% e vetë grave morën pjesë aktive në luftime gjatë konfliktit;
- Gjysma jetonte në një zonë ku civilët ose ndaloheshin ose burgoseshin (48%) ose ku civilët vdisnin për shkak të konfliktit (53%).

Si përfundim, tre të katërtat e grave mund të konsiderohen të prekura nga konflikti - të cilësuar si gra që kanë jetuar përgjatë një periudhe konflikti dhe që kanë të paktën një nga përvojat e lidhura me konfliktin të diskutuara më sipër.

Shumë gra të prekura nga konflikti⁶⁰ tregojnë të kenë përjetuar pasoja tjera siç renditen në tabelën 5.1. Dyzet e pesë për qind ishin ndikuar nga mosprania e burrave të familjes të cilët ishin larguar nga shtëpia për shkak të konfliktit, derisa një përqindje të ngjashme (44%) raportuan se shërbimet shëndetësore që ato përdornin më parë ose nuk ishin të disponueshme ose ishin të paarrtshme për një periudhë më të gjatë kohe. Kosova Veriperëndimore ishte një zonë që u prek veçanërisht: 62%, përkatësisht 55% e grave të prekura nga konflikti në këtë rajon patën këto përvoja.

Tabela 5.1: Përvojat e grave të prekura drejtpërdrejtë nga konflikti

Ju lutemi na tregoni nëse keni përjetuar ndonjëherë prej gjërave në vijim gjatë konfliktit të armatosur në të cilin keni kaluar:

	Po%
Burrat në familjen tonë (bashkëshortët, baballarët, vëllezërit) ishin larg shtëpisë dhe familjes (për shkak se u desh të iknin, luftonin në konflikt, ishin të ndaluar, u zhdukën)	45
Shërbimet shëndetësore (përfshirë shërbimet shëndetësore për gratë) që më parë i përdornit nuk ishin në dispozicion apo ishin të paqasshme për një periudhë të gjatë kohore.	45
Nuk kishte agjenci të zbatimit të ligjit (polici apo organizatë tjetër për të ruajtur rendin e qetësinë) në zonën tuaj lokale për një kohë të gjatë.	35
Gratë në familjen tonë u desh të shkonin në vende potencialisht të rrezikshme (d.m.th, përmes vijës së frontit/kufirit apo në afërsi të mjeteve eksplozive si minat) për të punuar apo për të mbledhur gjësende bazike për shtëpinë (dru zjarri, ushqim, ujë të pijshëm, derivate etj.).	22
Një anëtar i familjes së ngjishte apo bashkëshorti/partneri u plagos apo vdiq si pasojë e luftimeve /dhunës?	22
Pjesëtarët e grupeve të armatosura kanë ngacmuar gratë vendase në zonën ku ju keni jetuar.	11
Grupet e armatosura qëllimisht kanë përdorur kërcënimet, thashethemet apo ushtronin faktikisht dhunë ndaj grave për të tmerruar popullsinë lokale në zonën ku ju keni jetuar.	11
Pjesëtarët e grupeve të armatosura kanë përdorur praktika tepër poshtëruese ndaj grave vendase në zonën ku ju keni jetuar.	6
Rrethanat i kanë shtyrë gratë që të ofrojnë shërbime seksuale në këmbim për të mirat bazike apo për të pasur siguri për familjen e tyre në zonën ku jetonit.	5

BAZA: 1,562 gra, të moshës 18–74 vjeçare në Kosovë të cilat janë prekur nga konflikti i armatosur

BURIMI: Studim i udhëhequr nga OSBE-ja mbi dhunën ndaj grave në Kosovë (2018)

5.2: Konflikti dhe dhuna ndaj grave

60 Përkufizimi i 'të qenit i prekur nga konflikti' është kur dikush ka jetuar në një situatë ku ka pasur një konflikt aktiv dhe të armatosur për një periudhë prej së paku një javë dhe iu përgjigjur me po të paktën njëherë prej pyetjeve si në vijim: "A keni dëgjuar gjuajtje me armë, zhurmë të bombardimeve apo gjuajtjeve me artileri në zonën lokale ku ju keni jetuar gjatë kohës së konfliktit?" "A keni jetuar për së paku një javë në një vend kur personeli i armatosur (ushtria e rregullt apo ndonjë grup tjetër i armatosur) ka qenë i stacionuar apo ka lëvizur në numra të mëdhenj? Kjo mund të përfshijë banorët lokal që kanë marrë pjesë në konflikt." "A keni qenë dëshmitar i luftimeve në zonën lokale ku ju keni jetuar gjatë kohës së konfliktit?" "A është shkatërruar apo dëmtuar rëndë, si pasojë e konfliktit, pasuria e familjes suaj (p.sh., shtëpia juaj, vetura, bagëti)?" "A është marrë pasuria (p.sh., shtëpia juaj, vetura, bagëti) e familjes tuaj nga ndonjë grup i armatosur?" "A ka qenë e pamundshme për të gjetur punë në zonën lokale për shkak të konfliktit (zyrat/fabrikat ishin të mbyllura apo të shkatërruara, ose ishte tepër e rrezikshme)?" "A ka marrë pjesë ndonjë anëtar i familjes suaj apo burri a partneri juaj në konflikt ose a ka luftuar si pjesëtar i ndonjë grupi të armatosur?" "A keni pasur rol aktiv në luftimet gjatë konfliktit?" "A ishin civilët nga zona lokale, ku ju jetonit, të ndaluar apo të burgosur?" "A kanë vdekur civilët në zonën lokale ku ju jetonit si pasojë e konfliktit?" "A keni qenë personalisht i sulmuar fizikisht apo i plagosur si pasojë e konfliktit?" "A është dashur që të largoheni nga shtëpia juaj gjatë konfliktit që keni përjetuar?"

Gratë e identifikuar si të prekura nga konflikti u pyetën nëse përvojat e tyre të ngacmimeve seksuale apo dhunës fizike dhe seksuale nga partnerët ose jopartnerët ishin të lidhura me konfliktin e armatosur apo jo.

Nga gratë që pohojnë të kenë përjetuar dhunë fizike apo seksuale nga jopartnerët dhe që janë prekur nga konflikti, rreth 21% thonë se përjetimet e tyre ishin të lidhura me konflikt të armatosur, përqindje kjo që shkon në 32% kur u pyetën për incidentin më të rëndë që kishin përjetuar.

Pak më shumë se një e treta e grave të cilat kanë pasur partner ndonjëherë dhe janë prekur nga konflikti, e lidhin përvojën e tyre të dhunës fizike dhe/ose seksuale nga partneri intim me konfliktin, përqindje kjo që shkon në 38% kur pyeten për incidentin e tyre më të rëndë.

Megjithëkëtë, gratë e prekura nga konflikti nuk raportojnë të kenë përjetuar dhunë më shpesh sesa gratë që nuk janë prekur nga konflikti.

Reagimet psikologjike ndaj dhunës tek gratë që kishin përjetuar konflikt të armatosur në përgjithësi nuk përcilleshin me dallime të mëdha, qoftë edhe nëse dhuna ishte ushtruar nga partneri aktual, partner i mëparshëm ose jopartner.

Një e treta e atyre që kanë sëmundje ose problem shëndetësor kronik apo që janë të kufizuara për shkak të ndonjë problemi shëndetësor dhe që janë të prekura nga konflikti ia atribuojnë gjendjen e tyre shëndetësore konfliktit të cilin e kanë përjetuar (31%).

Të mbijetuarat e dhunës së lidhur me konfliktin të cilat ishin pjesë e këtij studimi cilësor, përshkruan përjetime të dhunës së rëndë fizike dhe seksuale, përfshirë brenda shtëpive të tyre dhe gjetkë, si për shembull në qendra të e përkohshme ushtarake të paraburgimit.

Një grua ka përshkruar se si kishte përjetuar dhunë psikologjike, seksuale e fizike për një kohë të gjatë në shtëpinë e saj. Ngjarja në vijim është përshkrim i rrëfimit të saj dhe i përvojës së saj për t'ju qasur shërbimeve tjera:

Rast studimor: Tregimi i A.

- A. ishte 14 vjeç në kohën kur nisi konflikti. Ajo jetonte me prindërit e saj dhe motrat më të vogla.
- Kur ishte 16 vjeç, babai i saj u fsheh dhe kur disa burra, të cilët ajo mendon se ishin nga ushtria, hynë në shtëpinë e tyre, nëna e saj u rrah dhe u dhunua para gjithë familjes deri në pikën e nevojës për kujdes të menjëhershëm mjekësor. Ndërsa nëna e saj ishte e pavetëdijshme, A. dhe motra e saj 13-vjeçare u përdhunuan nga burra të shumtë.
- Kur burrat u larguan, A. dhe familja e saj udhëtuan në një fshat tjetër dhe u fshehën aty. Në atë kohë asaj ju ofrua kujdes mjekësor për dhunën fizike, por asnjë mbështetje tjetër.
- Asaj i përshkruan disa medikamente pasuese, por që nuk i bleu nga frika se mos dikush do ta njihte në qendrën mjekësore dhe do të zbulonte se çfarë i kishte ndodhur.

“Unë nuk doja të rrezikoja të humbisja gjithçka që kisha. Ata thanë se ne duhej të merrnim disa injeksione. Ne nuk dinim çfarë të bënim, dhe nuk dinim se çfarë mund të na bënin mjekët dhe nuk donim që ata të mësonin se çfarë na kishte ndodhur”.

E mbijetuar e dhunës së lidhur me konfliktin


- Ajo nuk i tregoi askujt për përvojën. Kur u martua, ajo kishte frikë se burri i saj nuk do ta pranonte nëse e dinte se ishte përdhunuar dhe, për rrjedhojë, kur ai e kishte pyetur nëse ishte e virgjër, ajo i kishte thënë se kishte pasur një lidhje.
- Vite më vonë një mike i sugjeroi që ta vizitonte një OJQ që po ndihmonte gratë që kishin pasur përvoja dhune në konflikt dhe kjo ishte hera e parë që ajo foli mbi përvojën e saj

Ndër ato që kanë përjetuar dhunë të ushtruar nga partneri ose jopartneri që nga moshën 15 vjeçare, 4% janë sulmuar ose kërcënuar me armë zjarri (20 të anketuara).


6. Ndikimi i dhunës në jetët e grave dhe pengesat për të kërkuar mbështetje >>



Tre të katërtat e grave të cilat kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga jopartneri raportojnë të kenë ndjerë ndikimin e së paku një nga reagimet e shumta psikologjike si rrjedhojë e incidentit më të rëndë të përjetuar.



Më shumë se një e treta e grave (39%) të cilat raportojnë të kenë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partnerët ose jopartnerët e tyre kanë vuajtur nga një ose më shumë lëndime fizike si rezultat i incidentit më të rëndë të përjetuar.



Policia u informua apo mësoi për incidentin më të rëndë në vetëm 2% të rasteve të dhunës së ushtruar nga partneri aktual.

6. Ndikimi i dhunës në jetët e grave dhe pengesat për të kërkuar mbështetje


Ky kapitull ofron një pasqyrë të ndikimit që dhuna ka në mirëqenien e grave, nëse i kanë raportuar përjetimet e tyre diku dhe, nëse po, sa kanë qenë të kënaqura me përgjigjen. Gjatë këtyre pyetjeve, gratë u pyetën për ndikimin e incidentit më serioz të dhunës fizike ose seksuale të përjetuar, përfshirë edhe kërcënimet për përdorimin e të dyjave. Incidenti më serioz është përkufizuar si incidenti që ka ndikuar më së shumti te gruaja, qoftë në kuptimin psikologjik apo fizik.

6.1: Efektet psikologjike dhe lëndimet fizike

Pothuajse të gjitha gratë që raportuan përvoja të dhunës fizike ose seksuale kishin ndjerë të paktën një nga reagimet emocionale në tabelën 6.1. Pavarësisht marrëdhënies së gruas me kryerësin, zemërimi, bezdisja dhe frika janë reagimet më të shpeshta të dhëna ndaj incidentit më të rëndë të dhunës në Kosovë (si dhe në BE). Të mbijetuarat e dhunës së shkaktuar nga jopartnerët ishin veçanërisht më me gjasë të raportojnë se janë frikësuar nga dhuna që kanë përjetuar.

Tabela 6.1: Reagimet emocionale ndaj dhunës fizike dhe/ose seksuale (incidenti më i rëndë)

Kur rikujtoni incidentin më të rëndë, a e keni përjetuar ndonjërin nga ndjenjat e mëposhtme si pasojë e tij?




Pra, pothuajse të gjithë ato gra që kanë përjetuar ngacmim seksual kishin ndër të paktën një nga emocionet në tabelën 6.1. Ndërkohë që ndjesia e frikës ishte ajo që u përmend më pak në krahasim me përgjigjet e tjera mbi incidentin më të rëndë (28%), reagimi më i zakonshëm në përgjithësi ishte zemërimi - që ishte ndërë nga rreth gjysma e grave të prekura në secilin rast (46%).

Pjesa më e madhe e të mbijetuarave të dhunës fizike dhe/ose seksuale të ushtruar nga partneri intim ose jopartneri, kanë ndërë të paktën një nga reagimet psikologjike të renditura në tabelën 6.2 si rezultat i incidentit më të rëndë të dhunës. Vështirësitë në gjumë, ankthi, humbja e vetëbesimit, depresionin dhe ndjenja e të qenit krejt e dobët janë ndërë reagimet më të zakonshme, pavarësisht nëse kryerësi ishte një partner aktual, ai i mëparshëm apo dikush tjetër. Vështirësia në marrëdhënie gjithashtu përbën çështje për të mbijetuarat e dhunës së ushtruar nga partneri i mëparshëm. Gratë më të moshuara ka më shumë gjasë të thonë se nuk kanë pasur ndonjë nga këto reagime.

Tabela 6.2: Reagimet psikologjike ndaj dhunës fizike dhe/ose seksuale (incidenti më i rëndë)

Kur rikujtoni incidentin më të rëndë, a keni vuajtur nga ndonjë vështirësi nga të mëposhtmet si pasojë e tij?



	Partneri aktual	Partneri i mëparshëm*	Jopartneri
	%	%	%
Vështirësi në gjumë	43	27	32
Ankth	26	29	31
Ndenja e të qenit e cenueshme	24	15	20
Humbja e vetëbesimit	24	23	24
Depresioni	23	20	32
Vështirësi në të koncentruar	14	12	16
Vështirësi në raporte	12	28	13
Sulme paniku	11	13	28
Asnjëra	33	40	24

BAZA:
Gratë në Kosovë, moshë 18–74 vjeç, të cilat kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale që nga moshë 15 vjeçare dhe të cilat kanë identifikuar një incident më të rëndë: dhunë nga partneri aktual (149), partneri i mëparshëm (49) ose jopartneri (131)

*SHËNIM: bazë e vogël (49) për partnerin e mëparshëm

BURIMI:
Studim i udhëhequr nga OSBE-ja për dhunën ndaj grave (2018)

Studimi cilësor tregoi se gratë që kishin përjetuar dhunë si pasojë e konfliktit shpeshherë ishin ndikuar më së shumti në kuptimin psikologjik nga përvoja në fjalë. Disa thanë se në kohën kur ndodhi dhuna, ato më parë do të donin të kishin vdekur në vend se të kishin mbijetuar, ashtu që të mos jetonin me ndjenjën e asaj që u kishte ndodhur.

Gjithashtu, disa kishin frikë se njerëzit e tjerë mund ta zbulonin se çfarë u kishte ndodhur, duke përfshirë edhe burrat ose fëmijët e tyre, pasi mendonin se mund të fajësoheshin për atë që u kishte ndodhur. Para se të kërkonin ndihmë nga një OJQ, gratë përpiqeshin të shmangnin kujtimet e asaj që u kishte ndodhur, por sa herë që u vinin në mend i kaplonte trishtimi.

“Mund të kalojë gjysmë dite e të mos kem probleme, por pastaj përnjëherë nuk mund të përmbahem e filloj të qajë. Zgjohem, nuk e di çka të bëj, shikoj qiellin dhe e lus Zotin që të ma ruajë mendjen, sepse të gjithë duan të shprehin pikëllimin që kanë, këtë pikëllim që nuk na le të bëjmë gjumë”

E mbijetuar e dhunës së lidhur me konfliktin

Gratë që përjetuan dhunë si pasojë e konfliktit shpeshherë ishin prekur rëndë në kuptimin psikologjik nga përvojat e tilla

Më pak gra kanë vuajtur nga lëndime fizike apo pasojat e tyre se sa nga pasojat emocionale apo psikologjike si rezultat i incidentit më të rëndë të dhunës fizike dhe/ose seksuale, ndonëse shumë janë prekur edhe në këtë mënyrë. Rreth gjysma e atyre që përjetuan dhunë të ushtruar nga jopartneri; çereku i atyre që e përjetuan atë nga partneri i mëparshëm; dhe një e pesta që e përjetoi nga partneri aktual thonë se pësuan të paktën një nga lëndimet e renditura në tabelën 6.3 - më së shpeshti të nxira ose gërvishnje - në lidhje me incidentin më të rëndë.

Tabela 6.3: Lëndimet fizike që vijnë nga dhuna fizike dhe/ose seksuale (incidenti më i rëndë)

Kur rikujtoni incidentin më të rëndë, a ka rezultuar në ndonjërin si në vijim?

	Partneri aktual	Partneri i mëparshëm*	Jopartneri
	%	%	%
Mavijosje, gërvishnje	18	28	27
Lëndimet e brendshme	4	3	2
Plagë, ndrydhje, djegie	3	9	7
Tronditje apo ndonjë lëndim tjetër të trurit	3	5	13
Shtatzënia	3	5	2
Dështim (abort)	3	2	1
Thyerje, eshtra të thyer, dhëmbë të thyer	2	5	2
Infeksion apo sëmundje të transmetueshme seksualisht	2	1	1
Infertilitet apo paaftësi për ta përfunduar shtatzëninë	1	1	0
Asnjë lëndim	76	58	44
Nuk e din/refuzon	2	13	3

BAZA:
Gratë në Kosovë, moshë 18–74 vjeç, të cilat kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale që nga moshë 15 vjeçare dhe të cilat kanë identifikuar një incident më të rëndë: dhunë nga partneri aktual (149), partneri i mëparshëm (49) ose jopartneri (131)

*SHËNIM: bazë e vogël (49) për partnerin e mëparshëm

BURIMI:
Studim i udhëhequr nga OSBE-ja për dhunën ndaj grave (2018)


6.2: Përkrahja që duan të mbijetuarat e dhunës

Të gjithë të anketuarat të cilat kishin përjetuar dhunë fizike a seksuale u pyetën nëse do të kishin dashur të kishin ndonjë lloj të ndihmës pas incidentit më të rëndë që e kanë përjetuar. Në kuadër të kësaj pyetje u shtjelluan format e ndihmës që të mbijetuarat dëshironin si dhe boshllëqet në sigurimin e tyre krahasuar me kontaktimet që i kishin bërë gratë të cilat përjetuan dhunë për të cilat flet kapitulli 6.3.

Shumica e grave të cilat kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga një partner i mëparshëm (61%) ose nga një jopartner (68%) dhe dy të pestat (44%) e grave që kanë përjetuar dhunë nga partnerët e tyre aktual, pohuan se do donin të kishin pasur të paktën një nga format e informimit, këshillimit apo mbështetjes si më poshtë në tabelën 6.4. Burimi i përmendur më së shumti i informatave, këshillave apo mbështetjes që gratë thanë se do kishin dashur ta kenë pas incidentit të tyre më të rëndë të dhunës, si në Kosovë dhe në BE, ishte thjeshtë dikush që do mund t'i drejtoheshin e flisnin që do t'ju ofronte mbështetje morale. Mbrojtja nga dhuna dhe ngacmimet e mëtejshme, dhe marrja e ndihmës praktike, ishin veçanërisht të rëndësishme për ato gra, kryerësi i dhunës ndaj së cilave ishte një jopartner.

Tabela 6.4: Llojet e informacionit, këshilla dhe mbështetja që kërkoheshin pas incidentit

Cilin lloj të informatave, këshillave dhe përkrahjes mund të thoni se do të donit ta kishit pasur pas incidentit më të rëndë që e keni përjetuar?



	Partneri aktual	Partneri i mëparshëm*	Jopartneri
	%	%	%
Dikë për të folur/mbështetja morale	18	17	23
Informacion për sigurinë/parandalimin e krimit	7	8	4
Mbrojtja nga viktimizimi/ngacmimi i mëtejshëm	7	7	19
Mbështetja financiare	7	4	10
Ndihma praktike	6	10	23
Informata nga policia	5	12	14
Ndihma mjekësore	4	6	6
Ndihma për ta raportuar incidentin/marrja me policinë	3	0	6
Ndihma rreth sigurimit/kërkesës për kompensim	2	2	5
Asnjë nga këto/nuk ka kërkuar ndihmë	56	39	32

BAZA:
Gratë në Kosovë, moshë 18–74 vjeç, të cilat kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale që nga moshë 15 vjeçare dhe të cilat kanë identifikuar një incident më të rëndë: dhunë nga partneri aktual (149), partneri i mëparshëm (49) ose jopartneri (131)


*SHËNIM: bazë e vogël (49) për partnerin e mëparshëm

BURIMI:
Studim i udhëhequr nga OSBE-ja për dhunën ndaj grave (2018)

Më shumë se gjashtë në dhjetë gra kanë parë ose dëgjuar kohët e fundit reklamat për adresimin e fushatave kundër dhunës ndaj grave (62%). Rreth një e treta e grave ndiejnë se janë shumë mirë apo mirë të informuara për atë se çka duhet të bëjnë nëse vetë përjetojnë dhunë (35%), dhe edhe 29% ndiejnë se janë së paku disi të informuara, por 34% nuk ndihen të informuara apo nuk e dinë fare se çka duhet bërë. Gratë e reja dhe ato me arsimim të lartë kanë më shumë gjasa se gratë në moshë dhe ato me më pak arsimim të kenë parë reklamat e fushatave dhe të ndihen të informuara për atë se çka duhet të bëjnë nëse përjetojnë dhunë.

Figura 6.1: Ndërgjegjësimi për atë që duhet bërë pas përjetimit të dhunës

A mendoni se jeni të informuara mirë për atë që duhet bërë nëse përjetoni dhunë?



Në hulumtimin sasior, pjesëmarrëset u pyetën nëse kishin dëgjuar për ndonjërin nga tre organizatat në Kosovë që ofrojnë këshillim apo mbështetje për gratë që kanë përjetuar dhunë. Vetëm pak më shumë se gjysma kishin dëgjuar për ndonjërin nga këto organizata (51%). Rreth një e treta e grave (37%) njohën secilën nga këto dy organizata: Qendrën Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës dhe Shtëpinë e Sigurt (Gjakovë). Gratë e reja dhe më të arsimuara kishin më shumë gjasa se gratë më në moshë dhe më pak të arsimuara të kishin dëgjuar për ndonjërin prej tyre. Qendra Kosovare për Rehabilitim ishte më e njohur për ato në rajonin e Prishtinës dhe më pak e njohur në rajonin jugperëndimor. Shtëpia e Sigurt (Gjakovë) ishte më e njohur për ato që jetonin në rajonet juglindore dhe veriperëndimore. Linja ndihmëse për viktimat e krimit (Zyra e Prokurorit Publik) ishte më e njohur nga një çerek i grave (27%), pra më shumë në rajonet juglindore dhe veriperëndimore dhe ndër gratë me arsimim të lartë.

Brenda grupeve të diskutimit cilësor, është vënë re një ndërgjegjësim të kufizuar për ndonjërin prej shërbimeve të specializuara që mbështesnin gratë që përjetojnë dhunë dhe gratë të cilat morën pjesë supozonin se burimi i vetëm i mbështetjes do të ishte familja e tyre.

Gratë që kishin përjetuar dhunë të lidhur me konfliktin nuk kishin diskutuar për përvojat e tyre me askënd deri shumë vite pas ngjarjes dhe në rastet kur ato kanë folur, e kanë bërë ose me një mik të ngushtë ose kanë shkuar drejt në një OJQ të specializuar për mbështetje psikologjike. OJQ-të shiheshin si një vend më konfidencial ku gratë mund të shkonin dhe ku i prisnin punonjësit më dashamirës sesa policia apo personeli i autoriteteve të tjera.

"Këto OJQ nuk flasin për ngjarjen e ndodhur dhe kjo bën që gratë të kenë më shumë besim tek to ... Në këto OJQ ka gra që punojnë dhe tregojnë më shumë kujdes ndaj nesh, e ruajnë konfidencialitetin, ndërkohë që policia është më e pak e kujdesshme dhe më pak konfidenciale".

Grua, moshë 20-30 vjeçare, serbe e Kosovës, vendbanim rural

Më shumë se katër në pesë gra do ta konsideronin të pranueshme nëse mjekët në mënyrë rutine do t'i pyesnin nëse lëndimet që kanë në trup u janë shkaktuar si pasojë e dhunës (82%).


6.3: Raportimi i përvojës së dhunës dhe ngacmimit

Në këtë studim, gratë u pyetën nëse policia apo organizata të tjera ishin vënë në dijeni për incidentin më të rëndë të dhunës fizike ose seksuale. Këtu përfshiheshin edhe kërcënimet me dhunë fizike dhe seksuale.

Edhe pas incidenteve më të rënda të dhunës fizike dhe/ose seksuale, policia nuk u vu në dijeni për shumicën dërrmuese të rasteve, siç tregohet në figurën 6.2 më poshtë.

Figura 6.2: Kontakti me policinë pas incidentit më të rëndë të dhunës fizike dhe/ose seksuale


A është vënë në dijeni policia për incidentin më të rëndë?



Ka shumë pak gjasë që gratë të cilat identifikuan një incident më të rëndë ta kenë raportuar atë tek shërbimet e tjera përveçse në polici. Një gjë e tillë vlen sidomos në rastet e dhunës së ushtruar nga partneri aktual, ku 86% e grave nuk e kontaktuan as policinë e as ndonjë organizatë tjetër.

Tabela 6.5: Kontaktet pas incidentit më të rëndë të dhunës fizike dhe/ose seksuale

A keni kontaktuar ndonjërin nga shërbimet vijuese si rezultat e incidentit më të rëndë?



	Partneri aktual	Partneri i mëparshëm*	Jopartneri
	%	%	%
Mjeku, kujdesi shëndetësor apo ndonjë institucion tjetër i kujdesit shëndetësor	5	12	12
Spitali	4	8	13
Shërbimet sociale	3	6	1
Organizata me bazë fetare	3	6	7
Policia (vet raportim)	2	10	9
Shërbimet ligjore/avokati	1	5	3
Shërbimet/organizata tjetër	1	0	1
Organizatat për mbështetje të viktimës	0	8	1
Strehimorja e grave	0.2	1	0
Nuk është kontaktuar as ndonjë organizatë e as policia	86	77	65

BAZA:
Gratë në Kosovë, moshë 18–74 vjeç, të cilat kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale që nga moshë 15 vjeçare dhe të cilat kanë identifikuar një incident më të rëndë: dhunë nga partneri aktual (149), partneri i mëparshëm (49) ose jopartneri (131)

*SHËNIM: bazë e vogël (49) për partnerin e mëparshëm

BURIMI:
Studim i udhëhequr nga OSBE-ja për dhunën ndaj grave (2018)

Arsyet kryesore për mos kontaktimin e policisë ishin të njëjta qoftë kur kryerësi ishte partneri aktual qoftë dikush tjetër. Kryesisht, gratë mendonin se preferonin të merreshin më mirë vetë me incidentin ose të flisnin me miqtë/familjen (e cila është gjithashtu dhe arsyeja kryesore në të gjithë BE), ose me idenë se incidenti nuk ishte aq i madh sa për ta përfshirë policinë. Arsyet e tjera të rëndësishme përfshijnë frikën nga kryerësi, dëshira për të mos e ndarë përjetimin me askënd tjetër, turpi apo sikleti, dhe te gratë që kanë përjetuar dhunë nga partneri aktual, frika se mund t'i humbin fëmijët.

Tabela 6.6: Arsyet përse viktimat nuk kontaktojnë policinë

Pse nuk e keni kontaktuar policinë?

Pse nuk e keni kontaktuar policinë?	Partneri aktual	Partneri i mëparshëm	Jopartneri
	%	%	%
Jam marrë vet me të/kam përfshirë një mike/familjen në çështje	52	62	29
Ishte diçka e vogël/jo mjaft serioze/asnjëherë nuk më ka shkuar në mendje	34	22	30
Frika nga partneri/kryerësi	9	10	8
Turpi, sikleti	9	7	8
Nuk kam konsideruar se ata do të bëjnë diçka	9	3	8
Nuk kam dashur që dikush ta dijë/e kam mbajtur të fshehtë	8	5	11
Jam frikësuar se do t'i humbas fëmijët	8	1	-
Nuk kam dashur që partneri im/kryerësi të arrestohet apo të ketë probleme me policinë	7	10	1
Nuk ka dashur t'i jep fund lidhjes	6	3	-
Tepër e trazuar në kuptimin emocional për ta kontaktuar policinë	5	1	9
Kam menduar se është faji im	5	12	0.4
Nuk do të më besonin	5	1	3
Nuk kam menduar se ata do të mund të bënin diçka	4	4	2
Nuk kam mundur ta raportojë në polici për shkak të konfliktit	3	0	4
Nuk më ka lejuar partneri	2	1	-
Kam shkuar diku tjetër për të kërkuar ndihmë	1	0	0
Frika nga ndëshkimi nga dikush tjetër përveç partnerit	1	0	4
Dikush tjetër më ka ndaluar apo më ka shkurajuar	0	3	0
Dikush tjetër e ka raportuar atë apo vetë policia e ka zbuluar	0	0	5

BAZA:
Gratë, moshë 18–74 vjeç në Serbi, të cilat kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale, por të cilat nuk e kanë kontaktuar policinë pas incidentit më të rëndë: partneri aktual (98), partneri i mëparshëm (156), jopartneri (144)

BURIMI:
Studim i udhëhequr nga OSBE-ja për dhunën ndaj grave (2018)

Gratë që raportojnë se nuk kanë kontaktuar me asnjë organizatë mbështetëse kanë cituar po të njëjtat arsye kryesore si pengesa për raportimin e rastit.

Përballja me vetë incidentin është arsyeja më e shpeshtë për mos kontaktimin e policisë apo shërbimet e tjera (si edhe në BE). Barrierat e mëposhtme, të identifikuar në studimin cilësor, mund të ndikojnë tek gratë që ato t'i trajtojnë vetë incidentet e dhunës.

Kutia 6.1: Pengesat për raportim që janë identifikuar në hulumtimin cilësor janë:

1. **Turpi:** ose për shkak të natyrës së përjetimeve të tyre, ose për shkak se ato besonin se njerëzit do t'i fajësonin ato për dhunën.
2. **Nuk duan të ndahen nga fëmijët e tyre:** duke qenë se supozonin se fëmijët e tyre do të qëndronin me babanë e tyre.
3. **Mungesa e pavarësisë financiare:** që do i parandalonte ato që t'i jepnin fund lidhjes.
4. **Frika e hakmarrjes nga partneri:** pasi ato mendonin se policia apo ligji nuk do të mund t'i mbronte.
5. **Mungesa e besimit në institucione:** besimi se dhuna nga partneri intim falet.

Turpi u cilësua si një pengesë e madhe që ua pamundëson grave ta raportojnë dhunën e përjetuar, veçanërisht dhunën e ushtruar nga partnerit intim. Një nga arsyet për këtë ishte ekzistenca e një perceptimi se dhuna e ushtruar nga partneri intim nuk do të ndodhte pa pasur arsye, prandaj nënkuptohej se gruaja duhet të kishte bërë patjetër diçka për ta merituar atë.

“Ata thoshin, ‘kush e di se çka ka bërë sepse burri asnjëherë nuk e rrahë gruan pa arsye’. Pra, ajo me gjasë ka bërë diçka dhe prandaj ai po e rrahë atë.”

Grua, mosha 18-30 vjeçe, rome, vendbanim urban

Gratë që kishin përjetuar dhunë si pasojë e konfliktit kishin gjithashtu turp dhe frikë që ta raportonin dhunën. Në grupet e diskutimit që u mban gjatë studimit cilësor, gratë pranuan se shoqëria i shihte gratë që kishin përjetuar dhunë seksuale gjatë konfliktit në mënyrë tjetër dhe u shprehën se meshkujt konsideronin se ato nuk ishin të denja për respekt si pasojë e dhunës seksuale që përjetuan.

“Kam dëgjuar shumë burra që thonë se këto gra jepen lehtë dhe se meritojnë t’u bëhet edhe më keq sesa dhuna seksuale që armiku ka ushtruar ndaj atyre”.

Grua, mosha 34-55 vjeç, shqiptare e Kosovës, vendbanim urban

Gratë gjithashtu shprehën besimin se dhuna e shkaktuar nga partneri intim nuk duhet të raportohet sepse gratë nuk duan të lënë fëmijët e tyre. Nëse një grua dëshiron ta lë burrin e saj dhe të kthehet te familja e saj, sipas tyre familja do ta pranojë vetëm gruan, ndërsa fëmijët konsiderohen se i përkasin burrit.

“Nëse ajo do të fliste me prindërit e saj mbi dhunën, ata do ta hiqnin atë [gruan] prej aty. “Ata do ta ndanin nga burri [bashkëshorti], por gruaja nuk dëshiron që kjo të ndodhë sepse ajo i ka fëmijët, zgjidhje tjetër nuk ka, ajo do të ndjehej e trishtuar po t’i linte fëmijët. Nëse ajo shkurorëzohet nga ai, ajo nuk ka mundësi të tjera, prandaj ajo pranon këtë lloj jetese”.

Grua, mosha 18-30 vjeç, rome, vendbanim urban

Gratë shpjeguan se ka një perceptim se dhuna e ushtruar nga partneri intim nuk do të ndodhte pa ndonjë arsye, [duke lënë për të nënkuptuar] se gruaja do të ketë bërë diçka patjetër për ta merituar këtë gjë

Pjesëmarrëset ishin të mendimit se shumica e grave nuk kishin pavarësi financiare për të qenë në gjendje të braktisin një partner të dhunshëm, pasi nuk kishin të drejta trashëgimie apo të drejta pronësore. Nëse një grua nuk ka një vend pune, alternativa e saj e vetme për mbështetje financiare do të ishte familja e saj e gjakut. Gratë nuk mendonin se të gjitha familjet e gjakut do të pranonin që vajza e tyre të jetonte me ta përsëri; disa nuk do ta shihnin atë më përgjegjësi të tyre, madje të tjerë familjarë do ta inkurajonin vajzën e tyre për ta duruar situatën. Disa mund të ndihmojnë, por mund të vendosin kushte, si për shembull të mos mbajë me asnjë kontakt me burrin ose me fëmijët.

“Edhe nëse një grua dëshiron të mos vuajë më, nga mund t’ia mbajë ajo? Ajo nuk ka vend pune, duhet të shkojë tek prindërit e saj. Prindërit e saj do t’i thonë: Pse nuk durove dhe pse nuk qëndrove atje? Nuk kemi asgjë për të të dhënë këtu, nuk kemi pasuri —ua kemi dhënë atë djemve.’ Gratë nuk posedojnë pasuri ... ato duhet të durojnë gjithçka. Nëse gratë do të kishin burime financiare dhe kulm mbi kokë, ato nuk do të duronin.’

Grua, mosha 30-50 vjeç, shqiptare e Kosovës, vendbanim rural

Gratë të cilat morën pjesë në studimin cilësor shprehën shqetësimin për faktin se nëse do ta raportonin dhunën e ushtruar nga partneri intim, do të kishte pasoja serioze nga partneri i tyre. Përshtypja ishte se policia nuk do të reagoje shpejt dhe se mund të mos e arrestonin partnerin e tyre. Edhe nëse do ta arrestonin, do ta mbanin vetëm për disa ditë dhe me t’u liruar ai do të kthehej në shtëpi dhe do të mund të ushtronte dhunë përsëri mbi të.

Gratë gjithashtu shprehën mungesë besimi në institucionet, veçanërisht në policinë, e që mendohej të jetë faktor dekurajues për raportimin e dhunës nga gratë. Ato thanë se në mesin e zyrtarëve që punonin në polici kishte të tillë që e konsideronin të pranueshme dhunën e ushtruar nga partneri intim dhe se nuk do të përpiqeshin ta parandalonin atë në mënyrë efektive. Ekzistonte gjithashtu perceptimi se zyrtarët policorë nuk do të ruanin konfidencialitetin, veçanërisht në zonat rurale, ku kishte shumë gjasa që të njiheshin me njerëzit e përfshirë.

“Unë besoj se mungon besimi, sepse një zyrtar policie mund të jetë anëtar i familjes sime dhe unë kam një problem familjar, dhe nëse shkoj në polici, ai [zyrtari i policisë] do të përhapë lajmin se 'Oh gruaja e këtij personi ...'”

Grua, moshë 18-30, shqiptare e Kosovës, vendbanim rural

Raportimi i ngacmimit seksual

Gati dy të tretat e grave që kishin pasur përvoja të ngacmimeve seksuale thanë se nuk kishin biseduar me askënd rreth këtyre përvojave (65%). Në shumicën e rasteve, ato thanë se kishin qenë në gjendje të merreshin vetë me problemin (55%) apo që ishte një gjë shumë e vogël dhe se kurrë nuk u kishte shkuar ndërmend ta raportonin rastin (35%). Për një pjesë të vogël të tyre, duheshin llogaritur edhe faktorë të tjerë: disa donin ta mbanin ngjarjen sa më private (9%), disa përmendën siklet ose turp (4%), por kishte të tilla që mendonin se raportimi nuk do t’ju ndihmonte (4%).

Për ato që vërtetë folën për incidentin e ngacmimit seksual që u kishte ndodhur (gjithsej 33%), personat të cilëve zakonisht u ishin drejtuar për këtë ishin një i afërm/anëtar i familjes (23%), mikeshë (8%) ose i dashuri/partneri (6%). Ato nuk kishin e konsideruar raportimin e përvojave të tyre në polici, organizata me shërbime të specializuara apo shërbimet e tjera.

6.4: Kënaqshmëria me shërbimet

Shumë pak të mbijetuara të dhunës a ngacmimit kanë kontaktuar shërbimet zyrtare për mbështetje, gjë që e bën të pamundshme nxjerrjen e konstatimeve domethënëse statistikore për shkallën e kënaqshmërisë me këto shërbime.

Gratë që kishin përjetuar dhunë, e të cilat morën pjesë në studimin cilësor, raportuan përvoja të ndryshme në lidhje me shërbimet e ndryshme. Ato që kishin mundur të siguronin një mbështetje e kishin arritur këtë përmes një OJQ dhe ishin mjaft pozitive për mbështetjen psikologjike dhe praktike që kishin pranuar e që i kishte ndihmuar ato të përballonin përvojat e tyre dhe të nisnin një jetë të re.

Megjithatë, pikëpamjet mbi shërbimet e ofruara nga autoritetet lokale ishin më pak pozitive. Gratë shprehën mendimin se autoritetet ishin të ngadalshme për të vepruar ndaj të gjitha formave të dhunës kundër grave, sidomos për dhunën e lidhur me konfliktin.

Rasti studimor më poshtë e tregon ngjarjen e një të mbijetuare tjetër të dhunës që ka të bëjë me konfliktin, e cila ka përjetuar dhunë në një qendër ndalimi dhe paraqet përvojën e saj lidhur me qasjen në shërbimet përkrahëse.

Rasti studimor : Tregimi i B

- B. u martua në moshën 20 vjeçare dhe pati disa fëmijë. Burri i saj vdiq në fillim të konfliktit të Kosovës. Shkaku i vdekjes është i panjohur. Asaj i kishin thënë se ai u vra nga rrufeja; megjithatë, ajo gjithashtu ishte në dijeni të faktit se bashkëshorti kishte probleme me disa burra në punë dhe se mund të ishte vrarë nga ata.
- Gjatë konfliktit, B. dhe fëmijët e saj u kapën nga forcat e armatosura. Ajo u dërgua me gratë e tjera dhe fëmijët në një qendër të përkohshme ndalimi që ishte krijuar në një hangar.
- B u rrah dhe u përdhunua në mënyrë të përsëritur. Këto i shkaktuan asaj pasoja në shëndetin mendor dhe fizik, përfshirë këtu dëmtimin e veshkave dhe shpinës. B u lirua nga qendra e ndalimit dhe duhej të punonte shumë për t'i mbështetur dhe rritur fëmijët e vetme. Fëmijët e saj u traumatizuan nga ngjarjet dhe kjo ndikoi në mirëqenien e tyre psikologjike shumë vite më pas.
- Shëndeti fizik dhe mendor i B-së gjithashtu u ndikua rëndë. Ajo pranon trajtim mjekësor për veshkat e saj dhe këshillohet në një organizatë bamirëse.
- B aplikoi për kompensim që u jepet grave në Kosovë që kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë konfliktit të Kosovës. Asaj iu tha se kërkesa i është refuzua sepse kishte dyshime rreth rastit të saj.

“Kur mi kërkuan dokumentet, unë u thashë se nuk i kam. E kujt do i binte në mend për dokumente?”

E mbijetuar e dhunës së lidhur me konfliktin

7. Përvojat e dhunës në mesin e grupeve specifike të grave >>

Anketë për mirëqenien dhe sigurinë e grave në Kosovë



Foto: Yllka Fetahaj

7. Përjetimet e dhunës në mesin e grupeve specifike të grave

Anketa mblodhi një sërë detajesh për historikun e të anketuarve në mënyrë që të bëhej një analizë më e thellë mbi përmasat e dhunës së përjetuar nga grupe të ndryshme të grave. Qëllimi i kësaj është që të rritet kuptimi ynë mbi prevalencën dhe rrezikun e përjetimit të dhunës për grupe të caktuara. Ky kapitull përqendrohet në dallimet domethënëse në përvojat e raportuara të të gjitha formave të dhunës, përfshirë këtu ngacmimet seksuale, tek grupet e ndryshme të grave.

Mosha

Në përgjithësi, mosha është faktori më domethënës për dallimet në përvojat dhe qëndrimet e grave. Gratë më të reja (ato të moshës 18-29 vjeç) kanë më shumë gjasa se mesatarisht të thonë se kanë përjetuar ngacmime seksuale që nga mosha 15 vjeçare (42% kundrejt mesatares 29%) dhe në 12 muajt e fundit (24% kundrejt 13%) para anketës. Kjo vlen edhe për përjetimet e përndjekjes (15% kundrejt 8% mesatarisht që nga mosha 15 vjeç dhe 4% kundrejt 2% në 12 muajt e fundit).

Ndërsa, gratë mbi 60 vjeç kanë më shumë të ngjarë të thonë se kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partneri intim gjatë jetës (21% kundrejt 11% mesatarisht), ku prevalenca në 12 muajt e fundit nuk ndryshon pavarësisht nga grupmosha.

Statusi i lidhjes

Janë analizuar të dhënat nëse i anketuari ka një partner aktual (aktualisht i martuar, duke jetuar së bashku pa qenë i martuar ose i përfshirë në një marrëdhënie pa bashkëjetesë), ka pasur një partner të mëhershëm (përkufizim i njëjtë si partneri aktual) ose nuk ka pasur kurrë partner.

Gratë të cilat kanë pasur partner të mëhershëm kanë njëtrajtshmërisht më shumë të ngjarë të thonë se kanë përjetuar dhunë: 15% raportojnë të kenë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga një jopartner, për dallim me 7% syresh pa partner të mëhershëm. Ngjashëm, 18% e grave të cilat kanë pasur partner të mëhershëm raportojnë të kenë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partneri i tyre aktual, krahasuar me 9% gjithsej.

Statusi i punësimit

Pavarësisht se statusi i punësimit i një gruaje nuk është faktor i madh diskriminues, të dhënat sugjerojnë se nxënëset ose studentet janë më të cënueshëm ndaj formave të caktuara të dhunës. Ndonëse në masë më të vogël, e njëjta gjë vlen edhe për pensionistet.

Nxënëset dhe studentet kanë më shumë të ngjarë t'i raportojnë ngacmimet seksuale (60% në krahasim me 29% të grave gjithsej) dhe në 12 muajt e fundit (40% krahasuar me 13% gjithsej). Edhe pse studentet dhe nxënëset janë pothuajse të gjitha 18-29 vjeç, grupmoshë që ka më së shumti të ngjarë të raportojë ngacmimet seksuale, ato kanë megjithatë më shumë të ngjarë të kenë përjetuar më shumë ngacmime seksuale sesa gratë e moshës 18-29 vjeç në përgjithësi (42%).

Gratë në pension kanë më shumë të ngjarë të raportojnë përvojat e dhunës që i kanë pasur në jetën e tyre nga partneri aktual (16% kundrejt 8%).

Përveç kësaj, gratë në pension (30%) dhe ato që rrinë në shtëpi dhe përmbushin detyrat dhe përgjegjësitë e kujdesit për familjen (33%) raportuan më shumë dhunë fizike në fëmijëri sesa gratë e tjera në përgjithësi (21%).

Shkollimi

Në këtë anketë, gratë u pyetën për nivelin më të lartë arsimor që kishin arsim fillor, të mesëm apo të lartë. Gratë me arsim fillor 4-vjeçar (shumica e të cilave janë të moshës 50 vjeç e më shumë) kanë më shumë të ngjarë të thonë se kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga jopartneri (17% krahasuar me 8% të grave gjithsej) dhe dhunë fizike të shkaktuar nga partneri intim (16 % kundrejt 9% mesatarisht).

Gratë me shkollim të lartë janë më me gjasë që të thonë se kanë përjetuar ngacmim seksuale që nga mosha 15 vjeçare (44% krahasuar me gjithsej 29%) dhe në 12 muajt e fundit (25% kundrejt 13%) para anketës. Gjithashtu, ato kanë më shumë të ngjarë të kenë përjetuar përndjekje që nga mosha 15 vjeçare (13% në krahasim me 8% të grave gjithsej). Nga ana tjetër, ata kanë më pak të ngjarë se mesatarja që të raportojnë se kanë përjetuar dhunë fizike nga një partner ose jopartner (7% kundrejt 12% mesatarisht) ose dhunë fizike gjatë fëmijërisë së tyre (13% kundrejt 21%).

Të ardhurat

Gratë të cilat morën pjesë në këtë anketë u analizuan sipas katër grupeve të të ardhurave: ato që bëjnë jetë të mirë me të ardhurat e tyre të tanishme, ato që ia dalin disi, ato që kanë vështirësi dhe ato që kanë shumë vështirësi.

Ndërkohë që kur bëhet fjalë për prevalencë të dhunës së shkaktuar nga jopartneri kategoria e të ardhurave nuk është se çon shumë peshë, te dhuna e shkaktuar nga partneri intim janë disa dallime të dukshme. Gratë të cilat janë pjesë e familjeve që e kanë shumë të vështirë të përballojnë jetesën me të ardhurat e tyre të tanishme raportojnë shkallë më të larta të dhunës të ushtruar nga partner aktual (në nivel total përfshirë dhunën psikologjike, fizike dhe seksuale), ku 75% raportojnë të kenë përjetuar të paktën njëherë nga këto forma të dhunës krahasuar me mesataren prej 53%. Dallimet janë më të theksuara kur bëhet fjalë për dhunën fizike dhe psikologjike. Ato që e kanë shumë të vështirë të përballojnë jetesën me të ardhurat e tyre raportojnë nivele më të larta të dhunës fizike në fëmijërinë e tyre (32% kundrejt 21%).

Prevalenca e raportuar e të gjitha formave të dhunës nga partneri aktual është më e lartë në mesin e grave të cilat e kanë shumë të vështirë të përballojnë jetesën me të ardhurat e tyre

Etnia

Kur krahasojmë gjetjet mes popullsisë serbe të Kosovës dhe asaj shqiptare të Kosovës, prania e raportuar e dhunës është pothuajse gjithnjë më e lartë në mesin e popullsisë serbe të Kosovës, siç është paraqitur në Tabelën 7.1 më poshtë. Përjashtim të vetëm përbëjnë rastet e dhunës së nga partneri i mëparshëm.

Tabela 7.1: Prania e dhunës, sipas përkatësisë etnike

	Shqiptare të Kosovës/tjetër %	Serbe të Kosovës%
Ngacmim seksual	27	55
Dhunë fizike nga jopartneri	6	21
Përndjekje	1	5
Dhunë psikologjike nga partneri aktual	51	62
Dhunë fizike nga partneri aktual	7	16
Dhunë seksuale nga partneri i mëparshëm	3	13
Dhunë psikologjike nga partneri i mëparshëm	44	54
Dhunë fizike nga partneri i mëparshëm	14	16
Dhunë seksuale nga partneri i mëparshëm	7	5
Dhunë gjatë fëmijërisë	21	37

BAZA: Gjitha gratë në Kosovë të moshës 18-74 vjeçare (Shqiptare: 1,690; Serbe: 300) me partnerin aktual (Shqiptare: 1,340; Serbe: 233) apo partnerin e mëhershëm (Shqiptare: 168; Serbe: 245)

BURIMI: Studimi i udhëhequr nga OSBE-ja mbi dhunën ndaj grave (2018)

Dallime ka edhe sa i përket pranisë vjetore të raportuar për disa forma të dhunës. Serbet e Kosovës kanë më shumë të ngjarë të thonë se kanë përjetuar ngacmim seksual në 12 muajt e fundit para anketës (32% kundrejt 12% të shqiptareve të Kosovës), përndjekje (4% kundrejt 1%), dhunë fizike nga jopartneri (7% kundrejt 1%) dhe dhunë fizike apo seksuale nga partneri aktual (8% kundrejt 3%).

Këto dallime në praninë e raportuar ndërmjet shqiptareve të Kosovës dhe serbeve të Kosovës mund të jenë pjesërisht të lidhura me qëndrimet e ndryshme ndaj dhunës në familje. Më shumë shqiptare të Kosovës se serbe të Kosovës pajtohen me idenë se dhuna ndaj grave shpesh provokohet nga viktimi (36% kundrejt 23%) dhe se dhuna në familje është çështje private që duhet trajtuar brenda familjes (50% kundrejt 39%). Është vërejtur se serbet e Kosovës kanë qenë më të gatshme të flisnin mbi përvojat e tyre gjatë intervistës në kuadër të anketës.

Gratë me fëmijë dhe ato pa fëmijë

Gratë me (ose ato të cilat kanë pasur) fëmijë kanë përvoja goxha të ndryshme të ngacmimit seksual në krahasim me ato që nuk kanë fëmijë. Në mesin e atyre që nuk kanë fëmijë, 47% kanë përjetuar ngacmim seksual që nga moshën 15 vjeçare (22% të grave që kanë fëmijë), ndërsa 28% syresh kanë përjetuar ngacmime në 12 muajt e fundit para anketës (8% me fëmijë), me trende të ngjashme dhe për format më të rënda të ngacmimit seksual. Përndjekja është gjithashtu më e përhapur në mesin e atyre që nuk kanë fëmijë (17% që nga moshën 15 vjeç, në krahasim me 4% të grave me fëmijë). Gratë pa fëmijë kanë gjithashtu më shumë të ngjarë të raportojnë se kanë përjetuar dhunë fizike nga një jopartner që nga moshën 15 vjeçare (10% kundrejt 6%).

Vendndodhja

Gratë që jetojnë në zonat urbane kanë më shumë të ngjarë të tregojnë mbi përvoja të ngacmimeve seksuale sesa ato që jetojnë në zonat rurale, në të dyja rastet që nga moshë 15 vjeçare (33% kundrejt 25%) dhe në 12 muajt e fundit (16% kundrejt 12%). I njëjti trend vërehet edhe në lidhje me format më të rënda të ngacmimit seksual. Përhapja e dhunës fizike dhe seksuale të shkaktuar nga jopartneri është gjithashtu paksa më e lartë në zonat urbane (9% kundrejt 7%). Derisa përqindja e grave të cilat thonë të kenë përjetuar dhunë nga partneri aktual nuk ndryshon në varësi nga lokaliteti, dhuna psikologjike e ushtruar nga partneri i mëparshëm përjetohet më shpesh në zonat urbane (54% kundrejt 40%) ashtu si edhe prevalenca e dhunës fizike ose seksuale të shkaktuar nga partneri i mëparshëm në 12 muajt e fundit (5% kundrejt më pak se 1%).

Për dallim nga më sipër, dhuna fizike në fëmijëri është e përmendur më shpesh nga gratë që aktualisht jetojnë në zona rurale (24%) sesa ata që jetojnë në zonat urbane (17%).

Karakteristikat e partnerit aktual

Janë mbledhur informacione mbi moshën, arsimin, punësimin dhe disa përvoja e sjellje të partnerit të së anketuarës.

Duke pasur parasysh se gratë e moshës 60 vjeç e më lart kanë më shumë të ngjarë të kenë përjetuar dhunë të ushtruar nga partneri aktual, si rrjedhim gratë partnerët e të cilëve janë të moshës mbi 60 vjeçe thonë më shpesh të kenë përjetuar dhunë fizike ose seksuale nga partneri i tyre aktual (15% kundrejt 9% gjithsej).

Dhuna seksuale e shkaktuar nga partneri aktual është më e lartë tek ato gra partnerët e të cilave nuk janë në punë formalisht, ku 7% të grave partnerët e të cilave janë të papunë ose në pension kanë raportuar të kenë përjetuar këtë formë të dhunës krahasuar me 4% gjithsej.



8. Përfundime dhe rekomandime >>

Anketë për mirëqenien dhe sigurinë e grave në Kosovë



Foto: Yllka Fetahaj

8. Përfundime dhe rekomandime

Anketa dhe hulumtimi cilësor shpalosin katër gjetje kryesore në lidhje me dhunën ndaj grave në Kosovë:

1) Normat dhe qëndrimet shoqërore kontribuojnë në pabarazinë gjinore dhe stigmën e lidhur me raportim të dhunës dhe kërkim të ndihmës.

Gratë të cilat morën pjesë në anketë dhe në hulumtimin cilësor kanë shprehur shqetësimin e tyre sa i përket dhunës ndaj grave në Kosovë. Gati dy të tretat e grave të anketuara (64%) thonë se dhuna ndaj grave ndodhë shpesh. Kështu, më se gjysma e grave (54%) deklarohen të kenë përjetuar dhunë nga partneri intim, dhe atë kryesisht dhunë psikologjike, porse 9% e grave kanë raportuar se kanë përjetuar po ashtu edhe dhunë fizike.

Normat dhe qëndrimet shoqërore sa i përket rolit që duhet ta kenë gratë në shoqëri dhe pranimi i gjerësishëm i pabarazisë gjinore vendosin kontekstin për këtë dhunë. Ato ngulitin edhe më shumë pabarazinë në shoqëri ku burrat dominojnë në shtëpi, në punë dhe në sferën publike. Më se gjysma (57%) e grave të moshës 18-74 vjeçare në Kosovë besojnë se rrethi i tyre shoqëror mendon se: "Një grua e mirë i bindet burrit të saj edhe nëse ajo ka tjetër mendim." Një e katërta (26%) e grave besojnë se rrethi i tyre shoqëror mendon se: "Gruaja e ka për obligim të kryejë marrëdhënie seksuale me burrin e saj edhe nëse ajo nuk ka dëshirë". Më se një e treta e grave (35%) pajtohen me mendimin se dhunën e provokon viktimja dhe gratë ekzagjerojnë pretendimet mbi përdhunim apo abuzim (32%).

Përkundër përqindjes së lartë të grave të cilat kanë shpalosur të kenë qenë pre e dhunës së ushtruar nga partneri aktual apo ai i mëparshëm, shumica e grave nuk kanë kontaktuar asnjë shërbim qoftë edhe në rastet më serioze të dhunës të ushtruar nga partneri aktual (92%), partner i mëparshëm (81%) ose jopartner (72%). Në veçanti, vetëm 2% e grave raportuan për incidentin më serioz të dhunës së ushtruar nga partneri aktual në polici dhe 3% tek shërbimet sociale dhe gati asnjë nuk raportoi se kishte kontaktuar me ndonjë nga strehimoret për gratë apo me ndonjë shërbim tjetër të specializuar. E njëjta gjë vërtetohet dhe nga fakti se pothuajse gjysma e grave të anketuara (48%) besojnë se dhuna në familje është "çështje private" që duhet mbajtur si e tillë brenda familjes.

Gratë të cilat morën pjesë në hulumtimin cilësor janë shprehur se ka shumë pengesa për kërkim të mbështetjes. Këtu përfshihen pranimi i dhunës si diçka normale dhe mungesa e mbështetjes afatgjatë qoftë me strehim apo financiarisht, gjë që e bën lënien e partnerit abuziv aspak praktike dhe, si rrjedhojë, raportimi e rastit si gjë jopraktike dhe potencialisht të rrezikshme.

2) Legjislacioni nuk po gjen zbatim të mjaftueshëm dhe besimi tek institucionet që do të duhej t'u ofronin mbështetje viktimave të dhunës është i ulët

Ekspertët të cilët u intervistuan për qëllime të këtij raporti ishin në përgjithësi të mendimit se Kosova ka ligje të mira dhe se ka pasur përmirësim gjatë dhjetë viteve të fundit. Derisa ligjet që kanë të bëjnë me dhunën me bazë gjinore janë konsideruar si pjesërisht adekuate, zbatimi i tyre është cilësuar të jetë i mangët. Disa ekspertë raportuan se zyrtarët fajësojnë gratë për krimet e kryera kundër tyre, veçanërisht në lidhje me dhunën seksuale. Në disa raste, policia i bindë të mbijetuarat se dhuna nuk ka qenë kushedi sa e madhe dhe se ato nuk duhet ta raportojnë atë.

Vërtetë, gratë të cilat morën pjesë në studimin cilësor shprehën mungesë besimi në sistemet dhe akterët përgjegjës për mbrojtjen e tyre, duke sqaruar se në rast ushtrimi të dhunës nga partneri intim, brenga e tyre ishte se policia do ta mbante kryerësin në paraburgim vetëm për periudhë të shkurtër kohe dhe se kryerësi do lirohej e do t'i lëndonte sërish.

Gratë të cilat morën pjesë në studimin cilësor u shprehën se mosbesimi ndaj policisë ishte më i rëndomtë në zona rurale, ku policët kanë më shumë të ngjarë t'i njohin palët e përfshira dhe, për rrjedhojë, mund të ndodhë që të mos reagojnë objektivisht. Strehimoret e grave e kanë vënë në dijeni Misionin e OSBE-së në Kosovë se punonjësve të qendrave për punë sociale u mungon njohuria dhe ndjeshmëria e nevojshme për trajtimin e rasteve të dhunës në familje.

Ekspertët të cilët u intervistuan për këtë raport kanë deklaruar se ligjet për pagesat e ushqimisë për fëmijët në rast divorci duhet të zbatohen më mirë. Veç kësaj, ata vunë në pah tendencën për t'ia besuar kujdestarinë babait, gjersa nënës i duhet shpesh të dalë nga shtëpia. Gratë të cilat morën pjesë në studimin cilësor thanë se në rast ndarjeje apo divorci familja e gruas do të pranojë që ajo të kthehet në shtëpi, por pa fëmijë, ngaqë është e zakonshme që fëmijët të trajtohen si gjaku i babait. Nëse gruaja është e papunë dhe familja e saj nuk e pranon, ajo mund t'i humbasë fëmijët e vet. Duke pasur parasysh se dy në çdo pesë gra (41%) në Kosovë nuk kanë punuar kurrë, kjo është një pengesë shumë serioze për t'i dhënë fund situatës abuzive.

Ekspertët kanë qenë të mendimit se konsensusi shoqëror është që autorët e dhunës kundër grave të dënohen, por nuk kishte asnjë fokus në analizimin e faktit se pse kryerësit vepronin në atë mënyrë dhe të përpiqeshin ta ndryshonin këtë gjë. Ekspertët deklaruan se duhet të ketë rehabilitim të detyrueshëm për kryerësit, për të siguruar që ata ta kuptojnë ndikimin që ka abuzimi dhe se si të mos përsërisin më këtë sjellje.

U pohua se të pasurit e **një sistemi të unifikuar për mbledhjen e të dhënave** është vendimtar për krijimin e politikave për rastet e dhunës kundër grave. Mbledhja e të dhënave të unifikuara u mundëson institucioneve, OJQ-ve dhe ofruesve të shërbimeve të kenë një tablo më të qartë të kësaj dukurie nga momenti kur dhuna raportohet deri në zgjidhjen përfundimtare të rastit. Në vitin 2018, Zyra e Koordinatorit Nacional kundër Dhunës në Familje ka krijuar bazën e të dhënave për rastet e dhunës në familje dhe në muajin mars 2019 është nënshkruar një memorandum mirëkuptimi ndërmjet institucioneve relevante.

3) Ofrimi i strehimoreve dhe i shërbimeve tjera mbështetëse për gratë përcillet me mangësi, si edhe duhen ngritur kapacitetet e tyre, përfshirë këtu për grupet e grave në disavantazh

Rreth një e treta (35%) e grave të anketuara e kanë cilësuar veten si shumë mirë apo mirë të informuar për atë se çfarë duhet të bëjnë nëse përjetojnë dhunë, gjersa 29% syresh janë deklaruar të jenë të informuara deri-diku dhe 34% se nuk janë të informuara mirë. Megjithatë, shumica syresh nuk ishin në dijeni të shërbimeve të specializuara dhe as nuk e konsideronin qasjen pranë këtyre shërbimeve pas përjetimit të ndonjë incidenti dhune. Strehimoret e grave dhe, në veçanti, aftësia e tyre për të siguruar kujdes të qëndrueshëm afatmesëm janë fushë kyçe për përmirësim. Gratë kanë pak dijeni sa u përket shërbimeve mbështetëse që ofrohen nga strehimoret. Ato që ishin në dijeni të ekzistencës së strehimoreve për gratë ishin të shqetësuar për rrezikun që mund t'i kanoset një gruaje me rastin e kthimit në shtëpi tek burri i saj. Po kështu, ekspertët të cilët u intervistuan shprehën shqetësime sa i përket rrezikut që u kanoset grave të cilat kthehen sërish në shtëpi tek kryerësi pas qëndrimit në strehimore.

Përveç kësaj, ekspertët pajtohen që mungesa e fondeve të qëndrueshme për strehimoret është pengesë për ofrimin e shërbimeve adekuate për viktimat. Strehimoreve u mungon një burim i vetëm i besueshëm i financimit. Ato përballen me vështirësi, meqë qëndrueshmëria e tyre shpeshherë varet nga mbështetja e atypëratyshme financiare nga komunat, donatorët ndërkombëtarë ose projektet e gjenerimit të të ardhurave. Përkundër faktit që Departamenti për Politika Sociale dhe Familje në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale mban përgjegjësinë kryesore për të siguruar cilësinë e shërbimeve të strehimit, ai financon vetëm rreth gjysmën e buxhetit të kërkuar (rreth 30,000 euro për strehimore në vit); fondet e mbetura merren pjesërisht nga komunat dhe /ose donatorët ndërkombëtarë. Situata aktuale ka rezultuar në mbylljen e disa strehimoreve dhe dëbimin e viktimave ose mospranimin e viktimave të reja për disa muaj.

Derisa ekspertët kanë thënë se shërbimet e ofruara për gratë kishin nevojë të përmirësohen në gjitha aspektet, ata i konsideronin disa grupe grash si më të cenueshme në krahasim me tjerat. Ekspertët deklaruan se gratë nga radhët e komuniteteve të ndryshme joshumicë, siç janë serbet e Kosovës, goranet e Kosovës, turket e Kosovës, rome të Kosovës, ashkali të Kosovës dhe egjiptiane të Kosovës kanë më pak qasje në shërbime dhe kanë më shumë të ngjarë të diskriminohen nga ofruesit e shërbimeve sesa gratë tjera.

Veç kësaj, sipas tyre, **gratë nga zonat rurale** kanë qasje edhe më të mangët në shërbimet përkatëse (siç janë shërbimet shëndetësore dhe strehimoret e grave). **Gratë më në moshë** kanë më shumë të ngjarë të jenë të varura nga partnerët si financiarisht ashtu dhe emocionalisht, madje janë edhe në rrezik diskriminimi nga shërbimet përkatëse, gjë që e bën largimin e tyre nga kjo marrëdhënie jashtëzakonisht të vështirë.

Varësia ekonomike e grave ndaj partnerëve të tyre ishte një nga arsyt kryesore të identifikuar nga gratë të cilat morën pjesë në studimin cilësor (gjë që vërtetohet dhe nga fakti se 69% e grave të anketuara nuk kanë llogari bankare personale) si pengesë që ta lënë partnerin e dhunshëm. Prandaj, projektet e OJQ-ve për t'u ndihmuar grave të gjejnë punë apo të fillojnë biznes të tyre janë thelbësore për të ndihmuar atyre që të jetojnë në mënyrë të pavarur.

4) Të gjitha gratë të cilat i kanë mbijetuar dhunës së lidhur me konfliktin kanë nevojë për më shumë mbështetje

Konflikti i Kosovës dhe ndërhyrja e NATO-s në vitin 1999, ka pasur ndikim tek përjetimi i dhunës nga gratë. Gati tre të katërtat e grave cilësohen si të prekura drejtpërsëdrejti nga konflikti (73%), nga të cilat thuajse një e treta (32%) thonë se incidenti më i rëndë i dhunës së ushtruar nga një jopartner të cilin e kanë përjetuar lidhej me konfliktin.

Autoritetet në Kosovë janë zotuar që t'i mbështetin gratë të cilat kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë konfliktit të Kosovës duke u siguruar pension. Megjithatë, kompensimi u jepet vetëm grave të cilat kanë përjetuar dhunë seksuale përpara qershorit të vitit 1999, duke përjashtuar ato që ishin subjekt i dhunës si pasojë e konfliktit. Ekspertët ishin të mendimit se ky kufizim nënkupton që dispozita si e tillë ishte diskriminuese.

"Që nga shkurti i vitit 2018, viktimat mund të aplikojnë te Komisioni Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Gjendjes së Të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale gjatë Konfliktit për njohje dhe verifikim për të pranuar benefite individuale.⁶¹ Ekspertët e intervistuar vunë në dukje se rreth një e pesta e kërkesave janë pranuar. Disa gra të cilat kanë përjetuar dhunë seksuale si pasojë e konfliktit e kanë cilësuar procesin e rikujtimit të dhunës si gjë traumatizuese. Mund të jetë e nevojshme që të punohet më tepër për ta përmirësuar procesin dhe sistemin e verifikimit. OJQ-të që u japin mbështetje të drejtpërdrejtë grave janë shprehur se janë në gjendje që t'i mbështetin gratë me të cilat po punonin edhe për paraqitjen e kërkesave për kompensim, gjë që mund t'ua lehtësojë kalimin nëpër këtë proces.

Në fund, ekspertët vunë në dukje diskriminimin me të cilin përballen gratë që kanë përjetuar dhunë gjatë konfliktit. Këto gra kishin të ngjarë të përballëshin me paragjykimet nga komunitetet e veta në rast të bërjes publike të përjetimeve të tyre, duke e bërë shumë më të vështirë për to që të tregojnë përvojat e tyre ose të kërkojnë mbështetje.

Rekomandimet

Anketa dhe hulumtimi sasior sigurojnë bazën për rekomandime të mëtejme specifike:

Përmirësimi dhe monitorimi i legjislacionit dhe i zbatimit të tij

Për Qeverinë

1. Të plotësohet dhe ndryshohet Ligji për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës, viktimave civile dhe familjeve të tyre, për t'u lejuar të gjitha grave të cilat i kanë mbijetuar dhunës seksuale të lidhur me konfliktin të marrin kompensim, përfshirë gratë të cilat ishin viktimat të sulmeve pas qershorit 1999.
2. Të përmirësohet procesi i aplikimit për kompensim dhe sistemi i verifikimit, për të shmangur viktimizimin e mëtejshëm dhe për të siguruar që gjitha grave që i kanë mbijetuar dhunës së lidhur me konfliktin t'u jepet kompensim. Në dritën e përbindjes së vogël të grave që posedojnë llogari bankare personale, të merret parasysh bërja e pagesave vjetore të kompensimit në para të gatshme.
3. Të sigurohet se do zbatohet parimi i "kujdesit të duhur", domethënë të ketë mekanizëm ku viktimat të mund t'i raportojnë sjelljet e pahijshme, apo dështimin për t'i mbrojtur viktimat, nga radhët e zyrtarëve dhe të propozohen ndëshkime për sjelljet e pahijshme dhe dështimet e këtyre.

61 Raporti për Kosovën 2019 që shoqëron dokumentin Komunikim nga Komisioni te Parlamentin Evropian, Këshilli, Komiteti Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komiteti i Rajoneve 2019 Komunikimi për Politikën e Zgjerimit të BE-së <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-kosovo-report.pdf>

4. Të plotësohet dhe ndryshohet legjislacioni përkatës për të siguruar që gratë të mos humbasin kujdestarinë mbi fëmijët e rastin e shkurorëzimit nga partnerët abuzivë.

Për Ministrinë e Drejtësisë

6. Të monitorohen dhe identifikohen mangësitë në zbatimin e Procedurave standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje në Kosovë, për të siguruar që të ketë një mekanizëm efikas bashkërendimi.
7. Të monitorohen dhe të sigurohet se gjykatat respektojnë afatin 24-orësh për nxjerrje të urdhrit për mbrojtje emergjente.
8. Të sigurohet trajtimi i ndjeshmërisë së viktimave gjatë procedurave gjyqësore, për ta shmangur riviktimizimin e tyre.

Bashkëpunimi, trajnimet dhe qasja shumësektoriale

Për Qeverinë

9. Të aplikohet një qasje shumëinstitucionale, duke u ofruar grave që i drejtohen Prokurorisë informata të mjaftueshëm në lidhje me mbështetjen ligjore dhe shërbimet përkatëse shëndetësore dhe sociale. Të përmirësohet bashkëpunimi mes Policisë së Kosovës, prokurorëve, njërive të mbrojtësve të viktimave, qendrave për punë sociale dhe gjykatave, për të siguruar mbrojtje të mirëfilltë për viktimat.
10. Të sigurohen trajnime të rregullta për gjithë pjesëtarët e agjencive ligjzbatuese, përfshirë këtu prokurorët dhe gjyqtarët, si dhe për punëtorët socialë, mbrojtësit e viktimave dhe operatorët e linjave telefonike për ndihmë, lidhur me të gjitha format e DHNG dhe legjislacionin gjegjës, duke përfshirë edhe dhunën ndaj grave gjatë konfliktit.
11. Të propozohen programe për kryesit në suazat e një reagimi të koordinuar të komunitetit, për të nxitur ndryshimin e sjelljes së dhunshme. Siguria e viktimave të jetë në qendër të programeve të tilla.

Për Ministrinë e Drejtësisë

12. Përmes Akademisë së Drejtësisë, të ofrohen trajnime për prokurorë dhe gjyqtarë mbi ndjeshmërinë gjinore gjatë trajtimit të rasteve të DHNG dhe të dhunës në familje si në procedurë civile ashtu dhe atë penale.

Për Policinë e Kosovës

13. Të vazhdohet me mandatin e Divizionit për Trajnime në kuadër të Policisë së Kosovës për ofrimin e trajnimit bazë të detyrueshëm për gjithë zyrtarët policorë, si edhe me trajnimet e specializuara dhe të avancuara për zyrtarët policorë të cilët merren me rastet e dhunës në familje mbi mënyrën e reagimit ndaj rasteve të dhunës në familje dhe adresimit të paragjykimeve gjatë trajtimit të këtyre rasteve.
14. Të bëhet obligativ për Policinë e Kosovës informimi i menjëhershëm i qendrave për punë sociale dhe njërive të mbrojtësve të viktimave për secilin rast të dhunës në familje që raportohet, për ta adresuar llogaridhënien e mangët në reagim ndaj këtyre rasteve.

Për komunitat

15. Të përfundojë themelimi i mekanizmave koordinues për dhunën në familje në të gjitha komunat në Kosovë;
16. Të sigurohet qëndrueshmëri financiare për Strehimoret për viktimat e dhunës në familje;
17. Të fuqizohen kapacitetet e qendrave për punë sociale për të reaguar ndaj rasteve të DHNG dhe dhunës në familje në pajtueshmëri me kuadrin ligjor të Kosovës.
18. Të fuqizohen kapacitetet e ofruesve të kujdesit shëndetësor duke u siguruar trajnim të mirëfilltë për mënyrën se si duhet reaguar në rastet e DHNG dhe dhunës në familje.
19. Të autorizohen zyrtarët komunalë për barazi gjinore për t'i bashkërenduar përpjekjet për luftimin e dhunës në familje në nivel lokal përmes kryesimit mes tjerash të mekanizmit komunal bashkërendues për dhunë në familje.
20. Të propozohet buxhetim i përgjegjshëm gjinor, për të siguruar që grumbullimi dhe ndarja e burimeve publike bëhet në mënyra që janë efektive dhe që i kontribuojnë avancimit të barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave.

Shërbimet e specializuara dhe mbështetja për gratë

Për Qeverinë

21. Të përmirësohet niveli i mbështetjes ekonomike për gratë, duke përfshirë ndihmën financiare dhe strehimin, si dhe mbështetjen e projekteve të drejtuara nga OJQ-të që mbështesin gratë në gjetjen e punës dhe ngritjen e bizneseve; të stimulohen financiarisht bizneset që punësojnë gratë që i kanë mbijetuar DHNG.

Për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale

22. Të sigurohet që të ketë angazhim, si në nivel institucional ashtu edhe atë komunal, për sigurimin e fondeve operative të mjaftueshme dhe të rregullta e afatgjata për strehimoret ekzistuese të grave. Financimi duhet të përfshijë paga të mjaftueshme për punëtorët e strehimoreve.
23. Të sigurohet që të ketë procedura të thjeshta dhe të shpejta për licencimin e strehimoreve të reja, veçanërisht atyre potenciale që ndodhen në zonat rurale dhe/ose që janë në shërbim të grave nga radhët e pakicave. Mund të ngriten strehimore në nivel rajonesh që t'u shërbejnë disa komunave njëherësh, duke siguruar një hapësirë akomodimi familjar për çdo 10,000 banorë në pajtim me standardet e Konventës së Stambollit.
24. Të përmirësohet qasja në strehimoret e grave dhe shërbimet për gratë në pozite të cënueshme.
25. Të ofrohet mbështetje psikologjike për viktimat të cilat nuk qëndrojnë në strehimore.
26. Të organizohen programe për ta nxitur pavarësinë ekonomike dhe strehimin më afatgjatë për gratë të cilat i kanë mbijetuar DHNG, si mënyrë për riintegrimin e tyre në shoqëri.
27. Të propozohen programe riintegrimi të qëndrueshme për të mbijetuarat e dhunës në familje.

Për Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

28. Të sigurohet banim social për gratë të cilat janë viktime të DHNG.

Për komunitat

29. Të shpërndahen informata rreth shërbimeve në dispozicion dhe të drejtave të grave në rast dhune që mund të realizohen përmes institucioneve lokale sikurse qendrat për punë sociale, shkollat, institucionet shëndetësore.
30. T'u ofrohet mbështetje financiare grave të cilat i kanë mbijetuar dhunës për t'i mbuluar shpenzimet për kujdes ndaj fëmijëve.
31. Gratë në nivel lokal të informohen më mirë rreth asaj çfarë mund të bëjnë në rast se përjetojnë dhunë, me fokus të veçantë te gratë nga grupet në disavantazh.

Edukimi, shpërndarja e informatave dhe vetëdijesimi

Për Qeverinë

32. Të dizajnohen dhe realizohen fushata publike për ngritje të vetëdijes për dhunën ndaj grave, shkaqet dhe pasojat e saj, në përputhje me Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW). Të sigurohet që këto fushata të përfshijnë perspektivën e barazisë gjinore, DHNG si shkelje të të drejtave të njeriut, si dhe nocionin se kryesi është ai që mban përgjegjësinë për dhunën e jo viktime.
33. Të ngritet vetëdija sidomos sa i përket dhunës seksuale, veçanërisht në marrëdhëniet me partnerë intimë, duke siguruar që normat dhe qëndrimet tradicionale shoqërore që bëjnë që dhuna seksuale ndaj grave të zgjasë pambarimisht, si p.sh. ideja e "detyrës martesore", të sfidohen duke i informuar gratë dhe burrat mbi të drejtat e njeriut dhe ato sipas ligjit.
34. Të zhvillohen fushata për ta ngritur vetëdijen mbi dhunën seksuale ndaj grave të lidhur me konfliktin, duke i inkurajuar gratë që ta raportojnë dhunën dhe të kërkojnë mbështetje.

Për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale

35. Të zhvillohen fushata vetëdijesimi që i synojnë enkas gratë të cilat i kanë mbijetuar DHNG, me qëllim të vetëdijesimit të tyre mbi të drejtat dhe shërbimet e disponueshme. Të promovohen rrëfimet e grave të cilat ia kanë arritur që t'i japin fund dhunës së ushtruar ndaj tyre dhe për atë se si institucionet dhe shërbimet e specializuara nga OJQ-të u kanë dalë në ndihmë. Të sigurohet se do përfshihen gjitha grupet e grave në disavantazh dhe gjitha rajonet e Kosovës, përfshirë zonat rurale dhe zonat e banuara kryesisht nga popullata serbe e Kosovës.

Për Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

36. Të promovohen diskutime mes brezave të ndryshëm për ta nxitur angazhimin e rinisë dhe, në veçanti, burrave në moshë të re për ta luftuar DHNG. Veç kësaj, gratë dhe vajzat duhet të informohen më mirë rreth shërbimeve të posaçme në dispozicion të tyre nga OJQ-të dhe institucionet.
37. Të zbatohet komponenti i perspektivës gjinore në kurrikulat shkollore, përfshirë përmes heqjes nga tekstit shkollore të të gjithë gjuhës diskriminuese dhe normave shoqërore e kulturore që shkaktojnë vazhdimin pambarimisht të pabarazisë gjinore

Anketë për mirëqenien dhe sigurinë e grave në Kosovë



Foto: Yllka Fetahaj

SHTOJCAT

Shtojca 1. Studimi dhe puna cilësore në terren

Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) ka mbështetur realizimin e një studimi cilësor dhe sasior mbi dhunën ndaj grave, studim ky i kryer nga Ipsos. Ky është studimi i parë krahasues i këtij lloji dhe planifikohet që të përdoret në funksion të përmirësimit të politikëbërjes në të ardhmen si nga akterët vendorë ashtu dhe ata ndërkombëtarë që punojnë në zbatimin e politikave dhe programit në Kosovë.

Pyetjet kërkimore kyçe për projektin janë sa vijon:

- Cila është shkalla e dhunës së përjetuar nga gratë në Kosovë në situata jokonflikti dhe konflikti?
- Cilat forma të ndryshme të dhunës i përjetojnë gratë në Kosovë në situata jokonflikti dhe konflikti?
- Kush janë kryerës të dhunës ndaj grave (DHNG) në situata jokonflikti dhe konflikti?
- Cilat janë pasojat e dhunës?
- A i raportojnë gratë përjetimet e tyre tek policia apo autoritetet e organizatat tjera?
- A ka dallime midis përvojave të grave në varësi të moshës, arsimit, statusit profesional, në se kanë kaluar nëpër ndonjë konflikt apo jo apo nëse mund të përkufizohen si person i zhvendosur brenda vendit apo migrant?
- Cilat janë qëndrimet e shoqërisë ndaj DHNG, si edhe DHNG në situata konflikti?

Studimi përbëhet nga elementët e mëposhtëm:

- Anketa sasiore me një mostër përfaqësuese prej 1,990 grave të moshës 18-74 vjeç e realizuar nga 3 prill-16 gusht 2018. Mostra përbëhej nga 1,690 gra të cilat jetojnë në zona kryesisht të banuara nga shqiptarë të Kosovës dhe 300 gra të cilat jetojnë në zona kryesisht të banuara nga serbë të Kosovës. Janë përfshirë edhe komunitetet e tjera që jetojnë në këto zona.
- Është përdorur mostër e probabilitetit të rastësishëm, e stratifikuar dhe shumëfazore. Korniza e mostrës, që është një listë e qendrave të vendotimeve e përditësuar për herë të fundit në vitin 2014, është siguruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). Territorët e vendotimeve janë përdorur si njësi parësore të nxjerrjes së mostrës (NJPM-të). Në këtë mënyrë është siguruar mbulueshmëri prej gati 100%. Vetëm pesë NJPM që kishin më pak se 100 votues të regjistruar u përjashtuan nga mostra për shkak të konsideratave të praktikitetit të punës në terren, ngaqë bëhej fjalë për lokalitete të largëta dhe të izoluara. Ato përbënin më pak se 0.1% të popullsisë.
- Korniza e mostrës u stratifikua sipas rajoneve dhe madhësisë së vendbanimit. Më pas u përzgjedhën NJPM-të nga secila shtresë e mostrës me probabilitet proporcional me madhësinë. Nga gjithsej 175 NJPM të përzgjedhura, një numër i paracaktuar adresash u nxor nga secila NJPM mostër me synimin që në secilën NJPM të mbahen nga 10 intervista. Adresat u përzgjedhën në kohën kur do të zhvilloheshin intervistat, duke përdorur metodën e ecjes së rastit. Në rastet kur në adresën e përzgjedhur u identifikuan më shumë se një ekonomi familjare, njëra nga to u përzgjedh me fletëkontaktin elektronik.

Në secilën ekonomi familjare mostër u përzgjedh nga një grua për intervistim. E anketuara u përzgjedh sipas metodës së rastit nga lista e gjitha grave të cilat i plotësonin kriteret në ekonominë familjare të përzgjedhur, d.m.th. Gjitha

gratë e moshës 18-74 vjeç në një ekonomi familjare listoheshin sipas moshës nga më të moshuarat deri të më të rejat në fletëkontaktin elektronik. Më pas fletëkontakti përzgjidhte në mënyrë të rastësishme një të rastësishme nga to duke përdorur një gjenerues të numrave të rastësishëm.

- Intervistat u zhvilluan sy-më-sy nga anketuese terreni të trajnuara enkas (shih Shtojcën 2 më poshtë për hollësira të mëtejme rreth trajnimit dhe protokolleve).
- Shkalla e përgjigjeve shkoi në 60%⁶² dhe pranueshmëria mesatare ishte 96%.
- Ponderimet u llogaritën në dy faza: a) ponderimet e dizajnit të nxjerrjes së mostrës; dhe b) ponderimet pas shtresëzimit të mostrës. Ponderimet e dizajnit pasqyruan probabilitetin e përzgjedhjes së të anketuarve, ndërsa peshat e pashtresimit u llogaritën për të kompensuar rastet e mos përgjigjeve. Në Kosovë, për qëllime të ponderimit pas shtresëzimit u përdorën kategoritë e rajonit, madhësisë së zonës së banimit dhe e moshës. Meqë popullsia serbe e Kosovës ishte mbimostruar, gjatë procedurës së ponderimit ajo u ponderua për të përkuar me profilin aktual të popullsisë në Kosovë. Për shkak të dallimeve në metodologji, marrjen e mostrave dhe hartimin e pyetësorit, rezultatet e kësaj ankete nuk do të jenë të krahasueshme drejtpërsëdrejti me anketat në nivel Kosove.
- U realizuan diskutime me tetë grupe të fokusit (GF), duke përfshirë këtu grupet me gra nga radhët e pakicave etnike dhe gra të cilat kanë përjetuar konfliktin. Pilotimi i një grupi të fokusit u bë në dhjetor 2017, ndërsa pjesa tjetër duke filluar nga 19 qershori deri më 9 korrik 2018.

Tabela A1.1. Përbërja e grupeve të fokusit

GF	Vendndodhja	Numri i pjesëmarrëseve:	Grupmosha	Etnia	Numri i grave të prekura nga konflikti	Numri i grave me fëmijë	Numri i grave të punësuar
1	Prishtinë	8	34-55	Shqiptare të Kosovës	*	*	*
2	Prishtinë	7	31-50	Shqiptare të Kosovës	*	6	2
3	Ferizaj	8	18 – 29	Ashkali të Kosovës	*	0	2
4	Dragash	13	18-29	Shqiptare të Kosovës	*	4	2
5	Mitrovicë Jugore	16	18-29	Shqiptare të Kosovës	16	0	3
6	Gjakovë	8	50+	Shqiptare të Kosovës	*	8	8
7	Mitrovicë Veriore	8	25-55	Serbe të Kosovës	8	4	4
8	Graçanicë	9	41-60	Serbe, gorane dhe malazeze të Kosovës	9	8	5

*Nuk janë dhënë informata

- Pesë intervista të hollësishme (IH) me të mbijetuara të dhunës. Intervista e parë u realizua në janar të vitit 2018, ndërsa pjesa e mbetur në muajt korrik dhe gusht.

62 Shkalla e përgjigjeve llogaritet si më poshtë dhe në përputhje me përkufizimin e shkallës së përgjigjeve RR3 sipas Shoqatës Amerikane për Hulumtime të Opinioneve Publik. Shih Përkufizimet standarde: Përcaktimet përfundimtare të kodeve të rasteve dhe shkallëve të rezultateve për anketa (Final Dispositions of Case Codes and Outcome Rates for Surveys), Botimi i VII-të (Oakbrook Terrace, IL: Shoqata Amerikane për Hulumtime të Opinioneve Publik, 2011), f. 46.

